

Prill 2021  
Numri: 157  
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.progresibotime.com](http://www.progresibotime.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

رمضان كريم

## RAMAZANI URË PËR KALIMIN E VËSHTIRËSIVE




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër  
qëndrimi indiferent,  
pandjenja dhe injorant përballë  
mrekullive të pafundme  
madhështore, që prej  
grimcës më të vogël, e deri tek  
trupi më i madh, prej botës  
mikro, e deri në atë makro,  
të cilat ndriçojnë më së miri  
mendjen dhe zemrën,  
përveçse një çoroditje  
dhe falimentim i mendjes!?



**Profeti (a.s.), thotë:**

“Ditën e Kiametit asnjë rob  
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap  
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën  
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e  
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar  
pasurinë e tij dhe se ku e ka  
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e  
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që  
është drejtuar kah e mira dhe ka  
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e  
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



## RAMAZANI, URË PËR KALIMIN E VËSHTIRËSIVE

Ramazani i ofron njeriut tri receta, një recetë i është dedikuar individit, një tjetër shoqërisë dhe një i është dedikuar gjithë njerëzimit.

Ramazani është një rast i volitshëm për disiplinimin e egos, një rast i jashtëzakonshëm për edukimin shpirtëror.

Ndjenjat që e nxitin më së shumti njeriun të bjerë në gabime janë babëzia, ambicia e tepruar, mosmirënjohja, mungesa e turpit dhe mëshirës. Të gjithë këto ndjenja gjatë ramazanit frenohen, dobësohen sepse në këtë muaj vetëdija dhe mirësia sundon mbi të gjitha ndjenjat e tjera. Ky muaj shërben si një pasqyrë për njeriun. Njeriu në këtë periudhë gjen mundësinë për të kontrolluar dhe gjykuar mbi dëshirat e tepruara.

Ramazani është një mundësi për të ndryshuar botën. Gjatë Ramazanit vihet re një rënie drastike e përdorimit të alkoolit, vjedhjeve dhe krimeve të tjera. Por ky ndryshim nuk është vetëm në këtë botë por edhe për botën tjetër. Ramazani i jep njeriut mundësinë për të ndryshua prioritetet.

Muaj i Ramazanit është muaj i përmisimit dhe përsosjes shpirtërore.

Ramazani nga ana tjetër është një muaj ku shfaqet solidariteti social. Në këtë muaj rritet dukshëm bamirësia dhe mirëkuptimi midis njerëzve. Ramazani është muaj ku forcohen marrëdhëniet familjare dhe sociale. Të gjitha këto përveç ndikimit në këtë botë, janë në fakt një investim për botën tjetër.

Ramazani është një muaj që i shton vlerë jetës. Ramazani përmban mesazhe të forta universale.

Pandemia na mësoi se sa qenie e dobët dhe e brishtë që jemi. Nga kjo pikëpamje pandemia nuk është një dënim por një vërejtje, është një qortim që i drejtohet gjithë njerëzimit për të rishikuar sjelljet dhe veprimet.

Në një situatë të tillë mjaft të vështirë Ramazani është një urë për kapërcimin e vështirësive.

# Përmbajtja

Thoni në dashtë Allahut  
Adem Saraç

13




8

Muaji në të cilin ka zbritur Kurani  
Doç. dr. Mustafa Karabaxhak



Aftësia për të ndarë  
të drejtën nga e gabuara  
Ajnur Tutkun

20



10



34

"Çfarë ke bërë sot për Allahun?!"  
Osman Nuri Topbash

- 5 **Ndikimi i agjërimit mbi egon dhe zemrën**  
Prof. dr. Sulejman Derin
- 10 **Kurani në Ramazan**  
Doç. dr. Kerim Bulladë
- 18 **Thelbi i moralit islam**  
Xhafer Durmush
- 20 **Të lutesh me një gjuhë pa gjynahe**  
Doç. dr. Durak Pusmaz
- 22 **Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij**  
Mustafa Asim Kyçkashçë
- 26 **Ki respekt dhe duro**  
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 28 **Çfarë mund t'i ofrojmë botës**  
Doç. dr. Harun Emysh
- 30 **Përfaqësimi dhe predikimi**  
Sami Gëksyn



47

Një Ajet 32

- Largohu nga dyshimet** 44  
Doç. dr. Mustafa Xhanllë
- Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira** 47  
Irfan Erturk
- Psikologjia dhe prehja** 50  
Kybra Ergin
- Dobësimi i familjes** 54  
Sami Byjkkajnak

40



Pesë rregulla  
Ahmet Zijan

Mëshira e Profetit (a.s.)  
Naim Drijaj

56



# NDIKIMI I AGJËRIMIT MBI EGON DHE ZEMRËN

— Prof. dr. Sulejman Derin —

AGJËRIMI NGA NJË ASPEKT ËSHTË TË KUJTUARIT E ZOTIT (XH.XH.), NË NJË MËNYRË TË VAZHDUESHME, SEPSE LËNIA E NEVOJAVE DHE DËSHIRAVE MË TË NATYRSHME SI TË NGRËNËT DHE TË PIRËT NGAQË KA KËRKUAR AI, SIGURISHT QË NXJERR NË PAH NJË GJENDJE DHIKRI TË VAZHDUESHME. KJO GJENDJE VAZHDON POTHUAJSE NË MËNYRË TË DOMOSDOSHME MË SHUMË SE GJYSMËN E DITËS.

Dëlirja dhe përsosja e personalitetit të njeriut pa dyshim se është njëra prej detyrave më të rëndësishme për shpëtimin e përhershëm. Vendi i ushtrimit të kësaj detyra është fusha e “egos” dhe “zemrës”. Egoja duhet të pastrohet nga çdo lloj prirjeje për mëkat dhe papastërtitë e gjynahut. Ndërsa zemra duhet të mbrohet e të pajiset me devotshmëri. Në të kundërt, kapitali i jetës do të shkojë dëm dhe njeriu do të humbasë. Edhe harta e kësaj lufte që do të realizohet në trupin tonë i është paraqitur të gjithë njerëzimit si një plan mësimor hyjnor nga Zoti (xh.xh.), me Kuranin Fisnik dhe me fjalët, veprat dhe gjendjet e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ne në këtë shkrim krahas se do

të theksojmë që agjërimi është një ibadet, do të nxjerrim në pah edhe faktin sesi agjërimi bëhet shkak për pastrimin e nefsit dhe për mbrojtjen e zhvillimin e zemrës me devotshmëri.

Ego e njeriut, posedon një natyrë që siç thotë edhe Kurani Fisnik, urdhëron të keqen me të gjithë fuqinë që ka. Por gjithashtu atij i është dhënë edhe aftësia për t’u dëlirë. Ndoshta sprova dhe përgjegjësia e njeriut me veten e tij fillon këtu.

Ndërsa zemra është vendi edhe i të kuptuarit, edhe i devotshmërisë e cila cakton nderin dhe vlerën e njeriut te Zoti (xh.xh.). Zemra është thelbi i njeriut dhe vendi ku shikon Allahu Teala.





**NAMAZI I NATËS, VEÇANËRISHT NAMAZI I TARAVISË DHE ADHURIMI NË KOHËN E AGIMIT, JANË PREJ SUNETIT TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.), QË KRYHEN ME NJË KËNAQËSI E PASION TË MADH PËRGJATË MUAJIT TË RAMAZANIT. PEJGAMBERI (A.S.), KA THËNË: “NË SY-FYR KA BEREQET” ME KËTË SHPREHJE ËSHTË KËRKUAR QË BESIMTARËT TË JENË NË KËMBË NË MES TË NATËS, NË MËNYRË QË TË ADHUROJNË ZOTIN E TYRE.**

Zemra është masa e vlerës që robi do të ketë në ditën e gjykimit.

Për sa i përket agjërimit mund të themi se ai ka një veti edukuese për dëshirat egos dhe forcuese për ndjenjën e devotshmërisë në zemër. Në të vërtetë, ai është një adhuring që i është bërë obligim të gjithë njerëzimit në forma të ndryshme dhe një mundësi pastrimi/edukimi universale. Tani le të shohim marrëdhënien edukuese dhe pastruese ndërmjet agjërimit, egos dhe zemrës.

Dijetarët e mëdhenj të cilët mund t'i quajmë prijësit e edukimit të civilizimit tonë, i kanë konsideruar si të lidhur shumë me njëri-tjetrin edukimin e egos dhe dëshirat trupore. Gjërat me të cilat duhet të ushqehet trupi dhe mënyrat se si duhet të ushqehet ky i fundit pothuajse i kanë konsideruar si hapin e parë në edukimin e egos. Vazhdimisht na është kujtuar se duhet të shfaqim kujdes të madh kundrejt çdo lloji të haramit, të ushqehemi me hallall, të qëndrojmë larg gjërave të dyshimta dhe të përfitojmë nga mirësitë me një zemër të zgjuar dhe pa qenë neglizhentë ndaj Allahut (xh.xh.).

Hoxha i mirënjohur, Ibrahim Hakkë Erzurumi në veprën e tij me titull Marifetname, na e tërheq vëmendjen ndaj këtyre çështjeve të mëposhtme të cilat janë shtyllat, bazat dhe themelet e “Rrugës së Urtësisë”, domethënë të shkollës së “marifetu’n-nefs ve marifetu’ll-llah / njohjes së vetes dhe njohjes së Zotit”:

1. Të ngrënë e pakët.

2. Të folurit e pakët.

3. Të fjeturit e pakët.

4. Të qëndruarit larg njerëzve përveç se në situata të domosdoshme dhe të nevojshme.

5. Të përkujtuarit e Zotit në mënyrë të vazhdueshme.

6. Të llogariturit e vetes dhe të medituarit duke nxjerrë nga zemra çdo gjë të kësaj bote dhe duke iu drejtuar Zotit në një mënyrë të plotë.

Nëse i shohim me vëmendje, pothuajse të gjitha këto gjashtë nene mbartin qëllimin e pastrimit të egos dhe forcimit të devotshmërisë së zemrës. Këtu në një mënyrë përjetohen të gjitha kushtet e numëruara të ibadeti i agjërimit. Le ta shpjegojmë edhe pak më shumë:

Të ngrënë dhe të pirë në agjërime janë të ndaluar për një kohë të caktuar. I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e ka parë të përshtatshëm “savmi visal”, domethënë agjërimin ditë pas dite pa bërë iftar, sepse, uria dhe pehrizi ekstrem edhe pse mund ta bëjë njeriun të përjetojë gjendje të mbinatyrshe siç ndodh te murgjit budistë dhe Brahmanët, me kalimin e kohës e largojnë njeriun nga pjekuria e një personaliteti të ekuilibruar. Bazuar në këtë, ibadeti i agjërimit në Islam edhe pse jep edukimin e të ngrënë e pakët dhe në këtë mënyrë e bën zemrën të fitojë kundër egos, këtë të fundit nuk e shpëput krejt nga jeta. Thënë ndryshe, ia jep egos të drejtat e saj dhe ia kufizon e frenon dëshirat dhe eprshet.

Të folurit përgjatë agjërimit nuk është ndaluar krejtësisht. Domethënë, në fenë tonë nuk është këshilluar një praktikë të cilën mund ta quajmë agjërim i të folurit. Ama këshillohet në mënyrë të veçantë që t'i dalim për zot gjuhës dhe të qëndrojmë larg fjalëve e debateve të panevojshme. Ky është “taklili kelam/të folurit e pakët” që përbën njërin prej themeleve të rrugës së njohjes së Zotit (xh.xh.).

Namazi i natës, veçanërisht namazi i taravisë dhe adhurimi në kohën e agimit, janë prej sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), që kryhen me një kënaqësi e pasion të madh përgjatë muajit të Ramazanit. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “*Në syfyr ka bereqet.*” Me këtë shprehje është kërkuar që besimtarët të jenë në këmbë në mes të natës, në mënyrë që të adhurojnë Zotin e tyre. Këto vepra të mira që kryhen përbëjnë “taklili menamin / të pakësuarit e gjumit” i cili është njëri prej themeleve të edukimit të “sejri sulukut/ udhëtimit shpirtëror”.

Muaji i agjërimit është muaji kur rob i mund t'i shtojë momentet e veçanta të qëndrimit vetëm për vetëm me Zotin (xh.xh.). Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, (a.s.), pothuajse në çdo Ramazan ka hyrë në itikaf dhe veçanërisht në dhjetë ditëshin e fundit nuk është larguar nga xhamia natë e ditë. Marrëdhënien e tij me çdo gjë tjetër përveç Allahut Teala pothuajse e ka zbritur në nivelin më të ulët. Kjo gjendje quhet “uzleti enam”.

Agjërimi nga një aspekt është të kujtuarit e Zotit (xh.xh.), në një mënyrë të vazhdueshme, sepse lënia e nevojave dhe dëshirave më të natyrshme si të ngrënës dhe të pirës ngaqë ka kërkuar Ai, sigurisht që nxjerr në pah një gjendje dhikri të vazhdueshme. Kjo gjendje vazhdon pothuajse në mënyrë të domosdoshme më shumë se gjysmën e ditës. Ja pra, kjo është njëra prej çështjeve për të cilën folëm më sipër dhe që e quajtëm “dhikri mudam” dhe “fikri temam”.

Secila prej bazave për të cilat folëm më sipër, në shumë aspekte janë pastruese dhe edukuese për dëshirat e panevojshme, të ulëta dhe shumicën e rasteve të dëmshme të nefsit. Në të njëjtën kohë ato e mbrojnë zemrën nga preokupimet e panevojshme dhe e ushqejnë me gjëra që formojnë devotshmërinë. Në të vërtetë, Zoti (xh. xh.), shprehet se qëllimi i urtësisë në obligimin e agjërimit është pikërisht ky. Andaj thotë: “*...Ju është obliguar agjërimi, në mënyrë që të bëheni të devotshëm.*”<sup>5</sup> Njëri prej shumë përkufizimeve

të devotshmërisë është ky: “Devotshmëria është vetëdijesimi i robit për përgjegjësinë që ka ndaj Allahut.” Nisur nga ky kontekst, agjërimi është edhe një ibadet që ia shton njeriut ndjenjën e përgjegjësisë së nënshtrimit kundrejt Allahut, edhe një plan mësimor i ardhur nga Zoti për t’ia shtuar atij ndjenjën e përgjegjësisë kundrejt krijesave të tjera. Kjo sepse muaji i Ramazanit nga njëra anë është një muaj në të cilin kryhen shumë adhurime farz dhe nafile me në krye namazin. Në anën tjetër është edhe një sezon i veçantë në të cilin ndjehet në nivel të lartë vetëdijesimi për mëshirën, dhembshurinë dhe dhurimin duke dhënë zekatin dhe fitret.

Gjithashtu agjërimi, si një rezultat i natyrshëm i ngrënies dhe pirjes së pakët, bëhet shkak që nga zemra të shpërthejnë burimet e urtësisë. Shumë dijetarë e kanë shprehur në veprat e tyre se ka një lidhje të afërt ndërmjet urisë dhe urtësisë. Urtësia është një nderim i madh hyjnor edhe për zemrën, edhe për jetën tonë. Nisur nga ky kontekst mund të themi se agjërimi luan një rol të rëndësishëm në reflektimin e dritave dhe shfaqjeve hyjnore në zemrën tonë.

Disa dijetarë të urtë që janë frymëzuar nga hadithi fisnik: “*Për agjëruesin ka dy gëzime. Njëri është gëzimi kur të çelë iftarin, ndërsa tjetri është gëzimi kur të takojë Zotin.*”<sup>6</sup>, kanë thënë se agjërimi në të njëjtën kohë është edhe përgëzim për takimin me Zotin dhe për shikimin e bukurisë së Tij. Nisur nga këto që thamë, agjërimi është urë edhe për ndjesinë dhe perceptimin që bën të mundur shikimin (e fuqisë së) Zotit në çdo gjë të kësaj bote. Në këtë kontekst, agjërimi është prehje shpirtërore e ardhur nga Zoti që formon prehjen e zemrave.

Zemra e agjërimit është devotshmëria. Ndërsa vendi i devotshmërisë është zemra. Ndërsa agjërimi i zemrës është eliminimi i çdo lloj qëllimi që mban erë ego, nxjerrja e çdo gjëje prej saj përveç Zotit dhe specifikimi i sarajit të saj vetëm për Allahun (xh.xh.). Kjo gjendje është një agjërim që zgjat gjithë jetën dhe të cilën të gjithë dijetarët kanë dëshiruar ta realizojnë në jetën e tyre. Për ta arritur këtë pjekuri duhet të pastrohemi me agjërim, të tërheqim mëshirën dhe udhëzimin hyjnor me shumë përpjekje dhe t’i përgjrohemi Zotit (xh.sh.) për sukses

# MUAJI NË TË CILIN KA ZBRITUR KURANI

— Doç. dr. Mustafa Karabaxhak —

Muaji Ramazan është muaji i Kuranit. Pra, është një muaj në të cilin ka zbritur libri ynë i shenjtë, Kurani Fisnik. **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”** (Bekare, 185) Po ashtu është shprehur qartë se në cilën natë të muajit ramazan ka zbritur libri ynë i shenjtë, Kurani: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”** (Kadr, 1-5)

Muaji i Ramazanit në të njëjtën kohë është edhe muaji kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ia thoshte Kuranin Xhebrailit (a.s.). “I Dërguari i Allahut çdo vit ia thoshte Kuranin Xhebrailit (a.s.). Ndërsa vitin kur ka ndërruar jetë ia ka thënë dy herë.” (Buhari, Menakib, 25; Muslim, Fedail, 50; Fedailu’s-Sahabe, 98,99; Ibn Maxhe, Xhenaiz, 64.)

## KURANI ËSHTË I MBROJTUR NGA GABIMI

Kurani Fisnik është një libër mrekulli nisur edhe nga aspekti i fjalëve, edhe i kuptimit. Ndërkohë që mrekullitë e tjera të Hz. Pejgamberit ishin të kufizuara me kohën, mrekullia e Kuranit është një mrekulli që i sfidon shekujt. Në këtë kontekst, ai është një libër për të cilin njerëzit e kanë të pamundur të bëjnë një të tillë. **“...Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.”** (Isra, 88)

Kurani Fisnik është i mbrojtur nga gabimi dhe nën sigurinë e Zotit (xh.xh.): **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”** (Hixhr, 9) **“Ata që e mohojnë Fjalën**



**Tonë përkujtuese, kur u vjen, do të dënohen rëndë. Ai është vërtet një Libër i madhërueshëm. Atij nuk mund t’i afrohet gënjeshtria nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”** (Fussilet, 41-42)

Në librin tonë, Kuranin është e pamundur të gjendet qoftë edhe mospërputhja më e vogël: **“A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”** (Nisa, 82)

Sado i kujdesshëm që të jetë një dijetar, mund të gabojë në librat dhe shkrimet e tij, sepse është njeri. Ky transmetim i Ebu Ibrahim Ismail ibn Jahja ibn Ismail el-Muzeni el-Misri, i cili ishte prej nxënësve kryesorë të Imam Shafiut (204/820), është mjaft interesant: Shafiut ia kam dhënë të tëdhjetë herë librin e vet er-Risale për ta lexuar. Çdo herë patjetër e gjente nga një gabim. Pastaj thoshte: “Ah! Ah! Allahu nuk pranon që ndo një libër të jetë i saktë përveç librit të Tij.” (Ibn Abidin, Muhammed Emin ibn Omer ibn Abdulaziz Abidin ed-Dimashki el-Hanefi (1252/1836), Reddu’l-Muhtar ala ed-Durri’l-Muhtar, Botimi i

2-të, I-VI, Daru'l-Fikr, Bejrut, 1412/1992, I, 27.)

Mesazhet e Allahut në Kuranin Fisnik në lidhje me çdo çështje janë dhënë në mënyrë të kuptueshme dhe janë shpjeguar. **“Në këtë Kuran, Ne u shpjegojmë njerëzve gjithfarë shembujsh, por shumica e njerëzve, kurrësi nuk duan të besojnë.”** (Isra, 89)

Në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, domethënë, në muajin e Kuranit, ata që nuk dinë ta lexojnë Kuranin duhet që sa më parë ta mësojnë leximin e tij. Kurani Fisnik duhet të përfshijë çdo moment të Myslimanit dhe duhet të lexohet vazhdimisht. Kurani duhet të gjendet mbi tavolinën e mysllimanit, në xhep dhe në çantën e tij, në mënyrë që ta gjejë mundësinë dhe ta vlerësojë çdo moment. Ndërsa në muajin e Kuranit, në Ramazan duhet të preokupohemi edhe më shumë se herët e tjera me Kuranin. Kurani Fisnik është libri të cilin duhet ta lexojmë më së shumti dhe ndaj të cilit duhet të jemi jashtëzakonisht të prirë. Madje në këtë kontekst, vetë i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka paralajmëruar ata që janë preokupuar më shumë me hadithet dhe nuk e ka konsideruar si të pranueshme prishjen e kësaj radhe. Malik ibn Ubade (r.a.), transmeton se Resulullahu (a.s.), ka thënë: **“Ju e keni më të nevojshme të mësoni Kuranin. Ndërkohë dëshironi të transmetoni hadithe prej meje me një oreks të madh. Krahas kësaj, për atë që e ka mësuar mirë një hadith prej meje, nuk ka ndonjë problem për ta transmetuar. Por kush shpif për mua, domethënë, kush shpif ndonjë hadith në emrin tim, le të përgatisë vendin e tij në xhehenem.”** (Buhari, Tarihu'l-Kebir, VII, 301, 302; Taberani, Mu'xhemu'l-Kebir, XIX, 296; Ramehurmuzi, el-Muhaddithul Fasil Bejne'r-Ravi ve'l-Vai, fq. 172; Ebu Zur'a, Tarihu Ebi Zur'a ed-Dimashki, fq. 268, 269.)

## MË I MIRI PREJ JUSH

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: **“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson atë edhe të tjerëve.”** (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21/5027, 5028.) Hz. Pejgamberi na ka njoftuar se i jepet dhjetë sevape çdo shkronjë të Kuranit Fisnik që lexohet duke u shprehur: **“Ai që lexon një shkronjë nga Kurani Fisnik ka sevinin e një mirësie. Shpërblimi i çdo mirësie është dhjetë sevape. Unë nuk po them se “elif, lam, mim” janë një shkronjë, por përkundrazi “elifi” është një shkronjë, “lami” është një shkronjë dhe “mimi” është një shkronjë.”** (Tirmidhi, Fadailu'l-Kur'an,

16/2910). Kurani Famëlartë duhet të lexohet në çdo kohë dhe çdo vend: **“Ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës** (duke thënë: **“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh** (nga çdo e metë)! **Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”** (Al Imran, 191) Abdullah ibn Mugaffeli ka thënë se e ka parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke kënduar suren Fet'h mbi deve përgjatë çlirimit të Mekës. (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 24/5034; Muslim, Salatu'l-Musafirin, 237/794.) Por nuk duhet ta harrojmë edhe këtë se Kurani nuk ka ardhur vetëm për t'u lexuar dhe për të fituar sevape, por për t'u lexuar, për t'u kuptuar dhe për t'u praktikuar në jetë. Poeti i famshëm Mehmet Akif Ersoji e shpreh këtë si më poshtë:

*“E hapim Kuranin dhe i shohim faqet e tij,  
Ose i fryjmë tokës së një të vdekuri me të,  
Dijeni mirë se Kurani nuk ka zbritur për këtë,  
Pra, nuk ka zbritur as për t'u kënduar te varrezat,  
as për të parë fallin.”*

Kuranin Fisnik duhet ta lexojmë çdo ditë dhe duhet të mendojmë rreth kuptimit të ajeteve të tij. Në qendrën e jetës sonë duhet të gjendet Kurani Famëlartë.

Të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, i pëlqente kur disa sahabë e lexonin Kuranin. Njëri prej këtyre ishte Ebu Musa el-Esh'ariu. Një ditë Resulullahu (a.s.), e dëgjoi atë duke kënduar Kuran. Andaj tha për të: **“Atij i është dhënë zëri i bukur si zëri i bukur që i ishte dhënë pejgamberit Davud.”** (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 31; Muslim, Salatu'l-Musafirin, 236; Nesai, Iftitah, 83; Ibn Maxhe, Ikametu's-Salat, 176.)



# KURANI NË RAMAZAN

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Po përjetojmë lumturinë e arritjes së muajit në të cilin ka zbritur Kurani Fisnik i cili është burim udhëzimi dhe mëshire për të gjithë njerëzit<sup>1</sup> dhe në veçanti për besimtarët<sup>2</sup>, të devotshmit<sup>3</sup> dhe punëmirët.<sup>4</sup> Ajo që i jep kuptim muajit të Ramazanit, krahas agjërimit, padyshim se është fillimi i shpalljes së Kuranit. Muaji i Ramazanit në një kuptim është muaji i Kuranit. Fjala “Ramazan” vjen nga rrënja “ramada-ramida” që do të thotë të djegësh dhe të digjesh.<sup>5</sup> Thuhet se muajit të agjërimit i është thënë muaji i ramazanit për shkak se i djeg mëkatet me vepra të mira.<sup>6</sup> Nëse mendojmë rreth kuptimeve që i jepen fjalës Ra-

mazan, mund të themi se ato janë: “Pastrim, dëlirje dhe shkatërrim i mëkateve.” Mirë, por si do t’i djegim dhe pastrojmë mëkatet? Cilat janë metodat dhe parimet për ta bërë këtë?

Kurani Fisnik i ka shpjeguar metodat dhe rregullat e dëlirjes. Përderisa të ndiqen parimet e Kuranit dhe të Sunetit i cili është shpjegim i tij, edhe pse këto i vijnë rëndë dhe vështirë nefsit, kjo nuk është një çështje që nuk kryhet me sukses dhe shpëtimi i vërtetë fillon pikërisht me këtë. Kurani me atributin e tij “furkan” e ka dhënë recetën e shpëtimit.

Kurani Fisnik është një libër që e ndan nga

**“O BESIMTARË!  
NËSE I FRIKËSOHENI  
ALLAHUT, AI DO T’JU  
JAPË AFTËSINË E TË  
GJYKUARIT DREJT,  
DO T’JU LIROJË NGA  
GJYNAHET TUAJA  
DHE DO T’JU FALË...”**  
DOMETHËNË, ZEMRAVE  
TUAJA U JEP NJË DRITË  
DHE AFTËSI MË TË  
CILAT MUND TA NDAJNË  
TË VËRTETËN NGA E  
PAVËRTETA.

njëra-tjetra të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e gabuara, të mirën nga të keqen, të bukurën nga e shëmtuara, mëkatin nga sevapi dhe haramin nga hallalli. Ai na shpjegon se cila është e drejtë, cila është e gabuar, cila është e vërtetë, cila është e pavërtetë, cila është e bukur dhe cila është e shëmtuar. Ai i deklaron, i shpjegon dhe pastaj vendos parime e rregulla në lidhje me këto çështje.<sup>7</sup> Kurani këtë veçori të tij e shpjegon si më poshtë:

***“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”<sup>8</sup>***

Në ajetin e mësipërm tregohet cilësia “Furkan” e Kuranit. Fjala “furkan” do të thotë ndarës i së vërtetës nga e pavërteta. Ai e tregon në mënyrë thelbësore dhe të shkurtër rrugën e udhëzimit. Kjo synohet nga cilësia “Huden” e Kuranit Fisnik. Ndërsa me cilësinë “Furkan” tregohet rruga e udhëzimit në mënyrë të detajuar. Ai është një libër që shpjegon dispozitat e hallallit e haramit dhe që ndan të vërtetën nga e pavërteta e hallallin nga harami.

Njëri prej emrave të rëndësishëm të Kuranit është “Furkan”. Në ajetin: ***“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Furkanin/Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.”***<sup>9</sup>, është theksuar në mënyrë të veçantë cilësia “Furkan” e tij.

Ajeti në vijim me emrin “furkan” të Kuranit u jep besimtarëve një rregull shumë të rëndësishëm: ***“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tua dhe do t’ju falë...”***<sup>10</sup> Domethënë, zemrave tua u jep një dritë dhe aftësi më të cilat mund ta ndajnë të vërtetën nga e pavërteta. Kelamull-llahu (Kurani) është quajtur “Furkan” ngaqë e ndan të vërtetën nga e pavërteta në itikad (besim), të drejtën nga mashtrimi në fjalë dhe të mirën nga të keqen në vepra. Fjalës “furkan” i është dhënë edhe kuptimi shpëtim, sepse njerëzit me Kuranin arrijnë të shpëtojnë nga errësirat e devijimit.

E drejta nga e gabuara, e bukura nga e shëmtuara dhe e mira nga e keqja janë ndarë me urdhrat, ndalesat, deklaratimet dhe shpjegimet e Kuranit Fisnik. E vërteta ka dalë në pah si dielli me parimet dhe rregullat që ka vendosur ai (Kurani). Me cilësinë “Furkan” të Kuranit është bërë krejt e qartë se cilat parime dhe principe do ta shpjen njerëzimin drejt lumturisë dhe se cilat rregulla

e ligje do t’i shpjen individët, familjet dhe popujt drejt paqes, qetësisë, sigurisë dhe lumturisë. Urdhrrat hyjnore që Kurani ia ka shfaqur njerëzimit janë aq të qarta dhe të kuptueshme saqë një shpjegim dhe qartësim të tillë nuk mund të gjendet në asnjë fe, ideologji apo filozofi. Në lidhje me këtë çështje Kurani Fisnik ia shpall në një formë të prerë mesazhin e tij të gjithë njerëzimit: ***“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!...”***<sup>11</sup>

Muaji i Ramazanit është muaji i Furkanit/Kuranit. Besimtari që i beson dhe është i lidhur me Kuranin, falë “Furkanit” në këtë muaj arrin një fuqi më të madhe dalluese në krahasim me muajt e tjerë. Kurani i përket Allahut nga aspekti i fjalës, kuptimit, shpjegimit dhe sistemimit. Sigurisht që do të lexohen edhe fjalët e Kuranit. Të thuash se nuk ka kuptim, sevap dhe shpërblim të lexuarit e fjalëve të Kuranit edhe pse kanë ardhur shumë ajete e hadithe në lidhje me këtë çështje

t j e ,  
nuk është e drejtë. Nëse fjala, kuptimi, shpjegimi dhe sistemimi i përkasin Atij (Zotit), atëherë këtu robërve nuk u takon të thonë asnjë fjalë. Por të mos harrojmë se Kurani Fisnik nuk është dërguar vetëm për t’u kënduar. Ai është dërguar për t’u siguruar njerëzve lumturinë në këtë botë dhe në botën e përtejme. Ai është libër i dispozitave. Ai ka sjellë parime edhe për sistemin e jetës së kësaj bote, edhe për fitimin e botës tjetër. Ai nuk është një libër që flet vetëm për të kaluarën. Ai është një libër që e sistemon edhe të tashmen dhe të ardhmen ndërkohë që thekson se duhet të merret mësim nga e kaluara. Atëherë, ne si besimtarë falë cilësisë “furkan/dalluese” që na ka dhënë Kurani kemi një detyrë të shenjtë si dëlirja, sistemimi dhe edukimi i nefsit tonë, familjes sonë, umetit të Muhamedit dhe i gjithë njerëzimit me rregullat e parimet e tij.

Kurani e ka theksuar si më poshtë se qëllimi i





zbritjes së tij është që njerëzit e mençur të mendojnë rreth ajeteve të tij dhe të marrin mësim nga ato: **“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.”**<sup>12</sup>

Në këtë ajet gjendet argumenti se Allahu Teala e ka zbritur Kuranin jo vetëm që të këndohet pa menduar rreth tij, por për të menduar e medituar rreth kuptimeve të tij.<sup>13</sup> Ajetit që sapo e përmendëm më sipër i janë dhënë kuptime të ndryshme. Fjalja “për të përsiatur mbi vargjet e tij” është kuptuar në formën “për të zbatuar urdhrat dhe ndalesat e tij”. Sipas Fahrudin Razit, ai që nuk mendon, nuk mediton dhe nuk e arrin marrjen e suksesit nga Zoti, nuk mund t’i njohë të fshehtat magjepsëse të cilat janë përmendur në Kuranin Famëlar të.

Sahabët e nderuar në vitet e para të Islamit nuk e kuptonin mësimin përmendësh të Kuranit Fisnik siç ndodh në ditët e sotme. Ata i mësonin dispozitat e ajeteve që i memorizonin dhe përpiqeshin për t’i praktikuar në jetën e përditshme. Informacioni që do të japim më poshtë është shumë e rëndësishëm nga aspekti i metodave që përdornin, ndiqnin dhe u jepnin përparësi sahabët e nderuar në lidhje me të kuptuarit e Kuranit.

Ibn Mes’udi (v. 32/652) dhe Ubej ibn Ka’bi (v. 19/640) transmetojnë se i Dërguari i Allahut (a.s.), u jepte atyre dhjetë ajete për t’i mësuar. Ata nuk kalonin te dhjetë ajete të tjera pa i mësuar dispozitat e dhjetë ajeteve të para dhe pa

i praktikuar ato. Resulullahu (a.s.), atyre bashkë me mësimin e Kuranit, u mësonte edhe të punuarit me Kuranin. Abdurrahman es-Sulemi (r.a.), transmeton: “Kur mësonim dhjetë ajete nga Kurani, nuk kalonim te mësimi i dhjetë ajeteve të tjera derisa t’i mësonim urdhrat, ndalesat, hallallin dhe haramin që përfshinin dhjetë ajetet e para.” Imam Maliku (v. 179/795) në veprën e tij me titull Muvatta thotë: “Sipas lajmit që më ka ardhur mua, Abdullah ibn Omeri (v. 73/692) është preokupuar tetë vjet me mësimin e sures Bekare.” Gjithashtu Imam Maliku transmeton se Omeri (r.a.), e ka mësuar suren Bekare për dy mbëdhjetë vjet. Kur e ka përfunduar, ka thënë një deve prej gëzimit. Ndërsa Abdullah ibn Mes’udi (r.a.), ka thënë: “Neve na dukej i vështirë mësimi përmendësh i fjalëve të Kuranit, por na dukej i lehtë zbatimi i tyre. Ndërsa atyre që kanë ardhur pas nesh po u duket i lehtë mësimi përmendësh i Kuranit dhe i vështirë zbatimi i tij.”

Siç shihet qartë, sahabët e nderuar i kanë mësuar bashkë fjalët dhe kuptimet e Kuranit Fisnik. Pastaj i kanë zbatuar menjëherë në jetë ato. Ata i kanë dhënë më shumë rëndësi zbatimit të Kuranit sesa këndimit të tij. Andaj edhe ne si myslimanë të paktën në muajin e Ramazanit le të përpiqemi ta kuptojmë Kuranin me fuqinë e emrit “Furkan” që na ka dhënë. Le të përpiqemi për ta bërë atë një libër që e zbatojmë në jetën tonë me begatinë e muajit të Ramazanit. Le të kërkojmë metodat për ta kuptuar se çfarë dëshiron të thotë dhe çfarë kërkon prej nesh.

■ **REFERENCAT:** 1) Shik. Bekare, 185. 2) Shik. Junus, 57. 3) Shik. Bekare, 2. 4) Lukman, 3. 5) Ragib el-Isfahani, Mufredatu Elfadhi’l-Kur’an, korrektio Safuan Andan Davudi, Bejrut, Daru’l-Kelam, fq. 366. 6) Shevkan, Muhammed b. Ali b. Muhammed, Fet’hu’l-Kadir el-Xhamiu bejne Fennejir-Rivajeti ve’d-Dirajeti min Ilmi’t-Tefsir, Tas’hih, Ahmed Abdusselam, Bejrut, 1994, I, 228. 7) Kerim Bulladë, Kur’an Kendisini Nasıl Tanıtır; Botimet Kajëhan, Stamboll, 2010, fq. 31. 8) Bekare, 185. 9) Furkan, 1. 10) Enfal, 29. 11) Bekare, 256. 12) Sad, 29. 13) Shevkani, vepra e lartpërmendur, IV, 537.



إِنْ شَاءَ اللَّهُ

# THONI NË DASHTË ALLAHU

— Adem Saraç —

Politeistët mekas, të cilët nuk kishin aq fat sa t'ia vinin veshin mesazhit universal të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), bënë çfarëdo që kishin mundësi për ta bërë atë të heshte apo për ta lënduar.

Njëra prej këtyre iniciativave të shëmtuara ishin tri pyetjet që ia bënë të Dërguarit të Allahut, (a.s.), përpara gjithë njerëzve duke u mbështetur te mendimi që kishin marrë nga çifutët:

1. Cila është e vërteta e aventurave të të rinjve që patën ardhur në kohët e hershme? Ata të rinj kanë përjetuar ngjarje shumë të habitshme!

2. Na njofto për atë njeriun që e ka shëtitur token nga lindja deri në perëndim!

3. Çfarë është shpirti? Si është ai?

Pejgamberi, (a.s.), u tha pa hezituari aspak:

*“Përgjigjet e pyetjeve për të cilat pyetët, do t’jua jap nesër!”<sup>1</sup>*

Asnjë prej njerëzve që ndodheshin aty nuk e bëri një pyetje të tillë:

“Përse nesër dhe jo tani?” Të gjithë ishin të

fokusuar te dita e nesërme sikur ishin të sigurt se kjo punë do të merrte fund nesër...

Por edhe pse kaluan pesëmbëdhjetë ditë nga kjo ngjarje, në lidhje me këtë çështje akoma nuk kishin ardhur ndonjë shpallje. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ngeli në situatë shumë të vështirë. Madje, edhe engjëlli i shpalljes, Hazreti Xhebraili, (a.s.), i cili vinte pothuajse çdo ditë, madje nganjëherë disa herë në ditë, nuk shihej gjëkund.

Pasi u formua mjedisi i fitnes / përçarjes, që mushrikët e donin më shumë se përgjigjet që kërkonin, organizuan argëtime për shkak të gëzimit të madh që ndjenin dhe bënë festë. Sipas mendjes së tyre, ata tashmë ishin fituesit, ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte mposhtur. Ata e ngritën në këmbë të gjithë Mekën sikur të kishin korrur ndonjë fitore madhështore. Sikur edhe kjo të mos mjaftonte, thashethemet e tyre ishin shumë lënduese. Ato ishin aq lënduese, sa që disa sahabëve po u sosej durimi. Vendi ishte tensionuar jashtë mase dhe çdo moment mund të ndodhte çdo gjë. Politeistët thoshin:

“Ky burrë, i cili thotë se është i Dërguari i Allahut, nuk e mbajti fjalën e dhënë. Edhe pse tha: “Nesër do t’ju jap përgjigje.” – akoma nuk ka dhënë ndonjë përgjigje, edhe pse kanë kaluar pesëmbëdhjetë ditë. Ose nuk mundet që t’u japë përgjigje pyetjeve tona. Siç nuk mundet t’u japë përgjigje tri pyetjeve që i kemi bërë, tashmë nuk mundet të dalë më edhe ndërmjet nesh. Ç’është kjo gjë kështu? Nga njëra anë thotë se është i Dërguari i Allahut, nga ana tjetër nuk u jep dot përgjigje pyetjeve tona. Me sa kuptohet, Zoti i tij e ka lënë atë. Ose ai gënjen kur thotë se është i Dërguari i Allahut. Nëse është i Dërguari i Allahut, atëherë, le të na japë përgjigje për pyetjet tona! Nëse nuk është, le ta marrin vesh të gjithë të vërtetën e kësaj çështjeje!”<sup>2</sup>

Fjalët e rënda që i thanë politeistët e Mekës e mërzitën shumë të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Atij i erdhi shumë rëndë si çdo njeriu që shtypet nga barra e rëndë e thashethemeve. Sa herë që dilte në rrugë për shkak të ndonjë pune apo të misionit që kishte, përballej me talljet e të gjithë mushrikëve, madje edhe të grave dhe të fëmijëve të tyre:

-Ti sikur ishe i Dërguari i Allahut!

Përse nuk e mbajte fjalën edhe pse the: “Nesër do t’u jap përgjigje.”

-Apo nuk je i Dërguari i Allahut?

-Mos vallë Allahu të ka braktisur?

Çfarë nuk thoshin! Thashethemet, ofendimet, talljet dhe përçmimet ishin të padurueshme. I Dërguari i Allahut, (a.s.), nga njëra anë i duronte këto gjëra të padurueshme dhe nga ana tjetër përpiquej të qetësonte sahabët e tij, por shqetësimet e politeistëve po bëheshin vazhdimisht edhe më të padurueshme.

Ndërkohë që vendi ishte i tensionuar seriozisht me çdo gjë, zbriti ndihma e Allahut dhe më së fundi i erdhi shpallja Resullullahut, (a.s.). Sapo erdhi shpallja, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i njoftoi politeistët.

Politeistët, të cilët bënë aleancë me çifutët për ta mposhtur të Dërguarin e Allahut, (a.s.), pas britmave dhe klithmave të fitores që zgjatën për pesëmbëdhjetë ditë me radhë, befasisht ranë në një zbrazëturë të frikshme. Ata e dinin se do të merrnin fund një herë e përgjithmonë nëse Hz. Pejgamberi do t’u jepte përgjigje pyetjeve të atyre. Por ja që, me guximin që ua jepte injoranca, përsëri e mblodhën të gjithë popullin në oborrin e Qabesë së Shenjtë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), shkoi në Qabe duke marrë me vete një pjesë prej sahabëve të tij. I gjithë vendi ishte i mbushur plot me politeistë. Për shkak se kishin kaluar pesëmbëdhjetë ditë, njëri prej liderëve të politeistëve doli dhe i përsëriti pyetjet në mënyrë që t’ua rikujtonte njerëzve:

-Kane kaluar pesëmbëdhjetë ditë nga koha kur ia kemi bërë pyetjet. Unë tani secilën prej pyetjeve do ta parashtroj përsëri. Ndërsa ai do të na japë përgjigje një e nga një. Pyetja jonë e parë ishte kjo:

“Cila është e vërteta e aventurave të të rinjve që patën ardhur në kohët e hershme? Ata të rinj kanë përjetuar ngjarje shumë të habitshme!”

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), doli në një vend të lartë për të folur, të gjithë u kthyen plotësisht nga ai. Askush nuk nxirrte edhe zërin më të vogël:

“Pyetja juaj e parë ka të bëjë me As’habu’l-Kehf / Banorët e Shpellës, domethënë, me djemtë e rinj që fjetën në shpellë<sup>3</sup>. Aventurat dhe ngjarjet e habitshme që përjetuan ata janë kështu. I Dërguari i Allahut, (a.s.), filloi t’u lexonte suren Kehf njerëzve të cilët po e dëgjonin me shumë kujdes dhe vëmendje:

**“Çdo lavd dhe falënderim i përket Allahut, i Cili i shpalli robit të Vet (Muhamedit) një Libër të dëlirë nga çdo shtrembërim, (një libër) të drejtë, për të paralajmëruar nëpërmjet tij, dënim të ashpër (për jobesimtarët) dhe për t’u dhënë lajmin e mirë besimtarëve, të cilët bëjnë vepra të mira, se për ta do të ketë një shpërblim të bukur (Xheneti), në të cilin do të qëndrojnë përherë, si dhe për të paralajmëruar ata që thonë: “Allahu ka një bir”.**

Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, as etërit e tyre. Sa fjalë e rëndë është ajo që del nga goja e tyre! Ata flasin vetëm gënjeshtër. A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kuran)? Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë. Dhe, Ne do ta bëjmë të shkretë gjithçka, që gjendet në të. Vallë, a mendon ti se banorët e Shpellës dhe Rakimit<sup>4</sup> ishin një çudi nga mrekullitë Tona?

Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë: “O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!” Ne ua mbyllëm veshët atyre (duke i lënë të flinin) në shpellë për shumë vjet. Pastaj i ngritëm, për të marrë vesh se cili nga të dyja grupet do ta vlerësonte më mirë sa kohë kishin qenë të strehuar. Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës.

Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcuam në rrugën e drejtë. Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës.

Ne nuk do t’i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe. Ky populli ynë ka zgjedhur në vend

të Tij zota të tjerë, ndonëse ata nuk u sjellin dot asnjë provë të qartë. E kush është keqbërës më i madh, se ai që trillon gënjeshtër për Allahun?

Kur ju t’i lini ata dhe gjithçka që adhurojnë në vend të Allahut, gjeni strehë në shpellë: Zoti juaj do t’ju mbulojë me mëshirën e Tij dhe do t’ju përgatisë mënyrën nga e cila do të keni dobi”.

Ti (o Muhamed) do ta kishe parë Diellin kur lindte, se si anohej nga e djathta e shpellës së tyre dhe, kur perëndonte, ata i linte në anën e majtë, ndërkohë që ata gjendeshin në mesin e saj. Kjo është nga shenjat e Allahut. Sa për atë, që Allahu e udhëzon në rrugë të drejtë, pikërisht ai është i udhëzuari.

E sa për atë, që Ai e lë në humbje, ti, me siguri, nuk do të mund t’i gjesh mbrojtës që ta udhëzojë. Dhe (po të kishe qenë atje), do të mendoje se ata ishin zgjuar, por ata ishin në gjumë.

Ne i rrotullonim ata herë në krah të djathtë e herë në të majtë, kurse qeni i tyre rrinte shtrirë me dy këmbët e para në hyrje të shpellës. Sikur t’i kishe parë, ti do të ikje nga ata dhe do të të kaplonte frika. Kështu pra, Ne i zgjuam që të pyesnin njëri-tjetrin.

Njëri nga ata tha: “Sa keni ndenjur (në gjumë?)” - U përgjigjën: “Kemi qëndruar një ditë a një pjesë të ditës”. Disa thanë: “Zoti juaj e di më mirë se sa keni ndenjur.

Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t’ju sjellë diçka prej tij, le të sillet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju. Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t’ju gjuajnë me gurë ose do t’ju kthejnë (me forcë) në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kurrsesi”!

Dhe kështu, Ne bëmë që ata të zbuloheshin, me qëllim që të dihej se premtimi i Allahut është i vërtetë dhe, që të mos ketë asnjë dyshim për Orën (e Kiametit, se ajo do të vijë). Kur ata (banorët e qytetit) po haheshin me njëri-tjetrin për këtë rast, disa thoshin: “Ndërtojini atyre (në hyrje të shpellës) një ndërtesë! Zoti i tyre i njeh më mirë ata”. Ata që e fituan çështjen e tyre, thanë: “Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta!” Do të thonë: “Ata ishin tre veta e qeni i tyre ishte i katërti”. Disa do të thonë: “Ata ishin pesë veta e qeni i tyre ishte i gjashti”,

**duke hamendësuar për atë që është e fshehtë; kurse të tjerë do të thonë: “Ata ishin shtatë veta e qeni i tyre ishte i teti”.**

**Thuaj** (o Muhamed): **“Zoti im e di më mirë numrin e tyre. Vetëm pak veta dinë diçka rreth tyre”. Dhe mos polemizo rreth tyre, përveçse në mënyrë të përciptë dhe për ata mos pyet askënd! Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: “Me siguri që nesër do ta bëj këtë”, pa shtuar “Në dashtë Allahu!” Dhe, kur të harrosh (të thuash “në dashtë Allahu”) - kujtoje Zotin tënd e thuaj: “Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo”. Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore). Thuaj (o Muhamed): “Allahu e di më mirë sa kanë qëndruar. Atij i përket fshehtësia e qiejve dhe e Tokës. Eh, sa mirë sheh Ai çdo gjë dhe sa mirë që dëgjon! Njerëzit nuk kanë tjetër mbrojtës përveç Atij dhe Ai nuk e ndan me askënd pushtetin e Vet.” (Kehf, 1-26)**

Për herë të parë ishin mbledhur kaq shumë njerëz dhe për herë të parë po dëgjonin me kaq shumë seriozitet. Liderët politeistë, të cilët po përjetonin gjendje shoku nga habia, pa humbur aspak kohë, menjëherë dolën te pyetja e dytë.

Pyetja jonë e dytë ishte kjo:

“Na njofto për atë njeriun që e ka shëtitur tokën nga lindja deri në perëndim!”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u kthye nga liderët politeistë dhe nga populli që po e shikonin me një kureshtje, e cila sa vinte e shtoej dhe tha:

“Pyetja juaj e dytë ka të bëjë me Dhulkarnejnin, (a.s.). Historia e tij është kështu:

Pejgamberi, (a.s.), lexoi pjesën në lidhje me Dhulkarnejnin (a.s.), nga surja Kehf:

**“Ata (hebrenjtë) të pyesin ty (Muhamed) për Dhulkarnejnin, thuaj: “Unë do t’ju tregoj disa lajme për të.” Ne i dhamë atij mundësi në Tokë dhe i dhamë mjete e rrugë për të arritur çdo gjë, kështu që ai u nis në një rrugë. Kur arriti në vendin e perëndimit të Diellit, pa se ai po ulej në një burim të zi balte dhe në afërsi të tij gjeti një popull. Ne thamë: “O Dhulkarnejn, mund t’i ndëshkosh ata ose mund t’u bësh mirë atyre.” Ai tha: “Sa i përket atij që bën të këqija, Ne do ta ndëshkojmë e pastaj do të kthehet te Zoti i vet, i Cili do ta ndëshkojë me një dënim të rëndë. Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe do t’i premtojmë atij lehtësira.” Pastaj ndoqi një rrugë tjetër. Kur arriti në vendin e lindjes së Diellit, Ai e pa të lindte mbi një popull, të cilit Ne nuk i kishim dhënë gjë, për t’u mbrojtur nga dielli. Kështu ndodhi dhe Ne dinim gjithçka për të. Pastaj mori një rrugë tjetër. Derisa, kur arriti në mes dy malesh, gjeti rrëzë tyre një popull, i cili pothuaj nuk kuptonte asnjë të folme.” (Kehf, 83-93)**

Përsëri të gjithë po dëgjonin pa nxjerrë zë. Liderët e politeistëve, të cilët ranë në një humbje të madhe dhe të frikshme, ngaqë nuk kishin rrugë tjetër, kaluan te pyetja e tretë:

Pyetja jonë e tretë ishte kjo:

“Çfarë është shpirti? Si është ai?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), kësaj pyetjeje i dha një përgjigje shumë të shkurtër me një ajet fisnik:

***“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”*** (Isra, 85)

Pastaj u tha me një ton zëri të lartë:

***“Kështu më janë shpallur përgjigjet e pyetjeve që më keni bërë!”***

Përgjigjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i gëzuan pa masë myslimanët. Ndërsa mushrikët po përjetonin një humbje të tmerrshme. Tradhtarët, të cilët nuk lanë gjë pa bërë dhe fjalë pa thënë përgjatë pesëmbëdhjetë ditëve, tani po heshtnin.

Ndërsa tani le të kërkojmë pak për përgjigjen e pyetjes: “Përse u vonua shpallja kaq shumë?” Në të vërtetë, nuk ka ndonjë gjë për të kërkuar, sepse literatura islame dhe veçanërisht librat e tefsirit, kanë dhënë informacion mjaft të gjerë në lidhje me këtë çështje.<sup>5</sup>

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha mushrikëve: “Nesër do t’ju jap përgjigje!” – nuk pati thënë “inshallah”. Këtu nuk kishte ndonjë synim të keq, por ja që nuk pati thënë “inshallah”, domethënë, “nëse do Allahu”.

Ngaqë Allahu i Madhëruar është shumë i mëshirshëm kundrejt robërve të Tij, na tregon me këtë shembull se si duhet të veprojmë kur të themi ndonjë fjalë apo kur të bëjmë ndonjë gjë. Meqë i Dërguari i Allahut, (a.s.), është i pari që i drejtohet kjo këshillë, do të thotë se Allahu Teala nuk e ka përrjashtuar as atë në lidhje me këtë çështje. Ndërmjet ajeteve që erdhën si përgjigje për pyetjet që bënë politeistët, gjendej edhe ajeti qortues i cili thotë:

***“Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: “Me siguri që nesër do ta bëj këtë”, pa shtuar “Në dashtë Allahu!” Dhe, kur të harrosh (të thuash “në dashtë Allahu”) - kujtoje Zotin tënd***

***e thuaj: “Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo.”*** (Kehf, 23-24)

Kjo është njëra anë e ngjarjes.

Tani le të vijmë te mesazhi i duhur...

Ardhja e përgjigjes dhe drejtimi i mushrikëve ndaj kësaj përgjigjeje pas pritjes së gjatë të shpalljes që u vonua, siç e mbajti çështjen në rend të ditës përgjatë pesëmbëdhjetë ditëve, edhe shpalljen që erdhi e bëri influencuese në dimensionet serioze mbi të gjithë, sepse përgjigja erdhi pikërisht në një kohë kur nevoja ishte emergjente. Në këtë mënyrë, ndikoi së tepërmi në zemrat e njerëzve.

Nëse mund ta shprehim kështu, Allahu dhe i Dërguari i Tij ua shkatërruan kurthet politeistëve të Mekës, sepse ata patën folur shumë në lidhje me këtë ngjarje.

Ndërkohë që liderët e politeistëve mekas e ngacmonin Pejgamberin, (a.s.), nuk arrinin të bënin asgjë kundrejt shpalljes që vinte. Pasi nuk u ngeli asnjë rrugëzgjdhje, hidhnin shpifje të shëmtuara duke thënë: “Ai i ka shpikur vetë këto!” Pasi përgjigja e pyetjeve që patën bërë ata nuk erdhi për pesëmbëdhjetë ditë, filloi të ngjallej mendimi: “Kurani Fisnik është dërguar nga Allahu!” Sepse, po të ishte në dorën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të jepte përgjigje menjëherë!

Krahas të gjithave këtyre, të gjithë mushrikët me në krye liderët e tyre, për herë të parë po dëshmonin një mbledhje kaq serioze. Allahu i Lartësuar, i Cili e vonoi kaq shumë shpalljen, absolutisht e çdo gjë e bën sipas një caktimi.<sup>6</sup>

Po... Edhe ne nuk duhet të harrojmë të themi “Inshallah” kur të japim ndonjë fjalë apo kur të premtojmë për të bërë ndonjë punë, sepse qortimi në ajetin e mësipërm i përfshin të gjithë myslimanët. Edhe i Dërguari i Allahut kështu na ka lajmëruar.

Sallallahu alejhi ve sellem...

■ **REFERENCAT:** 1) Ibn Sejjidu'n-Nas, Ujunu'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve's-Sijer, vëll. 1, fq. 108-19. 2) Ali Muhammed Sal-labi, islam Tarihi Asr-i Saadet Dönemi, vëll. 1, fq. 293. 3) Banorët e Shpellës ishin disa të rinj monoteistë, të arratisur nga qyteti i tyre, për t'i shpëtuar persekutimit të një tirani pagan, që donte t'i detyronte të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Për të ruajtur pastërtinë e këtij besimi, ata u strehuan në një shpellë jashtë qytetit dhe iu dorëzuan mëshirës hyjnore. Allahu i Madhëruar i bëri të flenë për treqind vjet dhe i zgjoi, kur gjendja në qytet kishte ndryshuar: banorët e tij ishin bërë monoteistë dhe qyteti qeverisej nga një mbret i urtë e i devotshëm. Ringjalljen e tyre Allahu e bëri mrekulli për banorët e qytetit (dhe për tërë njerëzimin) që vërtetonte ringjalljen e plotë, ngaqë ata ishin ndarë në dy grupe: njëri grup thoshte se ishte veç shpirti ai që ringjallej, kurse grupi tjetër thoshte se ringjallej edhe trupi. 4) Rakim mund të jetë emri i një lumi që kalonte pranë Shpellës ose një tabelë në hyrje të Shpellës me emrat e banorëve të saj, ose emri i qenit të tyre. 5) Taberi, Tefsir, vëll. 15, fq. 191-192; Fahreddin er-Razi, Tefsir, vëll. 21, fq. 82; Kurtubi, Tefsir, vëll. 10, fq. 346-347; Ebu'l-Fida Ibn Kethir, Tefsir, vëll. 3, fq. 71-72. 6) Muhammed Ebu Zehra, Son Peygamber Hz. Muhammed (sav), vëll. 2, fq. 132-136.

# THELBI I MORALIT ISLAM

— Xhafer Durmush —

Në ajetin fisnik, i cili përmbledh kornizën e besimit dhe moralit të besimtarëve, thuhet: ***“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë*** (në adhurim); ***silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin*** (që ka mbetur ngushtë) ***dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.***” (Nisa, 36.)

Fakti që ky ajet fisnik vjen menjëherë pas ajeteve që përmbajnë rregullat për sigurimin e paqes familjare, është i rëndësishëm. Siç shprehet në literaturën e tefsirit, të qenit rob ndaj Allahut Teala e bën të domosdoshëm posedimin e një morali të tillë. Ata që u bëjnë padrejtësi krijesave të Allahut, zullumqarët, koprracët dhe ata që u bëjnë të këqija të gjithëve, nuk mund të bëhen robër të pranuar te Allahu Teala vetëm ngaqë kryejnë disa ibadete. Ajeti fisnik që përbën temën tonë, na tregon esencën e moralit Islam. Një mysliman së pari duhet të pastrohet nga cilësitë e këqija dhe të përpiqet të brendësojë virtytet që radhitëm këtu. Pastaj duhet të përpiqet t'i përsosë këto virtyte.

Në ajetin e mësipërm, janë shtjelluar marrëdhëniet njerëzore të cilat gjenden ndërmjet temave kryesore të sures Nisa, sepse në një shoqëri që përbëhet nga individë që i besojnë Allahut dhe e adhurojnë Atë, gjithmonë marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të saj duhet të ndërtohen mbi mirësi. Nisur nga kjo, sjellja me mirësi kundrejt atyre që u përmenden në ajetin fisnik, me në krye prindërit, përbën bazën e moralit Islam. Për këtë arsye, prindërit janë ata që meritojnë më së shumti të gjitha sjelljet e bukura të myslimanit, të cilat përfshihen nga koncepti i mirësisë. Pas prindërve kjo çështje vazhdon të zgjerohet në formë rrathësh, siç është përmendur edhe në ajetin fisnik.

Tashmë dëshirojmë të themi disa fjalë në lidhje me një pikë që është e rëndësishme po aq sa mbrojtja e të drejtave të jetimit dhe sjellja me mirësi ndaj të varfërve, e cila lidhet me të drejtat e fqinjit. Këtu para së gjithash duhet të mendojmë se si duhet ta kuptojmë në ditët e sotme urdhrin që ajeti fisnik jep për fqinjin e afërt dhe atë të largët. Në literaturën e tefsirit thuhet: “Konceptet afër dhe larg vlerësohen sipas rregullave nëse ka apo jo lidhje farefisnore, ose nëse është apo jo mysliman personi.” Këtë sqarim sot mund ta shpjegojmë në formën: “Besimtarët e ndjejnë në zemrat e tyre çdo vuajtje për të cilën kanë dijeni.”, sepse në ditët e sotme është e mundur që t'i arrijmë dhe t'u dërgojmë ndihmë nevojtarëve që mund të gjenden në cilindo vend të botës. Fjalën “fqinj”, që përmendet në ajetin fisnik, besojmë se duhet ta shqyrtojmë në një mënyrë më gjithëpërfshi-

rëse, duke u bazuar në këtë këndvështrim. Këtu do të ishte shumë e dobishme që t'ju kujtojmë hadithin që i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, e ka thënë për të shpjeguar bashkimin që duhet të formohet dhe mbrohet në kuptim të gjerë në shoqëri:

*“Besimtarët i ngjajnë një trupi në dashurinë kundrejt njëri-tjetrit, në keqardhje ndaj njëri-tjetrit dhe në mbrojtje të njëri-tjetrit...”* (Buhari, Edeb, 27.) Gjithashtu, në një hadith tjetër, i cili mund të jetë frymëzim për ne, thuhet: *“Beto hem në Allahun, me lejen dhe fuqinë e të Cilit jetoj, se besimtari është si bleta që ha gjëra të pastra, prodhon gjëra të pastra dhe që nuk e prish vendin në të cilin gjendet.”* (Ahmed ibn Hanbel, Musned, 2/199.) Ne besojmë se ky hadith fisnik duhet të kujtohet shpesh dhe veçanërisht duhet të meditohet rreth tij, sepse aty është shprehur në një formë të mrekullueshme ngjashmëria ndërmjet besimtarit dhe bletës, dhe janë vënë në pah burimet prej të cilave ushqehet myslimani dhe veprimet e hijshme e plot delikatesë që ai kryen. Bleta ulet në lule, merr atë që ka për të marrë (nektarin) dhe largohet pa dëmtuar asgjë, ndërkohë plotëson edhe lulen. Në këtë mënyrë, bëhet shkak për prodhim dhe begati. Bleta mund të çojë mirëqenie dhe begati në vende të largëta nëpërmjet grimcave të vogla që ngjiten në këmbët e saj...

Në fjalinë e fundit të ajetit që përbën temën tonë, thuhet: **“...Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë.”** Domethënë se njerëzit arrogantë dhe mburravecë që nuk i do Allahu Teala, nuk shqetësohen për t'i kryer përgjegjësitë njerëzore për të cilat u fol më lart. Ata që e perceptojnë detyrën e tyre, janë njerëzit modestë që mund të thonë: “Allahu është poseduesi i çdo gjëje.” Ata që mburren, siç janë larg vetëdijes për të qenë rob i Allahut, në kuptimin e vërtetë të fjalës, po ashtu nuk konsiderohet se kanë shpëtuar plotësisht prej shirkut, i cili ndalohej në fillim të ajetit. Nisur nga këto që thamë, ata që përpiqen për t'i ndihmuar njerëzit e afërt dhe të largët, sigurisht që duhet të qëndrojnë larg mburrjes, sepse ata që mburren nuk mund të përfitojnë prej këtyre cilësive të bukura. Pra, besimtari është ai njeri që e adhuron Allahun Teala, larg shirkut, si posedues i një besimi të vërtetë dhe i cili është i vetëdijshëm për përgjegjësitë kundrejt robërve të Allahut (xh.xh.). Besimtari është dora që jep, që i ndan gjërat me të tjerët dhe gjendet prezent kudo që ndjehet nevojë për të. Kjo çështje nuk kufizohet vetëm në aspektin material. Besimtari është një njeri që buzëqesh kur jep. Ai kthehet në burim shprese për të tjerët, pa e prerë shpresën e tij nga Allahu Teala edhe kur kaplohet nga terri e sprova.

## BAZA E MORALIT TË ULËT

Në suren Nisa, thuhet: “(Allahu nuk i do as) **ata që janë koprracë, të cilët kërkojnë që edhe të tjerët të bëhen koprracë dhe fshehin atë që ua ka dhuruar Allahu nga mirësitë e Tij. Ne kemi përgatitur për mohuesit ndëshkim poshtërues.** (Ai nuk i do) **as ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë Allahun e as Ditën e Kiametit. Ai që ka për shok djallin, dihet se sa shok i keq është** (djalli)!” (Nisa, 37-38.)

Në ajetin para këtyre thuhet: **“...Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë.”**, dhe radhiten cilësitë e padëshiruara te Allahu (xh.xh.). Cilësia e dytë është koprracia. Koprraci do të thotë që të mos u japësh krijesave të Zotit (xh.sh.), prej mirësive që t'i ka dhënë vetë Allahu. Allahu i Lartësuar, njerëzit e tillë i kërcënon me një ndëshkim poshtërues, i cili është përgatitur për qafirët.

Edhe një grup tjetër që Allahu Teala nuk e do, përbëhet prej atyre që e harxhojnë pasurinë për sy e faqe të botës, në mënyrë që të tjerët t'i lavdërojnë. Këtë e bëjnë ngaqë nuk kanë ndonjë shpresë për Ahiretin, apo ndoshta ngaqë nuk besojnë plotësisht. Allahu i Lartësuar nuk i pranon veprat në të cilat ka shtirje.

Siç e dimë, Allahu Teala nuk i do zullumqarët, shpërdoruesit dhe prishësit. Ai nuk i do mendjemëdhenjtë, tradhtarët dhe ata që e kalojnë cakun. Zoti (xh.sh.), nuk do asgjë që është shenjë e moralit të ulët. Në krye vijnë mendjemadhësia, koprracia dhe shtirja. Me sa duket, këto janë burimi i cilësive të këqija dhe burimi i pasioneve që e bëjnë njeriun skllav të nefsit dhe lodër të shejtanit.

Në këtë kohë kur egoizmi është në pikën kulmore, përkujtimi që gjendet në ajetet e mësipërme mbart një rëndësi të jashtëzakonshme.

# AFTËSIA PËR TË NDARË TË DREJTËN NGA E GABUARA

— Ajnur Tutkun —

Për ta gjetur të vërtetën (të drejtën) dhe për të qëndruar në anën e saj, është e nevojshme edhe dija, edhe nijeti i mirë. Qëllimi nga nijeti i mirë nuk është kënaqësia e egos, por kërkimi i dijes për të arritur te e drejta! Ai që nuk ndjen nevojë për shprehje të tilla si: “Sa shumë i ditur që qenka!”, “Ky njeri di shumë!”, “Një njeri i ditur dhe i mrekullueshëm!”, ai që shqetësohet në vend se të kënaqet nga këto komplimente që i bëjnë, është njeri me nijet të mirë. Njerëzit që kanë nijet të mirë dhe që janë të ditur, nuk e kanë shumë të vështirë ta gjejnë të vërtetën apo të qëndrojnë mbi atë të vërtetë pasi ta gjejnë.

Edhe pse në ditët e sotme duket sikur është

shumë e lehtë arritja e dijes, çdo dije që mund të arrihet nuk e shpie njeriun te e drejta apo e vërteta, madje mund ta shpjerë më lehtë te e gabuara. Ja, për këtë arsye, burimet e dijes themelore që na bëjnë ta gjejmë të drejtën pas nijetit të mirë (revelata hyjnore / Kurani Fisnik dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut) janë gjërat e para që duhet t'i ketë çdo njeri. Në të kundërt, privimi nga dija themelore që e bën njeriun ta dallojë të drejtën nga e gabuara, e shpie njeriun në gabime që i pëlqejnë nefsit edhe nëse bëhet fjalë për çështje që kanë lidhje me fenë.

Privimi nga burimet e dijes themelore që mbështeten te revelata hyjnore, gjithmonë dhe në çdo rrethanë e bën dijen të pabesueshme /



të pasigurt. Madje, edhe mendja dhe shkenca që është produkti më i vlefshëm i mendjes, gjithmonë nuk janë të sakta qind për qind. Ndërkohë që mjekët thoshin: “Duhani shkakton vetëm kollitje.” – rreth viteve 1950 në Amerikë, sot është vërtetuar se mund të na çojë deri në vdekje. Po ashtu, edhe hipotezat e dikurshme se veza e rrit kolesterolin, tashmë nuk kanë më vlerë për shkak të zbulime që kanë vërtetuar të kundërtën. Domethënë se mendje dhe shkenca që është produkt i mendjes mund të gabojnë. Ndërsa shpallja hyjnore nuk gabon asnjëherë! Ai që gabon është njeriu që nuk e komenton saktë shpalljen hyjnore, ose që e komenton mangët, ose që nuk e kupton fare atë.

Ja pra, animi nga gabimi dhe kryerja e asaj që është gabim në shoqëritë myslimane të ditëve të sotme edhe nëse bëhet fjalë për fenë, më së shumti burojnë nga privimi prej dijeve themelore. Një njeri që i posedon burimet e dijes themelore, nuk gabon aq lehtë, por edhe nëse gabon, e kupton gabimin, është i vetëdijshëm se mund të gabojë dhe më e rëndësishmja, përpaket ta rregullojë gabimin që ka bërë.

Rreziku më i madh i njerëzve që nuk u pëlqen të lexojnë është besimi ndaj çdo gjëje që dëgjojnë ose përvetësimi në mënyrë ekstreme i çdo gjëje që besojnë. Njerëzit që mendojnë se janë ekspertë të çështjes në lidhje me të cilën kanë lexuar dy-tre libra, përbëjnë një numër mjaft të konsiderueshëm. Ndërkohë të lexuarit është vetëdija për ta kuptuar oqeanin e madh të dijes. Njeriu që përpaket vazhdimisht për të mësuar ato që nuk i di, arrin mundësinë për të gabuar më pak. Ndërsa pagabueshmëria në fakt është në kundërshtim me natyrshmërinë e njeriut.

Ndikimi / mashtrimi i njerëzve që janë të privuar nga burimet themelore që mbështeten në shpalljen hyjnore nuk është shumë i vështirë. Veçanërisht në çështjet që kanë lidhje me besimin (si rezultat i shkaqeve që burojnë nga merakuri që ndjehet ndaj botës së padukshme që është plot me fshehtësi), njeriu e ka shumë më të lehtë që të gabojë. Për këtë arsye, kushti më themelor për të poseduar një besim të vërtetë dhe që nuk përmban devijim, besëtytni dhe kufër, është njohja e burimeve të shenjta të paktën në nivelin më të ulët.

Të gjithë ata që kanë kryer shkollën dhe thonë

se janë myslimanë, të paktën duhet ta lexojnë një herë Kuranin Fisnik bashkë me komentimin e tij dhe ndonjë libër të hadithit bashkë me shpjegimin e tij si për shembull, Rijazu’s-Salihin apo Texhridi Sarih. Ndërsa ata që nuk kanë një nivel të mjaftueshëm edukimi, të paktën duhet t’i dinë mirë gjërat që janë të lejuara dhe të ndaluara në jetën e përditshme. Pastaj, kur të përballen me ndonjë çështje që nuk kanë dijeni për të, duhet ta mësojnë nga njerëz ose literatura të besueshme.

Sigurisht se e gjithë çështja është personi i sigurt dhe burimi i sigurt. Siç nuk janë të qëndrueshme nganjëherë ato që thonë doktorët duke marrë për referencë shkencën e shkencëtarëve në lidhje me çështjet e shkencës, edhe në çështjet fetare nganjëherë nuk ka qëndrueshmëri në ato që thonë ata që flasin duke marrë për referencë burimet fetare. Edhe nëse të gjithë marrin për referencë fenë dhe mendjen, prapë se prapë rezultatet mund të jenë shumë të ndryshme. Ndërsa për të mos gabuar në çështjen e hallallit-haramit dhe besimit-mohimit, siç e shprehëm që në fillim, hyn në funksion nijeti i mirë. Të thuash: “Çdo pikëpamje që nuk ushqen egon është e vërtetë / e drejtë.” – mund të jetë e drejtë.

Njerëzit që nuk presin komplimente, që nuk kaplohen nga mendjemadhësia për shkak të grupit të atyre që i rrethon, që nuk përpiken me insistim për të vërtetuar veten dhe bindjet e tyre, që nuk përpiken për të theksuar sa herë t’u jepet mundësia se grupet e tjera kanë mangësi dhe se vetë janë shumë të mirë, që nuk janë të mbushur me ambicien për të arritur në kolltukë dhe pozita të caktuara, që shfaqin shumë kujdes për të mos u bërë mediatikë dhe që përpiken vetëm e vetëm për t’i dhënë vetes e të tjerëve prehje shpirtërore, është ashikare se janë njerëz të besueshëm. Shfaqja e kujdesit ndaj këtyre pikave mund të jetë e dobishme për t’i gjetur njerëzit e sigurt.

Përveç të tjerash, kërkimi i ndihmës me gjithë zemër nga Allahu i Lartësuar, siç përmendet edhe në suren Fatiha që e këndojmë në pesë kohët e namazeve përgjatë ditës dhe në fund të lutjeve tona, duke u lutur në formën: **“O Zot! Na udhëzo në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhënë mirësi!..”** – ndoshta mund të jetë gjëja më e domosdoshme për të mos gabuar.



# PRANOJENI ISLAMIN ME TË GJITHA RREGULLAT E TIJ

— Mustafë Asim Kyçkashçi —

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: ***“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë.”*** (Haxh, 11)

***“Por ata (popuj ku u çuan të dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.”*** (Mu'minun, 53)

Në ajetin paraardhës të ajetit të mësipërm theksohet bashkimi para përçarjes: ***“Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje!”*** (Mu'minun, 52) Përçarja është një dallgë shkujdesjeje, që të shpie në shkatërrim: ***“(O i Dashuri im!) Andaj, lëri ata në padijen (shkujdesjen e hutimin) e tyre për një farë kohe!”*** (Mu'minun, 54) Ky ajet është edhe një shpjegim i qartë që sqaron se si janë prishur fetë në të kaluarën...

Mesazhi është i qartë: Njerëzit duhet t'i besojnë Allahut nga të gjitha aspektet... Ata duhet ta ndjekin Sunetin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), nga çdo aspekt dhe nuk duhet të tentojnë të zgjedhin disa pjesë të caktuara prej tij. Kjo është tejet e rëndësishme.

Ndërmjet kushteve të leximit të Kuranit në namaz na del përpara një detaj: Nëse në rekatin e dytë nuk lexohet surja që pason suren që kemi lexuar në rekatin e parë, por e kalojmë atë dhe lexojmë një tjetër, është mekruh. Të shfaqurit e një tabloje sikur e kalon qëllimisht atë sure, nuk është konsideruar si diçka e pëlqyeshme. Andaj, njerëzit duhet të hyjnë brenda kornizës së Islamit duke i pranuar të gjitha dispozitat e tij siç thuhet edhe në ajetin fisnik: ***“O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar.”*** (Bakara, 208) Në të kundërt, veprat që bëhen, edhe pse mund të kenë referencë nga një aspekt prej Kuranit dhe Sunetit, gjithashtu kanë edhe aspekte të tjera që bien në kundërshtim dhe përplasen me dispozitat e fesë islame. Kjo dobësi del më shumë në pah veçanërisht nëse bëhet fjalë për një medh'heheb apo profesion, sepse një shoqëri e tregon veten me gjërat e ndryshme të saj. Për shembull, në jurisprudencën islame shkolla e Kufës dhe ajo e Medines sigurisht se ndahen nga njëra-tjetra me aspektet që u japin më shumë rëndësi. Njëra i jep më shumë rëndësi mendjes (akl), ndërsa tjetra i jep transmetimit (nakl)... Por ja që as Kufa nuk e la naklin dhe as Medina nuk e la aklën... Ndryshi-



mi që kanë ndërmjet tyre më shumë ka lidhje me logjikën dhe parimet e sistemit. Domethënë, atë që njëra e ka vendosur në radhë të parë, tjetra e ka vendosur në radhë të dytë. Për këtë arsye, që të dyja kanë një kible dhe një drejtim: Islamit e vërtetë...

Por ja që kur fraksioni Mutezile mohoi kaderin dhe fraksioni Xhebrije mohoi vullnetin, i morën vetëm disa prej ajeteve dhe haditheve. Në këtë mënyrë, bënë përzgjedhje të njëanshme të tyre. Si rezultat, e humbën tërësinë, unitetin dhe bindjen ndaj fesë nga çdo aspekt. Prandaj, një ndryshim milimetrik i istikametit në fillim është e qartë se çfarë devijimesh shkakton në synim. Për këtë arsye, qasjet e njëanshme dhe që janë mjaftuar me atë që kanë zgjedhur, kanë rezultuar me devijim. Le të japim disa shembuj konkretë:

Dikush i jep më shumë rëndësi çështjes së urdhrit të fesë për xhihad. Nisur nga kjo, feja për atë është xhihad. Madje edhe xhihad është vetëm xhihadi konvencional (nëse mund të shprehemi kështu). Si rezultat, lind një lëvizje rinore që hedh slogane dhe që bën aksione. Vetëm vetëdijesim, reagim, rezistim... Në këtë mënyrë, e mbushin tepër cilësinë “të ashpër kundrejt kafirëve” dhe e shndërrojnë këtë në gjendjen e një sjelljeje që pothuajse reflekton ndaj të gjithë besimtarëve dhe kafirëve... Pra, e çojnë deri aty sa bëhen të ashpër edhe kundrejt besimtarëve që nuk bëjnë xhihad si ata!

Dikush tjetër kapet pas mesazheve të rezistimit pasiv të fesë. Durim, vonim, tolerancë, dialog, falje... Sipas këtij këndvështrimi xhihadi është vetëm “përpjekje”. Te këta sundon mendimi i të jetuarit bashkë dhe ai i shumicës. Ata kanë një tolerancë aq të madhe, saqë pothuajse mund të kërkojnë ndjesë për shkak të besimit të tyre. Ata duan ta shndërrojnë njeriun në zog para se t’i predikojnë fenë.

Që të dyja këto lloj lëvizjesh sigurisht kanë pika që i kanë marrë si referencë, por ja që këto janë pika të përzgjedhura e të njëanshme siç paralajmëron edhe ajeti fisnik...

Në Kuran, Sunet dhe në sijeru’n-Nebi, që mund ta quajmë përvojë e epokës së lumturisë është përjetuar një periudhë në të cilën aspak nuk është lejuar lufta, por gjithashtu janë përjetuar edhe periudha në të cilat të gjithë kanë shkuar në xhihad... Andaj, nëse çështjet i analizojmë duke i marrë parasysh të gjitha, do të arrijmë në rezultate të duhura. Sigurisht se në shembullin që ka lidhje me epokën e lumturisë nuk gjenden problemet që po i shohim sot, sepse, ndërkohë që ata i përkisnin periudhave të përkohshme të një procesi, sot po flasim për praktikën e gabuar të atyre që marrin si model vetëm një prej praktikave të asaj kohe dhe ndërtojnë një sistem mbi të. Për shembull, edhe parimi i “Tedrixhit” mund të keqpërdoret. Tedrixh nuk do të thotë të fshehësh esencën e mesazhit dhe ta mashtrosh bashkëbiseduesin e tij (njeriun) në çështjen e asaj që e fton ai mesazh. Kur te flasim për Tedrixhin, në mendje duhet të na vijë ndalesa e alkoolit. Po, kjo ndalesë është plotësuar në katër shkallë dhe katër vite pas hixhretit. Por i Dërguari i Allahut (a.s.), e vinte në pah qëndrimin e tij duke mos pirë aspak alkool. Edhe Ebu Bekri (r.a.), i cili ishte prej shokëve të tij më të afërt, nuk ka pirë fare alkool. Kështu, alkooli ishte hequr de facto. Edhe mbulesa është bërë farz (obligim) në vitin e pestë të hixhretit, por le të shohim edhe këtë shembull që është përjetuar para hixhretit dhe që tregon edhe vuajtjet që ka hequr i Dërguari i Allahut (a.s.), gjatë predikimit. Mudrik el-Ezdi tregon:

“Bashkë me babain tim po bëja haxhin (e xhahilijetit). Pasi shkova në Mina dhe u vendosa aty, u takova me një grup njerëzish. Babain e



pyeta: “Përse është mbledhur ky grup?” Ai më tha: “Janë mbledhur për atë njeri që e ka lënë fenë e popullit të tij.” Kur i hodha sytë nga ana që ma bëri me shenjë, pashë të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Ai po thoshte: “O njerëz! Thoni la ilahe il-la’ll-llah, në mënyrë që të shpëtoni!” Dikush prej njerëzve e pështynte në fytyrë, dikush i hidhte dhé në kokë dhe dikush tjetër e ofendonte. Kjo situatë vazhdoi deri në drekë. Në ato momente erdhi një vajzë, së cilës i ishte hapur jaka, me një enë uji dhe një shami në dorë. Ajo po qante. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), piu ujë nga ena dhe i lau duart e fytyrën. E ngriti kokën dhe i tha:

*“Bija ime! Mbuloje jakën me mbulesën tënde! Mos u frikëso për babain tënd me mendimin se do të bjerë në kurth, do të vritet apo do të poshtërohet!”* Ne pyetëm se kush ishte ajo vajzë. Na thënë: “Ajo është vajza e tij, Zejnebja.” (Hejsemi, VI, 21.) Ja mbulesa... Akoma nuk kishte një shoqëri besimtare apo një shtet që të udhëhiqej nga jurisprudenca islame, por mbulesa ishte. Për këtë arsye, tedrixhin duhet ta kuptojmë drejt.

Çfarë ndodh nëse nuk e kuptojmë saktë tedrixhin? Në pah del një fe e cunguar me mesazhe të përzgjedhura. Apo siç shprehet edhe Kurani Fisnik, në pah del një fe që është humbje si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër për njerëzit. Nëse një praktikë që i përket një procesi përgjithësohet, gjërat që kanë zënë vend në kohën e epokës së lumturisë nuk mund të zënë vend dot në këtë strukturë të njëanshme. Dje janë dhënë fetva për të shpëtuar nga ndalesa e shamisë së kokës nëpër universitete. Tani nuk është më një ndalesë e tillë, por përsëri ka prej atyre që nuk e mbulojnë kokën edhe pse janë besimtare. Atyre u thuhet: “Dje keni përdorur këtë leje (në fjalë) për të hyrë si studente nëpër universitete, ndërsa tani do ta përdorni për të hyrë si pedagogë!.. Sidoqoftë, kjo nuk është një çështje besimi!.. Mos vallë të ngelin bosh ato vende? Pastaj urdhri i mbulesës ka zbritur shumë vonë...” Ja pra, kjo nuk është feja që ka predikuar Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Tani le ta shtjellojmë çështjen nga një këndvështrim i ndryshëm:

Me të vërtetë, a nuk është vepra një çështje besimi?

Me të vërtetë, lidhja besim-vepër është një fushë që ka rënë viktimë nga shtrëngimet e njëanshme. Nëse e merrni për bazë një-rën prej këtyre shtrëngimeve (metodave) të njëanshme, përsëri e ngushtoni fenë apo e nxirrni nga rrjedha e saj. Cilat janë këto metoda të ndryshme:

1. Metoda frikësuese / thirrje për teistikameti: Në këtë metodë vepra dhe besimi shfaqen si një tërësi. Për shembull:

“Ai që bën zina (imoralitet), e nxjerr këmishën e besimit kur e bën këtë mëkat të madh. Mëkatet e mëdha janë vepra të qafirëve. Ai që ka mendjemadhësi në zemër qoftë edhe sa një grimcë, ai që i përgojon të tjerët, etj., nuk mund të hyjë në xhenet.” Kur në këtë metodë frikësuese bëhet fjalë për besimtarin, flitet për një besimtar të përsosur. “Nëse njeriu nuk do për vëllain e tij atë që do për vete, ai nuk është besimtar.” Këto mendime i paralajmërojnë besimtarët nga një këndvështrim në të cilin përparësi ka aspekti i idealizmit. Gjithashtu ky këndvështrim nuk i lë fushëveprimi plogështisë dhe gjithmonë synon përsosmërinë. Nëse nxirret ndonjë dispozitë prej këtyre ajeteve dhe haditheve duke mos marrë parasysh se ato klasifikohen në metodën e të frikësuarit, patjetër duhet që vepra të konsiderohet si një pjesë e besimit, pra, besimtarin që bën mëkate të mëdha për ta nxjerrë nga besimi ose, nëse nuk nxirret dot nga besimi, për ta vendosur në një pozitë ndërmjet qafirit dhe besimtarit. Edhe fraksioni Mutezile këtë pati bërë. Pasi kësaj punë iu përzje edhe politika, në pah dolën Havarixhët dhe Vahabistët (të cilët janë radikalët e kohës sonë të apasionur pas terrorit) që thonë: “Meqë është qafir, atëherë është e lejuar vrasja e tij!”

2. Metoda tërheqëse / Thirrje për në besim: Në këtë metodë theksohet besimi dhe veprat shpirtërore:

“Ai që ka besim qoftë edhe sa një grimcë ne zemrën e tij, do të hyjë në xhenet. Ai që thotë si fjalë të fundit la ilahe il-lall-llah, do të hyjë në xhenet. Allahu i fal mëkatet. Ai ka falur edhe vrasësin e njëqind vetave. Shpresa nuk pritet nga mëshira e Allahut Teala. Gruaja që i bindet bashkëshortit të saj do të hyjë në xhenet. Hafizët dhe dëshmorët do të ndërmjetësojnë, ndërsa në krye vjen

ndërmjetësimi i madh i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). E rëndësishme është që të jemi me besim në frymën e fundit.”

Në të njëjtën kohë, kjo metodë sjell edhe të vërtetën në përputhje me Librin rreth çështjes së besimit. “Baza është aprovimi i zemrës. Besimi ekziston në zemër. Ajo që pritet prej një besimi të përsosur është reflektimi i tij edhe në sjellje. Por ja që njerëzit bien në gabime për shkak të nefsit, shejtanit dhe pengesave të tjera të ngjashme me këto. Madje, e vërtetë është se nuk ka asnjë rob të pagabueshëm. Atëherë zemra duhet të ketë shumë kujdes ndaj dashurisë dhe besimit të saj. Ata që nuk e frenojnë dot veten nga mëkatet dhe që nuk i kryejnë dot detyrat e tyre ashtu siç duhet, të paktën të mos e çojnë gjendjen e tyre deri në mohim. Por krahas faljes së Allahut, nuk duhet të harrojnë edhe zemërimin dhe ndëshkimin e tij.”

Nëse joshja e kësaj metode nuk bashkohet me frikësimin e metodës tjetër, do të përballemi me portretin e myslimanëve që nuk falen e që nuk luten siç po e shohim edhe në ditët e sotme. Pra, do të kemi myslimanë që shkojnë vetëm në namazin e xhumasë apo atë të bajramit. Ndërkohë, edhe vepra është për ta mbrojtur dhe vërtetuar besimin.

Nxjerrja e besimit në plan të parë dhe hedhja e veprës në plan sekondar është e papranueshme. Vepra menjëherë duhet të vendoset në pozitën e dytë që ka, por pa ia humbur rëndësinë që mbart. Edhe tarikatet tepër tolerante dhe që e kanë humbur istikametin në dimensionin e veprës në ditët e sotme, në të kaluarën e tyre kanë pasur prej atyre që patën qenë kapur shumë pas kësaj pikës së dytë. Kjo domethënë se ata që thonë: “Sidoqoftë nuk është çështje besimi!” – nesër i pret i njëjti rrezik. Sidomos kur bëhet fjalë për influencën përshpejtuese të ndryshimeve shekullore të ahirzamanit / kohës së fundit.

Nisur nga ato që thamë më lart, çdo besimtar duhet të përdorë kundrejt nefsit të tij metodën frikësuese dhe kundrejt të tjerëve metodën tërheqëse apo joshëse. Ndërkohë nuk duhet të harrojë se feja nuk përbëhet nga njëra prej këtyre, por nga të gjitha. Feja jonë islame ka si parim mesataren dhe peshoren e ndjeshme e të përpiktë. Shembujt janë të shumtë:

Nëse do t’ju flisja për “mbrojtjen e shfaqjeve të kulturës dhe civilizimit të Islamit dhe për mbylljen e veshëve ndaj mesazheve juridike dhe

politike të tij...” – patjetër se në mendjen tuaj do t’ju vinin disa organizata.

Po, nëse ju flas për ata që e shohin pothuajse si kusht shkatërrimin e civilizimit dhe kulturës dhe që e shohin Islamin vetëm nga këndvështrimi i hadithit: “Çdo bidat është humbje!” Një dijetar i edukuar në shkollat e njëanshme të këtij mendimit të fundit, pohoi se Java e Kremtimit të Ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), të cilën e përjetuam në ditët që kaluam, është shkaktarja e të gjitha problemeve të botës islame. Në këtë mënyrë, nxori në pah një qasje që nuk i pranon as aktivitetet si leximin e poezive dhe shpërndarjen e llokumeve.

Nga ana tjetër, edhe qasja e atyre që thonë vetëm kulturë dhe asgjë tjetër, kanë nxjerrë në pah vepra të papranueshme për ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), duke e përkujtuar Hz. Pejgamberin me tablo xhahilijeti, të cilën ai është munduar ta zhdukë, si recitimi i poezive nga vajzat e reja përpara djemve të rinj. Ndërkohë ajo që duhet të bëjnë besimtarët është përkujtimi i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), në ditë apo javë të caktuara me aktivitete të përshtatshme ndaj emrit të tij dhe në përputhje me sheriatin. Gjithashtu, nëse ju flas për ata që e ndërtojnë Islamin vetëm mbi dashurinë ndaj Ehli Bejtit dhe njerëzve, në mendje do t’ju vijë këndvështrimi fetar i shtrënguar dhe që e ka humbur vërtetësinë e tij. Nga ana tjetër, çfarë do të mendonit nëse do t’ju thosha se ka edhe prej atyre që përpiqen t’i vendosin në pozita të zakonshme sahabët apo Ehli Bejtin. Sipas tyre besimtarët duhet të merren vetëm me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Po nëse ju them se ka prej atyre që e shohin Islamin vetëm si një iluminizëm racional?

Problemi është ngushtimi vetëm në një aspekt, jo nxjerrja e dispozitës së duhur duke i përfshirë të gjitha aspektet dhe duke gjykuar sipas metodës e argumentit... Jo vetëm dashuri, por jo edhe vetëm frikësim... Jo vetëm shpresë, por jo edhe vetëm shqetësim... Jo vetëm esencë, por jo edhe vetëm formalitet... Jo vetëm vetmi, por jo edhe vetëm shërbim... Jo vetëm ndërgjegje, por jo edhe vetëm ligj... Jo vetëm përgëzim me xhenet, por jo edhe vetëm qortim e frikësim me xhehenem... Andaj duhet të merren të gjitha dhe nga çdo aspekt...



# KI RESPEKT DHE DURO

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

## NGJARJA:

Sipas transmetimit të Enes Ibn Malikut (r.a.), Rasulullahu (a.s.), kaloi pranë një gruaje e cila po qante duke bërtitur në krye të një varri dhe i tha:

*“Ki respekt ndaj Allahut dhe bëj durim!”*

Gruaja u përgjigj:

*“Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’të ka rënë ty!”*

Gruaja nuk e kishte njohur Profetin (a.s.). Më rëpo më pas, kur i thanë se ai që e këshilloi të ketë respekt dhe durim, ishte vetë Profeti (a.s.), ajo nxitoi për tek shtëpia e Rasulullahut (a.s.), hyri brenda dhe tha duke kërkuar falje:

*“Unë nuk ju njoha.”*

Ndërsa Profeti (a.s.), tha:

*“Durimi i vërtetë, është të durosh në momentin e parë të fatkeqësisë.”<sup>1</sup>*

## RESPEKTI DHE DURIMI

Në këtë hadith fisnik nuk është përmendur emri i gruas në fjalë. Gjithashtu, nga sa kuptohet prej transmetimeve, kjo grua qante se kishte humbur fëmijën e saj. Madje, qante me të madhe. Kjo kuptohet nga fakti se Profeti (a.s.), e ftoi atë të tregonte respekt ndaj Allahut dhe të bënte durim. Po ashtu, këtu kuptohet se edhe gratë mund

të vizitojnë varrezat, sepse Profeti (a.s.), nuk e paralajmëroi atë për faktin se kishte ardhur në varreza, por sepse po qante me të madhe.

Siç dihet, Profeti (a.s.), interesohej për njerëzit përreth dhe aty ku ndihej nevoja, kryente detyrën e tij të **“urdhërimit për të mirë dhe të ndalimit nga e keqja”**, në mënyrën më delikate dhe pa i thyer zemrën askujt. Pra, edhe në këtë hadith fisnik, Profeti (a.s.), ka urdhëruar për të mirë, duke i thënë: *“Ki respekt ndaj Allahut dhe bëj durim!”*. Edhe pse në mënyrë indirekte kjo nënkuptohet si “mos qaj duke bërtitur!”, ai nuk i tha kështu. Ky paralajmërim është një shembull i zbatimit të metodës dhe delikatesës së udhëzimit dhe urdhërimit për të mirë edhe kur tërhiqet vërejtja.

Gruaja e shkretë, në atë gjendje të përhumbur, pa bërë kujdes se kush e këshillonte të kishte respekt dhe durim, reagoi mjaft ashpër, duke thënë: *“Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’të ka rënë ty!”*. Përndryshe, kushdo qoftë, burrë apo grua, asnjë prej sahabëve nuk do të thoshte kurrë “më lër rehat”, po ta kishte njohur Profetin (a.s.).

Meqë ra fjala, është me dobi të themi diçka edhe për një çështje aktuale. Ka disa njerëz, që përballë disa haditheve të Profetit (a.s.), thonë: “Nuk më duket si thënie e profetit. Por edhe nëse e ka thënë, unë s’mund ta pranoj këtë!”, gjë që nuk është aspak e hijshme. Kjo bie në kundërshtim me të vërtetën e besimit, mënyrën e të kuptuarit të Profetit (a.s.) dhe respektit ndaj tij. Për rrjedhojë, atyre që kanë rënë në një injorancë

1. Buhari, Xhenaiz 32, 43; Ahkam 11; Muslim, Xhenaiz 14-15. Shih edhe Ebu Daud, Xhenaiz 23; Tirmidhi, Xhenaiz 13; Nesai, Xhenaiz 22.

të tillë ose kanë zgjedhur këtë mënyrë kuptimi, është e domosdoshme që t'u bëhet thirrje dhe paralajmërim, duke i këshilluar për respekt dhe durim.

Për shkak të gjendjes së përhumbur të gruas që reagoi ashpër, Rasulullahu (a.s.), nuk e zgjati shumë dhe vazhdoi rrugën. Nëse ai do ta kishte përsëritur këshillën e tij, gruaja mund të fliste fjalë më të rënda dhe më të ashpra. Dhe kjo mund ta shpinte atë grua në një gjendje më të keqe dhe më të rrezikshme nga gjendja që ndodhej. Thelbi i këshillës dhe urdhërimit për të mirë, është se nuk duhet që personi i cili këshillohet, të detyrohet me zor ta pranojë këshillën apo paralajmërimin. Kjo, sepse realizimi i detyrës së këshillimit për të mirë, nuk e ka si kusht pranimin e këshillës nga personi. Është e mjaftueshme të bëhet e ditur e vërteta.

Kjo është edhe metoda që duhet ndjekur sot. Pra, kur këshillohet e urdhërohet për të mirë dhe merren përgjigje si; “më lër rehat, shiko punën tënde, ç'të duhet ty etj.”, nuk duhet të hyjmë në debat apo në grindje me njerëzit. Neve na mjafton të themi të vërtetën dhe të këshillojmë të drejtën.

Një (apo disa) prej sahabëve, të cilët nuk përmenden me emër, mendoi se gruaja e bëri këtë veprim për shkak se nuk e njohu Profetin (a.s.). Për këtë arsye, ai ia bëri të ditur duke i thënë:

“Ai që të këshilloi të tregosh respekt dhe durim, është Profeti (a.s.).” Pas kësaj, gruaja u mërziu jashtë mase dhe duke harruar edhe dhimbjen që kishte për fëmijën e vet, mori rrugën për tek Profeti (a.s.), që t'i kërkonte falje. Ky është rezultati i natyrshëm i një myslimani që e ka të drejtë botëkuptimin e tij për Profetin (a.s.) dhe respektin ndaj tij.

Sipas transmetimeve, gruaja e shkretë mendoi se tek dera e Profetit (a.s.), do të kishte roje dhe ajo nuk do të kishte mundësi ta takonte atë. Mirëpo, nuk ndodhi ashtu. Ajo shkoi dhe u takua direkt me Profetin (a.s.).

Sipas transmetimit, thuhet se gruaja u betua se “Unë nuk të njoha!” dhe i kërkoi të falur. Mirëpo, Profeti ynë (a.s.), si një edukues i pashoq, e kuptoi se gruaja nuk kishte shumë njohuri në lidhje me durimin. Për rrjedhojë, ai ia shpjegoi menjëherë aty se çfarë është durimi i vërtetë, duke ia bërë të ditur edhe të gjithë umetin të tij. “*Durim i vërtetë, është të durosh në momentin e parë të fatkeqësisë.*” Madje, ai nuk u ndal fare tek fjalët që i tha gruaja: “Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s'të ka rënë ty! E rëndësishme

ishte që gabimi të pranohej dhe myslimanët të mësonin të vërtetën e durimit.

Dihet se njeriu mësohet dhe duron gjithçka me kalimin e kohës. Por është shumë e vështirë të jesh i durueshëm në momentet e para kur përballësh me fatkeqësitë dhe belatë. Pasi të kesh duruar goditjen e fatkeqësisë në momentin e parë, më pas ndikimi i saj do të pakësohet dalëngadalë. Mirëpo, të jesh i zbrazët nga besimi në ato momente, Zoti na ruajtë, mund të bëhet shkak i përfundimeve të padëshirueshme e të hidhura, që tek humbja e mendjes, e deri tek vetëvrasia. Për këtë arsye, është e domosdoshme që në momentet e para të fatkeqësisë të tregohemi të fortë, të respektueshëm dhe të durueshëm.

Siç kuptohet edhe nga kjo ngjarje, momentet e hidhërimit, janë momente të rrezikshme, të cilat mund të bëjnë të harrosh respektin ndaj Allahut dhe të bësh veprime të tepruara. Dhe përjetimi i momenteve të tilla është një realitet i jetës së kësaj bote për të gjithë. Momentet e hidhërimit dhe gëzimit, janë çaste kur vullneti dhe qëndresa e njeriut janë të dobëta. Një fjalë apo një fjali që mund të dalë nga goja e njeriut në momente të tilla, mund ta turpërojnë njeriun dhe mund ta nxjerrin edhe myslimanin nga besimi i tij. Për këtë arsye, rreziku është shumë i madh.

Respekti ndaj Allahut dhe durimi duhen më tepër përballë ndodhisë së vdekjes. Pjekuria e besimit të myslimanit matet pak edhe me anë të durimit që tregon gjatë ndodhive të vdekjes. Në fakt, vaji dhe kuja që përdor populli dhe në mënyrë të veçantë gratë, nuk janë virtyte ashtu siç pandehet. Virtyti i vërtetë është ta kalosh atë moment të hidhur duke e pranuar caktimin e Allahut. Rreziku që e pret njeriun në momente të tilla, është përdorimi i fjalëve që nënkuptojnë refuzimin e Profetit (a.s.), e madje edhe të Allahut të Madhëruar. Për shkak se durimi i njeriut është i dobët në çastet e hidhërimit, është shumë e vështirë që ai t'i kontrollojë fjalët që nxjerr prej goje. Allahu i Madhëruar, urdhëron: “**...Përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”** (Bekare, 155-156)

Në këtë ndodhi tregohet se jo gjithmonë këshilla dhe paralajmërimet marrin gjithmonë falënderime. Atëherë, neve na duhet të jemi të përgatitur ndaj reagimeve të papritura që mund të bëhen ndaj këshillave që bëjmë. Madje, kjo duhet vlerësuar si një detyrë që kërkon “respekt dhe durim”.

# ÇFARË MUND T'I OFROJMË BOTËS?

— Doç. dr. Harun Emysh —

Kushti parësor për t'ua dhënë edhe të tjerëve një vlerë është të pasurit e saj. Nëse në ditët e sotme hedhim një vështrim të përgjithshëm, çfarë kanë myslimanët e botës që njerëzit ta kenë zili dhe që të presin t'ua japin edhe atyre?

Në ditët e sotme, për fat të keq, shtetet islamë janë vendet në të cilat më së shumti vihet re injoranca, fanatizmi, imitimi, përçarja, despotizmi, barbaria, korrupsioni, mjerimi dhe disfatizmi. Cili jomysliman, i cili e shikon këtë gjendje të myslimanëve, dëshiron të bëhet mysliman? Ata që bëhen myslimanë absolutisht janë fatlumët që e njohin Islamin dhe vlerat e tij pa e njohur gjendjen e myslimanëve. Sepse sot, shumica dërmuese e myslimanëve nuk e përfaqësojnë në një mënyrë të denjë fenë e tyre. Rruga për t'ua dhënë Islamit njerëzve të tjerë është përfaqësimi i denjë i tij.

Islami nuk përbëhet vetëm nga kryerja e riteve si namazi, agjërimi dhe haxhi. Këto formalisht mund t'i mësojmë dhe t'i praktikojmë. Sigurisht se janë të rëndësishme edhe format e dukshme të këtyre që tregohen në shariat, por kryerja e këtyre nuk mjafton. Ndërkohë që ne i kryejmë këto, edhe ato duhet të influencojnë te ne, domethënë, duhet të formojnë ndryshime pozitive te ne. Në të vërtetë, këto për këtë punë janë, domethënë, janë urdhëruar që ne të bëhemi njerëz të mirë e të denjë. Përndryshe, Zoti na faltë, Allahu Teala nuk ka nevojë për këto.

Për shkak se nuk është e mjaftueshme që adhurimet të kryhen vetëm formalisht, disa dijetarë kanë kundërshtuar që në kohë shumë të hershme shtjellimin e urdhrave fetare vetëm në këndvështrimin e jurisprudencës islame duke i bërë kurbane të formalitetit. Më i njohuri prej këtyre është autori i veprës me titull *Ihja ulumi'd-din*, Imam Gazaliu (v. 505). Kur Imam Gazaliu i klasifikon shkencat, shkencën e ju-



risprudencës e vendos ndërmjet shkencave të kësaj bote, sepse jurisprudenca cakton përshtatshmërinë në pamje të jashtme të një ibadeti apo vepra ndaj rregullave fetare. Ndërsa pranimin te Allahu të atij ibadeti nuk mund ta dijë. Kjo është një specifikë që mund ta dijë vetëm Allahu i Madhëruar.

Domethënë se qëllimi kryesor i ibadeteve / adhurimeve që bëjmë është që të bëhemi njerëz të pranueshëm, pra, të bëhemi besimtarë të devotshëm dhe të moralshëm siç dëshiron Allahu Teala dhe i Dërguari i Allahut, (a.s.). Feja kërkon që ne të bëhemi njerëz të moralshëm. Por ja që të qenët fetar, domethënë, kryerja formale e ibadeteve, detyrimisht nuk e bën njeriun të moralshëm. Me një thënie tjetër, kryerja e adhurimeve detyrimisht kërkon që të jemi të moralshëm, por nuk mund të thuhet se çdo njeri që bën ibadet është i moralshëm. Njeriu mund të jetë i privuar nga morali, edhe pse e fal namazin, e agjëron ramazanin dhe e kryen haxhin.

Ne si myslimanë normalisht e shohim si të rëndësishme dhënien e edukimit fetar fëmijëve tanë, por moralin shpesh herë e hedhim në plan të dytë. Tani po më duket sikur po shikoni një kontradiktë ndërmjet këtyre dy fjalive që erdhën njëra pas tjetrës dhe po i dëgjoj këto fjali që po i thoni me radhë sikur po kundërshtoni: Feja dhe morali nuk janë të ndarë. Në të vërtetë, feja jonë urdhëron moralin e lartë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, është dërguar për të përsosur moralin e lartë. Andaj, kur fëmijëve tanë u japim edukimin fetar, synojmë t'i bëjmë njerëz që e duan popullin dhe atdheun, që u binden prindërve, që i respektojnë të drejtat e të tjerëve, që sillen me qytetari ndaj njerëzve dhe që kanë shpirt human duke u dhënë dije për Allahun, Pejgamberin dhe Librin e Allahut. Domethënë, shkak që ne u japim atyre edukim fetar është që t'ua mundësojmë për t'u bërë njerëz të moralshëm.

Po, të nderuar lexues, të gjitha kundërshtimet që i parashtruat duken me vend, por ja që, kur diçka nuk e ka emrin, shpesh herë nuk gjendet edhe vetë. A ka ndonjë krijesë në botën e jashtme që nuk i dihet emri apo që nuk është emërtuar? Sigurisht që ka, por vetëm se ajo krijesë pret që të njihet dhe të zbulohet nga njeriu. Ndërsa, nëse njihet nga njeriu, asaj absolutisht i është dhënë një emër, sepse gjëja që e quajmë krijesë, përbëhet nga gjërat që njerëzit i njohin dhe i kanë emërtuar. Krijesat që nuk i njohim dhe që nuk ua kemi vendosur emrin janë gjëra të paditura që akoma nuk kemi njohuri për to. Kur këto gjëra të panjohura t'i njohim ndonjë ditë, do t'ua vendosim edhe emrat. Faktikisht, një gjë është e njohur kur ka emër apo kur i vendoset emri. Sa më shumë gjëra të dijë një mendje, do të thotë se aq shumë gjëra njeh poseduesi i asaj mendjeje, sepse çdo dije në mendje korrespondon me një krijesë në botën e brendshme apo të jashtme.

Ja, kjo është pika që e ndan dijetarin nga injoranti. Dijetar është ai njeri që e njeh botën e ekzistencës nga një perspektivë më e gjerë për shkak të shumë krijesave që korrespondojnë me të dhënat (emrat) që ai ka në mendjen e tij. Domethënë se emrat nuk janë të paqëllimshëm, sepse secili prej tyre tregon një gjë. Nëse ju e zhdukni atë emër, automatikisht e zhdukni edhe atë gjënë që shpreh ai. Nisur nga kjo, përderisa morali të mos theksohet në veçanti, edhe pse gjendet brenda fesë, edhe ai vetë ngelet në plan të dytë. Në këtë situatë, edukimi fetar pandehet se përbëhet nga disa shkenca në formë kallëpi dhe disa ibadete formale. Si rezultat, Zoti na ruajtë, dalin fetarë pa moral. Ata falin namaz, mbajnë agjërim dhe e kryejnë haxhin, por lehtësisht mund të mashtrojnë, mund të shpifin, mund të bëjnë dredhi e shtirje, mund t'i ndihmojnë padrejtësisht ata që ndodhen në medhhebin dhe mentalitetin e tyre, madje, mund të harrojnë se të gjithë myslimanët janë vëllezër, Zoti na ruajtë, duke i konsideruar ata në humbje dhe ta shohin medhhebin e tyre si Firkatu'n-Naxhiye / grupi i shpëtuar e të sillen si të atillë.

Të gjithë e shohin qartazi se, para se t'i japim diçka botës, duhet t'i kemi vetë disa gjëra. Meqë kemi dalë në pah me identitetin e myslimanit, është e qartë se së pari, duhet të kemi moral. Madje, siç ka thënë edhe i ndjeri Sejjid Kutubi, meqë nuk jemi në gjendje të garojmë me botën në çështjet e shkencës, artit, teknologjisë, armatimit etj., vlera e vetme që ne sot mund t'ia japim botës është morali i lartë dhe sjelljet shembullore.

Po ta këshillosh dikë te ne në çështjen e edukatës, jo për sa i përket marrëdhënies mësues-nxënës apo prindër-fëmijë, për shembull, po t'i dhurosh një libër edukate diku, në kulturën tonë konsiderohet si turp dhe konceptohet si mosrespekt, sepse kjo është sikur t'i thuhet bashkëbiseduesit: "Ti ke nevojë të mësosh rregullat e edukatës." Fakti që këtë shkrim ia kam kushtuar çështjes së moralit, e kuptoj se mund të lërë një përshtypje të atillë, por edhe të mashtruarit e vetes me gjëra boshe duke bërë sikur nuk i shohim të vërtetat, jo që nuk i zgjidh problemet, por i thellon edhe më shumë. Nëse ju thoni së myslimanët nuk kanë dobisë në moral, atëherë nuk kam asnjë fjalë për t'ju thënë. Vetëm se realiteti na tregon qartë se aspak nuk është ashtu.

Vetë personalisht, veçanërisht pas shtatëmbëdhjetë dhjetorit, shumë herë i kam bërë vetes këtë pyetje: "Sa njeri i moralshëm jam unë?" Ndosh-ta jam shumë pesimist, nuk e di, por sipas meje, myslimanët që gjenden në fushën e politikës dhe atë të medias, në organizata shoqërore, në lëvizje civile e xhemate dhe në çfarëdo fushe tjetër, duhet t'ia bëjnë vetes këtë pyetje dhe të bëjnë një llogari serioze të nefsit të tyre. A nuk është kështu edhe sipas jush?..



# PËRFAQËSIMI DHE PREDIKIMI

— Sami Gëksyn —

I Dërguari i Allahut (a.s.) i dha këtë këshillë Aliut (r.a.), e cila është një porosi e artë edhe për ne:

*“Betohem në Allahun se, nëse Allahu udhëzon qoftë edhe një njeri të vetëm nëpërmjet teje, është më e mirë për ty se sa devetë e kuqe, të cilat janë mirësia më e vlefshme e kësaj bote.”* (Buhari, Fedailu'l-As'hab, 9.)

Kjo është dëshira më e madhe e ne të gjithëve. Pra, të bëhemi shkak për udhëzimin e një njeriu... Të bëhemi shkak për rregullimin e një vëllai tonë... Të ndihmojmë një fëmijë për t'u edukuar në atë formë, që në të ardhmen ta përfaqësojë Islamin në mënyrën më të bukur... Ky është halli, emocioni dhe përpjekja jonë... Për këtë po përpiqemi dhe për këtë po japim sa të kemi mundësi prej gjërave që i duam dhe i posedojmë. Por ja që të marrësh rezultat nuk është aspak e lehtë. Zgjidhja e nyjave që gjenden në zemrat e njerëzve nuk është aq e lehtë. Të zgjuarit e perceptimit nuk është një punë e thjeshtë. Ajo është një punë e mistershme dhe që ka nevojë për çelësa shpirtërorë...

Ne e predikojmë Islamin çdo ditë, por a arrin fjala jonë te njerëzit? Mos vallë u hyn në njërin vesh dhe u del nga veshi tjetër apo u shkon drejt e në zemrat e tyre? A ia kanë qëlluar synimit plotësisht mundësitë që kemi përdorur? Të gjitha këtyre duhet t'u bëhet analiza shpirtërore... Nëse fitimi ynë është hallall, ai sjell në pah rezultatin më influencues, por nëse në fitimin tonë përzihen dyshimet, Allahu na ruajtë, i tëri do të shkojë dëm.

Kështu janë edhe përpjekjet. Nëse fjalët nuk dalin nga zemrat tona, nëse ato që themi nuk i besojmë me zemër, atëherë, si mund të gjejnë përgjigje te bashkëbiseduesi? Si mund ta ndezë kandilin e zemrës së bashkëbiseduesit një zjarr që nuk na ngroh ne? Nisur nga kjo, duhet të themi se predikimi më ndikues vjen nga përfaqësimi më i mirë. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

*“Më i përsosuri i besimtarëve nga aspekti i besimit është ai që ka karakterin më të mirë.”* (Tirmidhi, Rada, 11.) Ndërsa në një hadith tjetër fisnik thotë: *“Mirësia është moral i lartë.”* (Muslim, Birr, 14, 15.) Andaj, morali i lartë është shumë i rëndësishëm. Ndërsa për aktivitetet e predikimit është akoma edhe më i rëndësishëm. Morali i lartë është shumë i rëndësishëm, sepse ai tregon nëse ka zënë vend edukimi që kemi dhënë.

Predikuesi duhet të ketë fytyrë të qeshur... Buzë-qeshja e fytyrës gjenden në moralin e lartë... Atij i duhet bujari dhe sakrificë... Edhe këto janë pjesë të pandashme të moralit të lartë... Atij i duhet të mos nxitojë dhe të jetë durimtar... Edhe këto janë prej kushteve të domosdoshme të moralit... Sa bukur e ka përmbledhur moralin e lartë Hasan el-Basriu, rahmetullahi alejh: “Themeli i moralit të lartë është përhapja e mirësisë, mosshqetësimi i të tjerëve dhe të qenët fytyrëqeshur.”

Kush është predikuesi më i suksesshëm? Sigurisht se ai i cili është bërë shkak për udhëzimin e udhërrëfyesve më të lartë dhe ka edukuar myslimanët më



të mirë... Myslimanët më të mirë kanë qenë sahabët e nderuar... Ndërsa mësuesi më i shkëlqyer i atyre ka qenë i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të... Me çfarë i edukoi ai ata?

Me Kuranin Fisnik dhe personalitetin e tij të shkëlqyer... I Dërguari i Allahut (s.a.s.), kishte një moral të shkëlqyer në lidhje me ndershmërinë dhe bujarinë...

I Dërguari i Allahut (a.s.), është ai që ka thënë: *“Unë jam dërguar për të përsosur moralin e lartë.”* – dhe ai që ka merituar lavdërimin e Kuranit Fisnik: *“Ti me të vërtetë ke një moral të lartë.”* (Kalem, 4)

Edhe ata që janë udhëzuar, e kanë arritur mirësinë për t’u nderuar me Islamin duke admiruar personalitetin e mrekullueshëm më shumë se sa duke parë mrekulli.

Edhe ne sot, nëse dëshirojmë të arrijmë mirësitë hyjnore më të mëdha duke u bërë shkak për udhëzimet dhe rregullimet e njerëzve, duhet të pajisemi me moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Por këtu ka një rrezik: Ne absolutisht duhet të përjetojmë emocionin për t’u bërë si i Dërguari i Allahut (a.s.), në dashurinë dhe respektin që ndiejmë ndaj tij. Por nuk është e mjaftueshme që të ndiejmë vetëm admirim, vetëm ta lavdërojmë dhe vetëm ta përkujtojmë, sepse pastaj mund t’ia kthejmë kurrizin kur të na thuhet: “Pasojeni atë!” Ja, kjo është e papranueshme. Dashuria e tillë pothuajse nuk ka asnjë dobi... Qëllimi i dashurisë është të pasuarit...

Një dashuri që nuk lind pasimin është një dashuri e dështuar... Qëllimi i admirimit është të ndjekurit... Një admirim që nuk siguron ndjekjen është një admirim i dështuar...

Ne nuk duhet vetëm ta admirojmë të Dërguarin e Allahut (a.s.), por duhet edhe ta ndjekim, edhe ta pasojmë... Fenë e atij duhet t’ua predikojmë njerëzve duke e përfaqësuar atë... Singëriteti ynë duhet të jetë si singëriteti i atij... Devotshmëria jonë duhet të jetë si devotshmëria e atij... Buzëqeshja jonë duhet të jetë si buzëqeshja e atij... Përpjekja, puna, sakrifica, bujaria, durimi, falja, guximi, trimëria dhe çdo gjë tjetër e jona duhet të marrin pjesë nga ai... Ne gjithmonë duhet të përpiqemi për të marrë pjesë nga ai...

Nëse veprojmë në këtë mënyrë dhe hedhin hapa të sigurtë, edhe pse mund të jenë të vegjël si hapat e milingonës, në këtë rrugë që nuk i arrihet pika kulmore, me lejen e Allahut, (xh.xh.), do t’ia dalim të afrojmë veten dhe njerëzit drejt të vërtetës.

Nëse ne përpiqemi për të marrë pjesë nga bujaria e të Dashurit të Allahut (a.s.), edhe Allahu do të na shfaqet ne me emrin e Tij Kerim.

Nëse ne e harxhojmë të gjithë fuqinë tonë për të marrë pjesë nga besnikëria e të Dashurit të Allahut (a.s.), edhe Zoti (xh.xh.), i Cili nuk e thyen premtimin asnjëherë, do të na nderojë me shpërblimet dhe mirësitë që na ka premtuar.



“Ata thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj!  
Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin,  
as Jaukën, as Nesrin!’ (Nuh, 23)”

Megjithëse profetët kanë qenë njerëz, ata kishin pozitë të veçantë tek Allahu, ishin të zgjedhur dhe u vinte shpallja prej Tij. Statusi i tyre njerëzor dhe hyjnor, është përcaktuar qartë nga vetë shpalljet e Allahut. Për shembull, Kurani e urdhëron Profetin (a.s.), t’i njoftojë njerëzit se ai është vetëm një njeri si gjithë të tjerët.<sup>1</sup> Përveç kësaj, Kurani e urdhëron Profetin (a.s.), t’ua bëjë të ditur njerëzve, se thesaret e Allahut nuk gjenden në dorën e tij, se ai nuk e di të shkuarën dhe të ardhmen dhe nuk është melek.<sup>2</sup>

Në këto ajete, Profeti (a.s.), urdhërohet qartë që t’u thotë njerëzve se ai nuk zotëron cilësi të shenja, sepse arabët e kohës së injorancës, nuk besonin se një profet mund të ishte njeri normal.<sup>3</sup> Ata dëshironin me patjetër që të shihnin tek ai cilësi të jashtëzakonshme dhe të mrekullueshme.

Në fakt, nëse studiohet historia e feve, do të shihet se në imagjinatën e njerëzve, një prijësi fetar i atribuohet gjithmonë cilësi të jashtëzakonshme. Po ashtu, shihet se në këtë pikë, njeriu i kalon kufijtë dhe u atribuon atyre disa cilësi hyjnore. Dhe pikërisht kjo gjendje është edhe një nga shkaqet më të rëndësishme të shfaqjes së shirkut. Shembulli më i spikatur i këtij fenomeni në aspektin e historisë së profetëve, është Isai (a.s.).

Ai ishte një prej profetëve të mëdhenj dhe natyrisht që ishte dërguar që në radhë të parë t’u predikonte njerëzve teuhidin. Por për fat të keq, pas vdekjes së tij, për shkak të ndodhive që u zhvilluan, ai u shndërrua në një figurë të shenjtë i cili besohet se është biri i Zotit. Madje, ata që i besojnë kësaj feje, shkojnë aq larg sa pretendojnë se Isai (a.s.), është Vetë Zoti.

Ky devijim, nuk është vetëm në lidhje me profetët, por vlen edhe për të mëdhenjtë e fesë siç janë shenjtoret, evliatë, njerëzit e mirë etj. Disa prej tyre

u konsideruan se kishin cilësi mbinjerëzore kur ishin ende në jetë, e disa të tjerë pas vdekjes. Njerëzit u luteshin, u kërkonin ndihmë dhe i merrnin si ndërmjetës të Allahut.

Gjatë gjithë historisë, gjithmonë ka pasur njerëz të cilët kanë ecur në vijën e drejtë të teuhidit, kanë qenë të devotshëm dhe njerëz të mirë, të cilët ndiqeshin nga njerëz të shumtë. Por për fat të keq, ka pasur edhe prej atyre të cilëve u janë atribuuar cilësi mbinjerëzore, duke u shenjtëruar nga ana e ndjekësve të tyre të devotshëm. Kurani bën fjalë për idhujt Vedd, Suva, Jeguth, Jauk dhe Nesr.<sup>4</sup> Shpjegimet në lidhje me këtë ajet në librat e tefsirëve, janë shumë të rëndësishme për të treguar se si me kalimin e kohës njerëzit e mirë janë shndërruar në idhuj.

Emrat e idhujve që përmenden në ajet, janë emrat e disa njerëzve të mirë që kanë jetuar më parë. Pas vdekjes së këtyre njerëzve, admiruesit e tyre kanë ngritur statuja në shenjë nderi dhe respekti ndaj tyre. Por për fat të keq, me kalimin e një kohe të gjatë, qëllimi i vërtetë i ndërtimit të këtyre statujave u harrua dhe ata filluan të shihen si zota të shenjtë. Po ashtu, Kurani na bën të ditur se edhe hebrenjtë dhe të krishterët i kanë idhujtarizuar të mëdhenjtë e feve të tyre, gjë e cila në fakt përbën një devijim shumë serioz. Ky nuk është vetëm një evidentim, por në të njëjtën kohë, është bërë edhe një paralajmërim i rëndësishëm për ne si përfaqësuesit e fundit të teuhidit/monoteizmit të vërtetë mbi tokë.

Shfaqja e një respekti të tepruar ndaj njerëzve dhe madhërimi i tyre, është një nga llojet e shirkut. Për rrjedhojë, edhe Profeti (a.s.), nuk e ka aprovuar respektin e tepruar ndaj njeriut, përfshi edhe ndaj vetë atij dhe, lidhur me këtë na ka paralajmëruar: “Mos më lavdëroni në mënyrë të tepruar ashtu siç e lavdërojnë të krishterët Isain birin e Merjemes! Unë jam vetëm rob i Zotit. Prandaj thoni, “Robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij”” (Buhari, Enbija, 48.)

1. shih. Kehf, 110; Fussilet, 6.

2. shih. En’am, 50.

3. shih. Furkan, 7.

4. shih. Nuh, 23.



Ky veprim i Profetit (a.s.), na jep këto kritere: Asnjë njeri nuk është në nivelin e profetëve dhe, përderisa as profetëve nuk mund t'u jepet një status i mbinatyrshëm, atëherë duhet qëndruar larg edhe shenjtërimit të njerëzve të tjerë. Për rrjedhojë, respekti dhe madhërimi që tregohet ndaj Allahut, nuk mund të tregohet për asnjë krijesë tjetër. Lidhur me këtë çështje, ne duhet t'i mbajmë nën kontroll të gjitha mendimet, ndjenjat dhe sjelljet tona. Ashtu siç sillemi me maturi ndaj atyre që jetojnë, ashtu duhet të sillemi edhe ndaj atyre që kanë vdekur. Varret e tyre duhet t'i vizitojmë për të kujtuar vdekjen dhe për të marrë shembull prej jetës së tyre shembullore. Por asnjëherë nuk duhet t'i lutemi atyre duke pritur ndonjë dobi prej tyre, apo duke i bërë ata ndërmjetës të Allahut. Kjo, sepse ne adhurojmë vetëm Allahun dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë. Gjithashtu, duhet theksuar se mendimet e tilla si, "filan elvi ja i di veprat e njerëzve", nuk përputhen aspak me besimin e teuhidit. Ky besim i gabuar, me vetëdije apo pa vetëdije, nënkupton se përveç Allahut ka edhe të tjerë që dinë të fshehtat. Për fat të keq, këto lloj besimesh, pranohen si normale në disa rrethe të caktuara. Por në fakt, ky është një devijim shumë serioz, sepse të fshehtën/gajbin e di vetëm Allahu i Madhëruar. Dija, shikimi dhe dëgjimi i Tij, janë të pakufishëm. Për këtë arsye, besimtarët e dinë mirë se ata ndodhen vetëm nën kontrollin e Tij. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik, urdhërohet: **"...Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni!"** (Hadid, 4)

Përveç këtyre, myslimanët besojnë se vetëm profetët janë të mbrojtur nga gjynahet. Për rrjedhojë, një person mund të jetë shumë i devotshëm dhe i virtytshëm. Njerëzit mund të përfitojnë prej moralit të tij të lartë dhe personalitetit të tij shembullor. Por të gjitha këto virtyte nuk nënkuptojnë se ai është i

ruajtur prej gabimeve dhe gjynaheve. Një besimtar mysliman nuk duhet të veprojë kurrë në mënyrë të atillë, që të tregojë respekt të tepruar ndaj ndokujt apo diçkaje. Ai nuk e konsideron të ruajtur prej gabimeve një person për shkak të mendimeve dhe virtyteve të tij të larta, sepse e di mirë se edhe nëse një person është shumë i devotshëm, ai mund të bëjë gjynahe dhe mund të gabojë në zgjedhje dhe mendime. Për rrjedhojë, myslimani nuk duhet të kërkojë asnjë urtësi pas mendimeve dhe sjelljeve të një personi të tillë.

Gjithashtu, ky person nuk konsiderohet si dikush që nuk mund të kundërshtohet dhe t'i vihen në diskutim mendimet dhe sjelljet. Përndryshe, kjo do të thotë që njeriu të mohojë veten e tij. Nga ana tjetër, përveç sahabëve që janë përgëzuar me Xhenet, askujt nuk i është garantuar shpëtimi i përjetshëm. Mbi të gjitha, a nuk është vetëm Allahu Ai që i njeh robërit e Tij në mënyrën më të përsosur!? Për këtë arsye, besimtari nuk dyshon aspak në këtë të vërtetë.

Nëse besimtari është i sigurt për virtytet e larta të një personi, ai mund të mendojë se ky person mund të jetë prej të dashurve të Allahut. Madje ai ushqen mendime të mira në lidhje me të dhe përpigjet të përfitojë prej jetës së tij shembullore. Por ai kurrsesi nuk mund t'i aprovojë besimet e gabuara që pretendojnë se Zoti është mishëruar apo është shfaqur tek dikush që pranohet si njeri i mirë. Gjithashtu, besimtari i konsideron si të gabuara edhe besimet që i atribuojnë dikujt cilësi mbinatyrore, saqë po ta thërrasë dikush në ndihmë ai i shkon menjëherë në ndihmë kudo që të ndodhet. Sepse kjo nuk përputhet aspak me besimin në parimin e teuhidit të cilin e përsëritim në çdo rekat të namazit kur themi: **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!"**



# “ÇFARË KE BËRË SOT PËR ALLAHUN?!”

Shërbimi në rrugën e Allahut është një përgjegjësi shoqërore që Zoti i Madhëruar na e ka ngarkuar si detyrë ne, robërve të Tij. Jeta e besimtarit që u shërben krijesave, fiton thellësi shpirtërore, begati dhe madhështi. Ai që ekzistencën e vet të përkohshme ia kushton shërbimit në rrugën e Allahut, arrin ta çlirojë përjetësisht shpirtin e tij të pavdekshëm.

Ndërsa Mevlana i nderuar, në lidhje me pjekurinë shpirtërore që përfiton njeriu nga shërbimi për hir të Allahut, shprehet:

*“Nëse shikoni me syrin e zemrës, të cilin e përfitoni nga adhurimet, dhurimet, mirësitë dhe shërbimet që bëni, do të shihni edhe ngjyra të tjera përveç atyre që shihni zakonisht. Në vend të gurëve të rëndomtë, do të shihni perla e xhevahire. E çfarë është perla në fund të fundit? Ti vetë bëhesh det, bëhesh diell, që lundron e shëtit në qiell.”*

Allahu, u ka dhuruar robërve të Tij mirësi pa fund dhe, në këmbim të kësaj, i ka urdhëruar ata që duke përdorur mirësitë që zotërojnë, t’u shërbejnë krijesave të Tij. Nga kjo pikëpamje, çdo besimtar duhet të mendojë: “Çfarë mundësish më ka dhuruar Allahu dhe si mund të shërbej me këto mundësi në rrugën e Allahut?” Ata që mendojnë vetëm për vete dhe nuk shërbejnë në rrugën e Allahut, duke bërë një jetë boshe, megjithëse kanë mundësi dhe mirësi të panumërta, janë si një pemë pa kokrra. Këtë mund ta ilustrojmë me një shembull të tillë: Rapi është një pemë madhështore, që mund të jetojë një mijë vjet. Mirëpo nuk ka fruta. Madje, nuk bën as për dërrasë, por vlen vetëm si dru zjarri. Kurse ulliri, megjithëse në pamje të jashtme nuk ka ndonjë

madhështi të veçantë, një vit pasi mbillet fillon të japë fruta.

Po ashtu edhe njeriu, nëse jeton pa fryte si pema e rrapit, megjithëse mund të ketë mirësi të ndryshme, si pasuri, shëndet, dije dhe mundësi, e çon dëm veten. Një njeri i mençur duhet të jetë si pema e ullirit, të japë shumë fryte pa humbur kohë, duke u munduar të jetë sa më i dobishëm.

Allahu, ka vendosur në shërbim një të fshehtë të madhe. Shërbimi ndaj njeriut, një krijesë e cila është krijuar vetëm për të adhuruar Allahun, është një lloj grade, e cila dëshmon për devotshmërinë ndaj Allahut. Allahu, merr përsipër zgjidhjen e vështirësive personale të atyre që shërbejnë për fenë e Tij dhe që merren me zgjidhjen e problemeve të robërve të tjerë. Kurse ata që merren vetëm me interesat dhe problemet personale, Ai i lë vetëm për vetëm me problemet e tyre.

Shërbimi është kërkimi i kënaqësisë së Allahut duke shpëtuar prej egoizmit dhe duke iu drejtuar çdo krijese me një shpirt altruist. Çdo punë e sinqertë në rrugën e Allahut, e cila bëhet vetëm për të përfituar kënaqësinë e Allahut, duke qenë larg mendimit për përfitim nga kjo botë, është një përshkrim i kërkimit të takimit me Zotin dhe një pasqyrim i kësaj dëshire në sjellje dhe vepra.

Të jesh një shërbyes i vërtetë në rrugë të Allahut, është një nder i lartë, që Allahu i Madhëruar mund t’i japë robit të Tij. Prandaj, duhet t’ia dimë mirë vlerën kësaj mirësie dhe të përpiqemi që çdo punë ta bëjmë me sinqeritet dhe duke qenë në rrugë të drejtë.



Hadithi profetik thotë:

*Shërbyesi i një populli është zotëria e atij populli.* (Dejlemi, el-Firdevs bi-Me'sûri'l-Hitab, Bejrut 1986, II, 324.)

Ebu Hurejra transmeton se Profeti (a.s) ka thënë:

*“Dikush, pa një degë peme në rrugë dhe tha: «Betohem në Allahun se do ta largoj këtë degë peme që të mos i pengojë myslimanët!» Pastaj e largoi dhe për këtë fitoi xhenetin.”* (Muslimi, Birr 128)

Gjithashtu Pejgamberi a.s, ka thënë:

*“Një person që ishte duke ecur në rrugë, pa një degë ferre dhe e largoi nga rruga. Allahu u kënaq shumë nga veprimi i tij dhe ia fali gabimet.”* (Buhariu, Ezan 32, Muslimi Birr 127, Imare 164)

Nuk duhet harruar se ndonjëherë, shpërblimi Allahut fshihet në një punë të vogël që bëhet me sinqeritet. Prandaj, pa marrë parasysh nëse është e vogël apo e madhe, kënaqësia e Allahut, duhet kërkuar duke vrapuar vazhdimisht pas çdo shërbimi të dobishëm.

Kjo, sepse t'u shërbesh të tjerëve vetëm për hir të Allahut, është puna më e pranuar tek Ai. Në fakt edhe qëndrimi në rrugën e drejtë, nuk është gjë tjetër përveç shërbimit ndaj njerëzve dhe të qenit i dobishëm për ta.

Pejgamberi (a.s), ka thënë:

*“Më i miri ndër njerëzit, është ai më i dobishmi për të tjerët.”* (Bejhaki, Shuab VI, 117; Ibn Haxher, I 264)

Nga kjo pikëpamje, rruga e lartësimit shpirtëror

për robërit kalon përmes shërbimeve të kryera me zemër të sinqertë. Madje edhe një punë e vogël, e cila arrin të fitojë kënaqësinë hyjnore, mund të jetë më e madhe se shumë adhurime nafie (vullnetare).

Njëherë, kur bënte një i nxehtë i madh, Muhamedi (a.s), dhe shokët e tij qëndruan në një vend të përshtatshëm për të pushuar. Një pjesë e shokëve të tij agjëronte dhe një pjesë jo. Ata që agjëronin i zuri gjumi nga lodhja. Ata që nuk agjëronin ngritën çadrat për hije, morën ujë për abdest dhe për kafshët, duke shërbyer

kështu edhe për ata që agjëronin. Kur erdhi koha e iftarit, i Dërguari i Allahut a.s, tha:

*“Sot, ata që nuk agjëruan fituan më tepër shpërblim.”* (Buhari, Xhihad 71; Muslimi, Sijam, 100-101; Nesaiu, Saum 52)

Profeti (a.s) gjithë jetën e tij ia dedikoi shërbimit, ai gjithë jetën e vet e zbukuroi me shërbime ndaj njerëzve. Mbi të gjithë në shërbimin për të udhëzuar njerëzit dhe për t'i pasuruar ata shpirtërisht. Në të njëjtën kohë nuk linte pas dore as veprat e dukshme.

Për shembull, me gjithë këmbënguljen dhe përpjekjen e sahabëve për ta penguar, i Dërguari i Allahut, ka punuar së bashku me ta në ndërtimin e xhamisë Kuba, xhamisë së tij në Medinë dhe në hapjen e hendekut në betejën e Hendekut.

Gjithashtu, Pejgamberi(a.s), është marrë vetë personalisht me përfaqësuesit e fiseve që vinin tek ai, madje edhe u ka shërbyer atyre. Kur i vinte ndonjë mysafir, nëse ishte në shtëpi, menjëherë i ofronte atij një shilte për t'u ulur; nëse ishte jashtë, hiqte shallin e tij dhe ia vinte si shtrojë mysafirit.

*“Nëse shikoni me syrin e zemrës, të cilin e përfitoni nga adhurimet, dhurimet, mirësitë dhe shërbimet që bëni, do të shihni edhe ngjyra të tjera përveç atyre që shihni zakonisht. Në vend të gurëve të rëndomtë, do të shihni perla e xhevahire. E çfarë është perla në fund të fundit? Ti vetë bëhesh det, bëhesh diell, që lundron e shëtit në qiell.”*

Kjo modesti dhe frymë shërbimi kaq e lartë e Pejgamberit tonë të nderuar, është një model i pashoq dhe ideal për të gjithë umetin islam. E gjithë jeta e tij, nga fillimi deri në fund, kaloi me shërbime plot mëshirë për njerëzit dhe gjithë krijesat.

Nga ana tjetër, njerëzimi gjithmonë ka nevojë për angazhimin e besimtarëve në shërbim. Nevoja për këtë ndihet edhe më shumë në ditët tona, kur lidhjet vëllazërore fetare janë dobësuar, kur paqja dhe qetësia sociale ka filluar të humbasë dhe kur egoizmi, urrejtja dhe armiqësia janë shtuar. Për një mirësi apo një shërbim të vogël, që mund të bëhet në kohë të tilla, Allahu Teala dhuron shumë shpërblime të mëdha.

Sa bukur shprehet Imam Rabani në lidhje me këtë çështje:

*“Sa fatlum është ai, të cilit i është dhënë mirësia e ndjekjes së sunetit, urdhrave të të Dërguarit të Allahut (a.s)! Sot edhe punët më të vogla që bëhen duke besuar se feja e tij është e vërtetë, renditen në kategorinë e punëve të mëdha...”* (Mektubati, Rabani, Letra 44)

Prandaj veten dhe pasardhësit duhet t'i pajisim me entuziazmin e shërbimit të Profetit (a.s) Çdo lloj shërbimi duhet ta bëjmë me dashuri, me kënaqësi dhe entuziazëm duke u shndërruar në besimtarë model për të gjithë.

Ndërkaq, që shërbimi i kryer të jetë i pranueshëm në lartësinë e Allahut, duhet që kryerja të përmbajë disa veti dhe cilësi. Sipas kësaj, shërbimi i pranueshëm është kërkimi i pëlqimit të Allahut duke iu drejtuar krijesave me një zemër të mbushur plot me principialitet, sinqeritet, mëshirë dhe vetëmohim.

Neglizhenca dhe dembelizmi në shërbim e ul vlerën e ti edhe nëse është bërë me sinqeritet. Për ta bërë çdo shërbim për hir të Allahut duhet ta konsiderojmë atë si një mirësi dhe ibadet. Kjo ngjarje e ndodhur në epokën lumturisë është shumë domethënëse në lidhje me këtë që përmendëm:

Një herë, Resulullahu, dërgoi një grup sahabësh për ekspeditë që në mëngjes herët. Njëri prej tyre mbeti pas dhe familjes së vet i tha:

“Unë mbeta pas me qëllim që ta fal namazin e drekës bashkë me të Dërguarin e Allahut, ta përshëndes dhe të ndahem me të. Po ashtu dëshiroj që ai të bëjë edhe dua për mua, që ajo të jetë ndërmjetësim Ditën e Kiametit!

Pasi fali namazin me Profetin, ai iu drejtua atij dhe e përshëndeti. I

Dërguari i Allahut , i tha:

“A e di se sa të kanë kaluar shokët?”

Sahabiu iu përgjigj:

“Po, më kanë kaluar aq sa distanca e një udhëtimi prej në mëngjes herët!”

Atëherë, Resulullahu i tha:

*“Betohem në Atë që ka shpirtin tim në duar, se ata ta kanë kaluar ty në virtyte aq sa distanca mes lindjes dhe perëndimit.”* (Ahmed, III, 438.)

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti (a.s), ka kthyer këtë përgjigje:

*“Sikur të dhurosh gjithçka ka mbi Tokë, nuk mund të arrish virtytin që kanë arritur ata duke dalë që në mëngjes herët.”* (Tirmidhiu, Xhuma, 28/527; Ahmed, I, 256; Bejhaki, III, 187.)

Duke dashur të gëzojë Pejgamberin (a.s) me qëndrimin pranë, e lëndoi zemrën e tij të pastër. Shërbimi në rrugën e Allahut është gjëja më e rëndësishme. Qëndrimi larg shërbimit për arsyeje dhe interesa personale është një humbje e madhe shpirtërore. Allahu kërkon prej nesh të shërbejmë në kolektiv siç thotë edhe ajeti kuranor:

**Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide.** (Saff, 4)

Dashuria është eliksiri më i fortë për t'i shndërruar vështirësitë në mëshirë. Kur bëhen me dashuri, edhe punët më të vështira janë të lehta. Shërbimi në rrugën e Allahut i realizuar me dashuri është një burim i madh i lumturisë dhe gëzimit. Besimtari në çdo vepër të tij synon arritjen e dashurisë së Allahut.

Këto fjalë të Muhamed Ikbalit janë si një dritë, që i ndriçon rrugën përballë vështirësive çdokujt që shërben në rrugën e Allahut:

Një gazelë po i ankohej një gazele tjetër:

- Këtej e tutje do të jetoj në Qabe. Aty do të banoj e do të kullos. Sepse gjuetarët kanë ngritur kurthe nëpër lëndina dhe na gjurmojnë ditë e natë. Tashmë dua të jem e sigurt prej gjuetarëve, që edhe zemra të më gjejë qetësi!”

Gazela tjetër që po dëgjonte, tha:

- O miku im i mençur! Nëse do të jetosh, jeto brenda rrezikut. Gjuaje veten gjithmonë në gurët e mprehjes dhe jeto më e mprehtë se shpata me

çelik të pastër! Rreziku e sprovon fuqinë. Kështu e kuptojmë se deri ku mund të arrijë fuqia e trupit dhe e shpirtit.”

Shërbimi më i madh, më i rëndësishëm dhe jetik që mund t'i bëhet njerëzimit është predikimi dhe mësimi i fesë islame. Këshillimi i njerëzve për mirë, drejtësi dhe mirësi dhe ndalimi nga e keqja dhe shëmtuara. Për të zbatuar librin e Allahut dhe traditën profetike së pari duhet të duam dhe të kultivojmë në zemër dashurinë për t'i shërbyer njerëzve në mënyrë që të njohin Zotin.

### PREDIKIMI I TË VËRTETËS

Një nga veçoritë kryesore që e dallon besimtarin prej njerëzve të tjerë është mëshira. Kulmi i shërbimit që bëhet për hir të Allahut është ftesa tek e vërteta dhe predikimi i fesë Islame. Predikimi i Islamit është shenjë e mëshirës që vjen nga dashuria për hir të Allahut.

Sa shërbim i lartë është t'i thërrasësh njerëzit në mirësi, t'u mësosh të vërtetat që nuk i dinë, duke u korrigjuar gabimet, t'i drejtosh për tek Vërteta, duke ua përmirësuar moralin dhe duke ua mbushur botën shpirtërore me ndjenja të larta, veçanërisht në ditët tona, ku njerëzit tërhiqen nga rrymat egoiste si trungjet nga vërshimet e përrënjeve. Ky shërbim që ua zbukuron njerëzve edhe këtë botë edhe botën tjetër, është një shfaqje dhe shprehje sublime e falenderimit ndaj Allahut. Ku ka vlerësim më të madh për njeriun se sa të fitojë lëvdimin e Allahut në Kuran?:

**E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.”** (Fussilet, 33)

Allahu duke dashur që të jemi prej krijesave prej të cilave Ai është i kënaqur me ta dhe duke dashur të na bëjë prej robërve të tij fitimtarë në këtë botë dhe botën tjetër thotë:

**Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të**

**ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.** (Ali Imran, 104)

Në lidhje me rëndësinë e predikimit në Islam Profeti (a.s) thotë:

**Nëse Allahu e udhëzon dikë përmes teje, kjo është më e vyer për ty sesa gjithçka mbi të cilën lind Dielli!”** (Hakim, Mustedrek, III, 690.)

Ebu Bekri duke e përdorur mallin dhe pasurinë e kësaj bote në mënyrën më të frytshme, ia pati kushtuar të gjitha të Dërguarit të Allahut, pasurinë e pati shpenzuar në rrugën e Zotit, veçanërisht, në vitet e para e më të vështira të Islamit, pati shpëtuar shumë skllavë nga keqtrajtimi dhe torturat duke i blerë dhe u dhënë lirinë më pas! I pakënaqur që ai e shpenzonte pasurinë në këtë mënyrë, një ditë, i ati, Ebu Kuhafe, i pati thënë:

“O bir, ti s'bën gjë tjetër veçse blen skllavë të dobët e të pafuqishëm dhe i çliron. Meqë kërkon të çlirosh skllavë, bli skllavë të fuqishëm që të të mbrojnë përballë rreziqeve dhe të këqijave!”

Dhe Ebu Bekri (s.a.s.) i pati dhënë këtë përgjigje të shkëlqyer:

“O baba, synimi im i vetëm që sillem kështu është të fitoj pëlqimin e Allahut! Duke i çliruar ata, unë shpresoj vetëm shpërblim te Allahu!”

Për t'i lavdëruar këtë dhe bujaritë e tjera si kjo të Ebu Bekrit, zbriti ky ajet:

**“Edhe Ne e bëjmë të suksesshëm në rrugën më të lehtë atë që e shpenzon mallin në rrugën e Allahut, që, duke ndjerë respekt për Të, ruhet nga haramet dhe e vërteton fjalën më të bukur (Fjalën e Njësisë)!”** Lejl, 5-7)

Kurse Profeti (a.s) thotë:

**“Ai që fton për në rrugë të drejtë, ka të njëjtin shpërblim me atë që i përgjigjet ftesës së tij. Por kjo nuk e pakëson shpërblimin e tyre. Kush thërrret për në punë të keqe merr mëkate sa ata që e bëjnë, dhe kjo nuk e pakëson mëkatet e atyre që e ndjekin”** (Muslim, Ilim, 16)

*“Sa fatlum  
është ai, të cilit i  
është dhënë mirësia  
e ndjekjes së sunetit,  
urdhrave të të  
Dërguarit të Allahut  
(a.s)! Sot edhe punët  
më të vogla që bëhen  
duke besuar se feja e tij  
është e vërtetë, renditen  
në kategorinë e punëve  
të mëdha...”*

(Mektubati, Rabani,  
Letra 44)

Pra shpërblimi i përpjekjeve për të udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë e të vërtetë, i ngjan një topi bore që duke rënë nga një pikë e lartë rritet duke vënë shtresë mbas shtrese deri sa shndërrohet në një ortek të madh.

Nga ana tjetër predikimi i Islamit është një “xhi-had i madh” Allahu thotë në Kuran:

**Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani).** (Furkan, 52)

Urdhri për të **“luftuar me forcë”**, i përmendur në këtë ajet, zbriti në periudhën e Mekës, në një kohë kur besimtarët nuk kishin forcë materiale për t’i luftuar politeistët. Ky urdhër hyjnor zbulon një nga kuptimet më të rëndësishme të xhihadit, atë të kumtesës së parimeve kuranore përmes praktikimit në jetë. Sepse muslimanët në atë periudhë nuk kishin asnjë armë në dorë, ata vetëm mësonin dhe predikonin Kuranin. Ata përpiqeshin të predikonin Islamin duke kapërcyer një sërë vështirësish dhe pengesash.

Për të arritur rezultatin e duhur në predikimin e islamit, së pari duhet të angazhohemi seriozisht me Kuranin dhe të bëhemi një Kuran i gjallë në tokë sepse kjo është mënyra më e mirë për të predikuar dhe prezantuar islamin, bukuritë e islamit bëhen më të dukshme kur i ekspozojmë në veten tonë.

Profeti (a.s) në çdo moment i nxiste dhe inkurajonte besimtarët për rëndësinë e predikimit dhe përçimit të mesazhit islam. Në një hadith thotë:

*“Përcillni tek njerëzit, qoftë edhe një ajet nga unë.”* (Buhari, Enbija, 50.)

*“Allahu ia zbardhtë fytyrën atij që, atë që ka dëgjuar prej nesh ua përcjell të tjerëve njësoj siç e ka dëgjuar! (Sepse) ka shumë njerëz, të cilët, dijet që u përcillen i kuptojnë dhe i praktikojnë më mirë se ai që i ka dëgjuar ato.”* (Tirmidhi, Ilim, 7.)

Pengimi i njerëzve nga e keqja dhe e shëmtuara është si gurë qosheje për besimin siç e shpreh edhe Profeti (a.s) rëndësinë e kësaj mbi besim në hadithin:

*“Kush nga ju sheh një të keqe, le ta korrigjojë atë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi, atëherë le ta bëjë me fjalën e tij. E, nëse se ka të mundur as këtë, atëherë le ta urrejë me zemrën e tij. Mirëpo, kjo është gjendja më e dobët e besimit.”* (Muslim, Iman, 78)

Profeti jep një shembull shumë të bukur në

lidhje me përgjegjësinë e inkurajimit ndaj të mirës dhe ndalimit nga e keqja:

*“Shembulli i një njeriu që respekton kufijtë e vënë nga Allahu dhe një njeriu që shkel ato është sikurse shembulli i njerëzve që hipin në një anije pasi të hedhin short. Disa prej tyre gjenden nën kuvertë, disa në kuvertë (pjesa e sipërme e anijes). Ata nën kuvertë, sa herë që u duhet uji, e kërkojnë nga ata mbi kuvertë, prandaj propozojnë: ‘Sikur ta hapnim një vrimë në dyshtemenë e anijes, nuk do t’ju bezdisnim (me kërkesat për ujë)’. Nëse ata sipër kuvertës do t’i lenin ta zbatonin idenë e tyre, të gjithë do të fundoseshin; nëse nuk i lejojnë, të gjithë do të mbeten të sigurt.”* (Tirmidhi, Fiten, 12)

Profeti(a.s) na tregon se si kanë filluar të degenerojnë hebrenjtë:

*“Prishja e parë në mes të Bijve të Izraelit ka filluar kështu. Një person, kur shikonte dikë duke bërë një të keqe e kritikonte duke i thënë:*

*“Shiko miku im! Kije frikë Allahun dhe hiq dorë nga kjo që bëre! Sepse kjo nuk është hallall për ty”. Ditën tjetër, me qëllim që të ulej pranë tij dhe të hanin e pinin së bashku, nuk e këshillonte më. Ja pra, atëherë Allahu i Lartësuar i bëri zemrat e tyre të ngjashme me njëra-tjetrën.”*

Profeti (a.s) ndërsa po tregonte ishte i mbështetur pastaj menjëherë u drejtua dhe tha:



*“Edhe ju ose do të këshilloni njëri-tjetrin në punë të mira, do të ndaloni nga e keqja dhe do t’i qëndroni përballë padrejtësisë së tiranit, ose përndryshe Allahu i Lartësuar ua përngjan zemrat tuaja njëra-tjetrës dhe ju mallkon ashtu sikurse mallkoi Bijtë e Izraelit.”* (Ebu Davud, Melahim, 17/4336)

Ashtu siç shprehet Imam Gazaliu: Të qëndruarit bashkë me jomyslimanët, gjynahqarët dhe neglizhentët, sjell njësim të mentaliteteve; njësimi i mentaliteteve transformohet në njësim të zemrave. E kjo situatë tregon zvarritjen e ngadaltë të njeriut drejt shkatërrimit.

Neglizhimi i detyrës së predikimit islam tek njerëzit shkakton dëme të pariparueshme në këtë botë dhe botën tjetër. Në lidhje me këtë të vërtetë Ebu Hurejre (r.a), transmeton:

*Ditën e Kiametit një njeriu i afrohet një njeri i panjohur dhe e kap nga gryka. Njeriu habitet dhe i thotë:*

*“Çfarë kërkon unë? Unë nuk të njoh fare!”*

*Njeriu që e ka sulmuar ankohet me këto fjalë:*

*“Kur ishin në Tokë, ti më ke parë duke bërë gabime dhe punë të këqija, por nuk më paralajmërove, nuk më pengove.”* (Mundhiri, et-Tergib ve’t-Terhib, Bejrut 1417, III, 164/3506; Rudani, Xhem’u’lfevaid.)

Personi që do të predikojë islamin duhet të

jetë i pajisur me dituri, moral dhe sjellje të mira. Nuk mund të përfytyrohet një predikues islam injorant, sepse një i tillë nuk mund të shpëtoje nga gabimi as në metodë as në përmbajtje. Prandaj kjo rrugë ka nevojë për dituri dhe atmosferë shpirtërore.

Nga ana tjetër, çdo besimtar në rolin e predikuesit duhet fillimisht të formojë personalitetin e tij, pasi rruga më ndikuese për t’i udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë është të qenurit një shembull konkret i drejtësisë, mirësisë, bukurisë dhe largpamësisë. Nga kjo pikëpamje peygamberët kanë qenë modele të shkëlqyera në popullin e tyre në të gjitha aspektet e jetës. Nisma e predikimit nga një person që nuk është i pjekur shpirtërisht është një lidhje e kotë dhe një gabim i madh njëkohësisht. Një person i tillë në vend që t’i bëjë mirë e dëmton islamin dhe bëhet shkak për t’i larguar njerëzit nga islami.

Siç thotë Aliu (r.a) “Hija e shkopit të shtrembër është e shtrembër” pra nga e shtrembra nuk del e drejta.

Allahu në lidhje me mënyrën e predikimit në Islam thotë:

**Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!** (Nahl,125)

Aliu (r.a.), shprehet:

“Njerëzve, tërhiquni vërejtjen me fjalë të urta që i bëjnë të mendojnë. Kjo, do t’i qetësojë zemrat e tyre.”

“Qetësojini shpirtat tuaj me fjalë dhe vepra të urta”

Ndërsa ftojme njerëzit në udhëzim duhet të ndjekim një stil komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm. Siç thotë Rrumiu: “Nuk ka rëndësi sa shumë di por sa kupton personi përballë.

Besimtari në rrugën e vështirë të predikimit duhet të jetë tolerant dhe i butë, në komunikim duhet të përdorë një gjuhë të ëmbël.

Një tjetër parim që duhet të ndjekë predikuesi është ndjenja e përgjegjësisë për shoqërinë dhe të vlerësojë njerëzit. Predikuesi asnjëherë nuk duhet ta nxjerrë nga mendja se njeriu është krijesa më e vyer dhe e çmuar e krijuar nga Zoti.





# PESË RREGULLA

— Ahmet Zijlan —

Përgjatë gjithë jetës gjithmonë dëshirojmë të fitojmë. Të fitojmë jetën, të fitojmë këtë botë dhe botën tjetër... Fitimi dhe arritja e suksesit është diçka që e dëshirojnë të gjithë. Suksesi duhet të arrihet edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Etërit tanë kanë thënë: “Pasuria të pajton. Ndërsa varfëria të bën të zihesh.” Pasuria hap shumë kyçe dhe zgjidh shumë probleme. Paraja është shumë gjëra, por nuk është çdo gjë. Paraja është edhe mirësi, edhe fatkeqësi.

Zoti (xh.sh.), na ka dhënë edhe shëndet, edhe mendje. Organet punojnë siç duhet, sytë shikojnë dhe veshët dëgjojnë. Mund të flasësh dhe mund të dëgjosh... Çdo gjë funksionon në formë të përsosur. Mbi të gjitha, ke lindur nga prindër myslimanë në një vend islam dhe je rritur ndërmjet njerëzve me besim. Gjithashtu ke edhe besimin, i cili është mirësia më e madhe. Të gjitha pasuritë janë të tuat. Përveç të tjerash, ke edhe një udhërrëfyes, pra, të Dërguarin e Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Ke edhe librin e shenjtë, Kuranin Fisnik që të tregon të mirën e të keqen dhe që të njofton për ato që duhet të bësh. Allahu Teala të ka dhënë

gjithë këto mirësi në këtë botë. Ndërsa në lidhje me botën tjetër, çështja është lënë në dorën tënde. Ja xheneti, ja edhe xhehenemi!..

Allahu Teala nuk thotë që “të punosh vetëm për ahiretin”, por thotë se “kjo botë është ara e ahiretit. Që të dyja fitohen këtu”. Ne duhet të punojmë për ta siguruar jetesën në këtë botë, për të qëndruar në këmbë dhe për t’u bërë të dobishëm për të tjerët pa e harruar ahiretin. Myslimani nuk duhet të jetë dembel dhe i vobektë. Myslimani duhet të jetë i vetëdijshëm, i aftë, sakrifikues, bujar, i ndershëm, durimtar, punëtor, njeri që e bën bukur çdo punë, fytyrëqeshur, fjalëmbël, njeri me dinjitet, i mëshirshëm, largpamës, njeri që nuk mashtron, njeri që mendon, i drejtë, i dashur dhe modest. Të gjitha cilësitë e bukura duhet të gjenden te myslimani. Ai duhet të përpiqet për të poseduar fuqi materiale. Në punën, artin apo shkencën që bën, duhet të arrijë të njihet e të tregohet për mirë me gisht... Myslimani duhet të lexojë, të mësojë dhe të punojë shumë. Zoti (xh.sh.), i jep të mira atij që punon me cilësi. Myslimani nuk duhet të shfaqë mangësi në marrjen

e masave dhe duhet ta pranojë caktimin e Allahut Teala. Gjuha e tij asnjëherë nuk duhet të ndalojë së përmenduri Zotin (xh.sh.) dhe gjithmonë duhet ta falënderojë Atë. Kur Allahu Teala të na japë, atëherë duhet të kemi kujdes ndaj këtyre pesë rregullave:

### **RREGULLI I PARË:**

#### **PASURIA NUK DUHET TË BËHET SHKAK PËR PAKËSIMIN E IBADETEVE!**

“Kjo botë është ara e botës tjetër.” Jeta jonë është një kapital që na është dhënë për të fituar xhenetin. Nëse Allahu Teala të ka dhënë pasuri apo famë dhe nëse shqetësimet për të tjerët apo për punën të bëjnë që të shfaqësh mangësi në ibadetet si namazi, agjërimi, haxhi etj., nëse vjen koha e iqindisë duke thënë: “A ta fal tani apo ta fal më vonë namazin e drekës.”, nëse e neglizhon ibadetin apo veçanërisht nëse e lë krejtësisht atë, atëherë kjo pasuri dhe famë nuk janë aspak të dobishme. Një pasuri dhe famë që të pengon prej këtyre, më mirë të mos e kesh.

Pra, rregulli ynë i parë është: “Ahireti para së gjithash!” – sepse jeta e vërtetë është jeta e ahiretit. Asnjë punë e kësaj bote, asnjë mbledhje dhe asnjë fitim nuk mund ta zërë vendin e një farzi sado fitim që të të sjellë. Për këtë arsye, asgjë nuk duhet të jetë pengesë për namazin. Mendimet: “E bëj më vonë apo e filloj më vonë.” – janë plotësisht boshe. Jeta befasisht mund të marrë fund. Pastaj pendimi nuk ka asnjë dobi.

Preokupimet nuk mund ta pengojnë myslimanin nga detyrat e tij që i ka farz. Ajeti fisnik është shumë i qartë: *“Ata janë njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.”* (Nur, 37)

Ne nuk urdhërohemi në mënyrën: “Mos bëj tregti! Mos hyr në industri! Vetëm shko në xhami, fal namaz dhe mbështetu te Zoti për rrëskun!” Por urdhërohemi kështu: “Bëj çfarëdo që të duash si tregtia, bujqësia, industria, puna në shtet etj., ama bëji duke i dhënë përparësi ahiretit! Të gjitha këto bëji duke mos i harruar detyrat e botës tjetër!”

Edhe sot myslimani duhet ta programojë punën, kohën dhe çdo gjë tjetër. Ai gjithashtu duhet ta gjejë patjetër kohën e duhur për t’u përgatitur edhe për ahiretin. Namazin, ligjëratën fetare, agjërimin, umren dhe haxhin nuk duhet t’i konsiderojë si pengesa për punën e tij. Nëse me të vërtetë këto bëhen pengesë për punën e tij, atëherë duhet të heqë dorë nga një mjedis i tillë negativ dhe ta ndryshojë punën. Zoti (xh.sh.), nuk e jep rrëskun vetëm nga

një vend. Qëllimi nga jeta nuk është vetëm për të fituar dy-tri qindarka. Prej një fitimi që arrihet në këtë mënyrë nuk ka dobi as kjo botë, as bota tjetër, as fëmija, as bashkëshortja... Ai që fiton në këtë lloj forme, në ahiret hyn në zjarr, ndërsa pasurinë e tij e hanë të tjerët.

### **RREGULLI I DYTË:**

#### **FITIMI YT NUK DUHET TË JETË NË DËM TË ASKUT!..**

Lakmia për të fituar nganjëherë i bën njerëzit aq të pashpirt saqë mund të mendojnë në mënyrë barbare e të pandërgjegjshme si: “Le të fitoj unë, të tjerët pak rëndësi kanë!” Myslmani duhet të largohet nga ky mentalitet... Shembulli i Imam Ebu Hanifes, i cili është imami i medhhebit tonë, është i njohur. Atij i erdhi një copë. Shitësi nuk e dinte vlerën e mallit. Për shembull, tha: “200 dirhemë!” Imam Azami tha: “Jo, ky mall bën 100 dirhemë!” Pra, ai nuk tha: “Sidoqoftë ky është çmimi që jep klienti! Askënd s’po e mashtroj.” Me anë të këtij rregulli, myslimani asnjëherë nuk duhet të shndërrohet në një kapitalist të pandërgjegjshëm. Edhe nga paraja që fitohet me veprime për t’i zhytur rivalët apo me mendime për t’i shtypur ata, nuk vjen ndonjë dobi.

### **RREGULLI I TRETË:**

#### **MYSLIMANI DUHET TË FITOJË NË MËNYRË HALLALL DHE DUHET TË LARGOHET NGA HARAMET**

Nëse ka hyrë haram në fitimin tënd dhe t’i e ke përvetësuar këtë sikur të ishte diçka normale ndërkohë që mendon të bëhesh i pasur, atëherë do të ishte më mirë sikur të mos e kishe atë fitim dhe pasuri. Ta prodhosh dhe ta shesësh alkoolin që është haram, të fitosh duke hapur vende pune si mejhane, lokal me alkool, kazino, etj., të fitosh para nga haramet si ryshfeti, kamata etj., me mendimin: “Po fitoj jetesën, po fitoj rrëskun e familjes dhe të fëmijëve të mi.” – nuk kanë asnjë aspekt që mund të justifikohet. Kjo do të thotë luftë kundër Allahut të Madhëruar.

Vjedhja, uzurpimi, fitimi me anë të mashtrimit, fitimi duke dhunuar të drejtat e të tjerëve, marrja me forcë, droga, arma apo trafikimi i njerëzve... të gjitha këto janë haram. Nëse në fitim hallall hyn një pjesë haram, atëherë e ndyn të tërin. Për këtë arsye, duhet të largohemi krejtësisht edhe nga një grimcë e haremeve që i ka ndaluar Allahu Teala. Këtyre nuk duhet t’u drejtohem kurrë me mendimin: “Do të fitojmë para. Do të bëhemi të pasur.” Nëse me këtë fitim ndërton ndonjë xhami, kryen haxhin apo bën ndonjë mirësi, prapë se prapë nuk mund

ALLAHU TEALA TË VARFRIN DHE SKAMNORIN IA KA LËNË AMANET TË PASURIT. TY TË KA DHËNË, NDËRSA ATIJ NUK I KA DHËNË. NË KËTË MËNYRË, AI PO TË SPROVON NËSE DO TA NDASH ME ATË APO JO. PËR KËTË ARSYE, ZEKATIN DUHET TA LLOGARISËSH MIRË. PASI TA LLOGARISËSH, DUHET TA JAPËSH NË VENDE KU JEPET ZEKATI. PËR SHKAK SE KUFIRI ËSHTË NJË E DYZETA APO DY PËR QIND E GJYSMË, DUHET TË JAPËSH PAK MË SHUMË.

të shpëtosh. Allahu na ruajt, ky fitim do të thotë se e ke vendin gati në xhehenem. Por nëse largohesh nga haramet dhe i drejtohesh vetëm hallallit, Zoti (xh.sh.), do të ta japë rrëskun prej hallallit. Nëse ka përzierje të tilla në fitimin tënd, menjëherë pendohu, hiq dorë prej tyre dhe përpiku të fitosh e të hash prej hallallit.

### **RREGULLI I KATËRT: MYSLIMANI DUHET TA KRYEJË ZEKATIN DHE TË JAPË PËR HIR TË ALLAHUT!..**

Kur Allahu Teala të të japë pasuri apo pozitë, këto duhet t'i pranosh se i ke nga Ai. Duhet ta japësh zekatin dhe pasurinë duhet ta ndash me të afërmit, shokët dhe njerëzit e tjerë. Asnjëherë nuk duhet të mendosh se do të pakësohet, por përkundrazi, duhet ta kuptosh se Allahu Teala do të të japë edhe më shumë. Nëse nuk vepron në këtë mënyrë, atëherë përsëri do të ishte më mirë të mos e kesh atë pasuri.

Allahu Teala të varfrin dhe skamnorin ia ka lënë amanet të pasurit. Ty të ka dhënë, ndërsa atij nuk i ka dhënë. Në këtë mënyrë, Ai po të sprovon nëse do ta ndash me atë apo jo. Për këtë arsye, zekatin duhet ta llogarisësh mirë. Pasi ta llogarisësh, duhet ta japësh në vende ku jepet zekati. Për shkak se kufiri është një e dyzeta apo dy për qind e gjysmë, duhet të japësh pak më shumë. Nëse nuk mund ta bësh llogarinë e saktë dhe mendon: “Unë po e jap zekatin.” – do ta japësh mangët pa e kuptuar. Në këtë mënyrë, do të ngelet haku i dikujt te ti. Nëse të ngelet haku i dikujt te ti, atëherë dihet pasoja që ka.

Kur njerëzit bëhen të pasur, veçanërisht nëse rrethohen nga njerëz të varfër, ata i kapin për rrobash. Pra, mendojnë në këtë mënyrë: “Dikush prej nesh po pasurohet, prandaj le të na pasurojë edhe ne.” Si u afroresh atyre? A ua zgjat dorën e ndihmës? Apo vallë merr një hanxhar dhe ua pret duart atyre njerëzve që kanë qenë më ty që nga e kaluara e deri më tani? Nëse vepron në këtë mënyrë, atëherë kjo është mendjemadhësi, egoizëm, koprraci, pëlqim i

vetes duke e harruar të kaluarën.

Të përkujdesesh edhe për të tjerët ndërkohë që fiton, nuk do të thotë patjetër të japësh lëmoshë. Me ndonjërin mund të bësh ortakëri, ndërsa dikë tjetër mund ta ndihmosh për të hapur ndonjë biznes apo për të gjetur ndonjë punë. Domethënë, njerëzit duhet t'i mësosh të kapin peshkun, jo t'ua japësh këtë të fundit. Por edhe atyre që nuk kanë mundësi të punojnë, duhet t'ua zgjasësh dorën e ndihmës duke u dhënë lëmoshë. Për njerëzit që janë në këtë klasë duhet të përkujdesesh duke u dhënë pak apo shumë sipas mundësisë. Nëse ke ndonjë kauzë apo një ideal, duhet të përpiqesh edhe për atë. Në këtë mënyrë, i shërben edhe kauzës apo idealit tënd. Si rezultat, pasuria jote bëhet shkak që të fitosh ahiretin.

### **RREGULLI I PESTË: DUHET TA PRANOSH SE SUKSESI VJEN NGA ALLAHU TEALA**

Pra, nuk duhet të thuash: “Unë fitova.” Për punën që ke bërë, suksesin që ke korrur dhe fitimin që ke arritur, nuk duhet të thuash: “Unë e kam bërë, unë mendova, unë punova, unë përdora mendjen, unë shfaqta aftësinë...” Kush je ti? Kush jemi ne? Nëse Allahu Teala nuk dëshiron, askush nuk mund të bëjë asgjë. Zogu nuk mund t'i rrahë krahët. Prandaj çdo gjë që vjen, duhet ta pranojmë se vjen nga Allahu (xh.sh.). “Hajrihi ve sherr-rihi minall-llahi teala / e mira dhe e keqja, pra çdo gjë vjen nga Allahu.” Ajeti kuranor është shumë i qartë në lidhje me Luftën e Bedrit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kur gjuajte, nuk gjuajte ti, por gjuajti Allahu.”** (Enfal, 17) Për këtë arsye, nuk kemi pse të lavdërohem. Ka një histori të bukur:

Kur një dervish po ecte në rrugë, një person i pa-cipë e kishte gjuajtur me gurë pa asnjë arsye dhe ia kishte çarë kokën. Dervishi nuk ishte nxehur aspak, nuk i kishte thënë gjë dhe kishte vazhduar rrugën. Ndërsa kishte kaluar pranë një furre buke, furrtarit i kishte ardhur keq për gjendjen e tij dhe i kishte dhënë një bukë. Dervishi e kishte falënderuar

edhe atë, e kishte futur bukën nën sqetull dhe kishte vazhduar rrugën e tij. Dervishi kishte takuar dikë që e njihte. Ai e kishte pyetur: “Kush ta ka çarë kokën?” Dervishi i ishte përgjigjur: “Ai që më ka dhënë këtë bukë.” Personi e kishte pyetur përsëri: “Mirë, por kush ta ka dhënë bukën?” Dervishi këtë herë i ishte përgjigjur: “Ai që më ka çarë kokën.” Për këtë arsye, duhet falënderim për mirësitë dhe durim për sprovat e Allahut Teala. Mirë, por çfarë ndodh nëse thua: “Unë fitova!” Atëherë bëhesh mendjemadh, egoist dhe koprrac. Domethënë se ky rregulli i pestë është edhe garancia e rregullave të tjerë. Nëse një nevojtar të kërkon ndihmë, nuk duhet të thuash: “Unë e kam fituar vetë këtë pasuri. Prandaj edhe ai le të punojë dhe të fitojë!”

Njerëzve që janë të pasur gjithmonë u janë tërhequr veshët, sepse të qenët i pasur është një gjendje mjaft e rrezikshme. Pra, është një gjendje pothuajse sikur të qëndrosh mbi thikë, sepse nefs i dëshiron të të zvarrisë drejt egoizmit duke të thënë: “Ti e ke fituar vetë këtë pasuri!” Njeriu fillon ta shohë veten më lart se të tjerët dhe të mburret kur bëhet i pasur. Ngaqë i ka mundësitë ekonomike të mëdha, probabiliteti i tij për të rënë në kurthin e shejtanit të mallkuar është më i lartë se i njerëzve që nuk janë të pasur duke e tepruar në shpenzime apo duke u zhytur në ndonjë gabim. Nëse veten nuk e pranon si ruajtës i amanetit, këto fatkeqësi do të të gjejnë.

Nëse nuk e pranon se pasuria vjen nga Allahu Teala, i sheh nga lart dhe i largon nga vetja shokët, të afërmit dhe të varfrit me të cilët ke qenë në të kaluarën. Pastaj fillon të mos e japësh zekatin dhe të mos i kryesh farzet. Allahu na ruajt nga kjo gjendje! Por nëse thua: “Allahu e ka dhënë!” – do ta kujtosh se je një ruajtës i amanetit. Për këtë arsye, nuk do të harrosh të marrësh atë që mund ta marrësh. Kur herët apo vonë ta veshësh këmbësh pa jakë dhe pa xhepa, domethënë, kur ta veshësh qefinin, do të të kujtohet se nuk mund të marrësh dot asgjë me vete. Kur ta arrish këtë gjendje, nuk do t'i neglizhosh farzet, do ta japësh zekatin, madje edhe më shumë dhe do t'u dalësh për zot miqve e të afërmve.

Këto pesë cilësi janë kusht. Nëse njeriu i arrin këto pesë cilësi, e vlerëson siç duhet pasurinë. Pra, e shikon parane si një mjet. Në të kundërt, njeriu vjen deri në atë gjendje saqë mund ta adhurojë paranë. Kur duhet të japë, dora nuk i jep dot. Pastaj pandeh se paraja e bën të fuqishëm dhe se i jep prehje. Ndërsa kur ta humbasë, pandeh se do të humbasë çdo gjë. Më ka treguar një shoku im që quhet Mehmet Ajvazogllu:

Ai kishte shkuar te vendi i punës së një biznesmeni që e njihte. Kur kishte arritur, kishte vënë re se punëtorët po protestonin te dera. Ata bërtisnin me të madhe. Ai kishte shkuar pranë tyre dhe u kishte thënë: “Ju keni punuar për një kohë të gjatë në këtë vend pune. Keni ngrënë bukën e këtij institucioni. A nuk është turp për ju? Ju po shfaqni veprime poshtëruese.” Punëtorët i kishin thënë: “Vëlla, së pari na dëgjo! Pastaj vendos nëse kemi të drejtë apo jo! Ai na ka nxjerrë prej pune dhe nuk na e ka dhënë dëmshpërblimin. Ia kërkuam, por ai na nxori jashtë duke na thënë: “Çfarë dëmshpërblimi?” A nuk kemi të drejtë që ta kërkojmë hakun tonë?” Shoku im kishte hyrë brenda. Këtë herë i ishte nxehur biznesmenit që e njihte: “Shoku im, çfarë po bën? Përse nuk ua jep atyre të drejtën që u takon?” Ai i kishte thënë: “Për cilën të drejtë e ke fjalën?” Shoku im i kishte thënë: “Si për cilën të drejtë e kam fjalën? Ata kanë të drejtën e tyre. Ne kemi një ligj pune. Nëse ti nuk ua jep të drejtën atyre, sigurisht se do të protestojnë te dera. Nëse prapë nuk ua jep, do të të padisin në gjykatë. Herët apo vonë do ta marrin të drejtën e tyre. Përse e çon kompaninë tënde në këtë gjendje? Përse nuk ua jep të drejtën punëtorëve?”

A e dini se çfarë i kishte thënë biznesmeni? Ai i kishte thënë kështu:

“Mos më thuaj pse nuk ua jap! Zemra nuk më bën që t'ua jap! Merre çelësin e kasafortës. Ndërsa unë po të kthej kurrizin. Ti merri paratë dhe jepua!” Shoku im kishte vepruar siç i kishte thënë ai. Më pas punëtorët ishin larguar.

Mendon: Biznesmeni as nuk mund të jepte, as nuk mund të shikonte kur merreshin paratë e tij. Kjo nuk është gjë tjetër vetëm se vlerësim i parashë më shumë seç duhet. Allahu na ruajt!

Ata që bëjnë vetëvrasje ngaqë kanë falimentuar dhe ata që hyjnë në stres ngaqë kanë humbur një sasi parash, bien në këto gjendje ngaqë nuk i respektojnë këta pesë rregulla.

Lumturia e njeriut nuk vjen prej pasurisë, parave dhe komfortit, por vjen nga prehja shpirtërore që ia jep zbatimi i detyrave kundrejt Allahut Teala, nga lutja dhe nga begatia e adhurimit, zekatit dhe mosdëmtimit të askujt.

Allahu i Lartësuar na bëftë prej atyre që e shohin jetën e kësaj bote si arën e ahiretit! Mos na bëftë prej atyre që janë të magjepsur nga paraja! Na e lehtësoftë që ta përdorim paranë si një mjet! Çfarëdo që të na japë, na e dhëntë prej më të mirës! Amin!..



# LARGOHU NGA DYSHIMET

— Doç. dr. Mustafa Xhanllë —

*“DO TË VIJË NJË KOHË QË,  
NJERIU NUK DO TA SHOHË  
NËSE PASURINË PO E FITON  
NGA HALLALLI APO NG  
HARAMI.” (BUHARIU, BUJU, 23.)*

Besimtari i sotëm jeton në një orvatje të vërtetë shpirtërore. Besimtari, i cili thotë se i ka besuar Allahut dhe që i është dorëzuar Atij, gjendet brenda një çmendurie të konsumimit të pakontrolluar, pa vënë re çfarë është haram, çfarë është hallall e çfarë është e dyshimtë; gjendet i lëshuar pas dëshirave të paepura të nefsit.

Sikur të dojë të vërtetojë ajetin kuranor: *“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?”* (Furkan, 43.), e ka lëshuar veten tashmë pas kurtheve të jetës. Nga ta shpiejë nefsi andej drejtohet në

mënyrë të pavetëdijshme.

Në fakt shekuj më parë, Krenaria e Gjithësisë, Muhamedi (s.a.s.), i shqetësuar nga drejtimi drejt nefsit që mund të bënte ymeti i tij, ashtu siç e përmendëm edhe në hadithin më lart, kishte paralajmëruar se nga do të merrnin drejtim njerëzit në këtë botë, pa pasur fare shqetësimin nëse është hallall apo haram ajo çfarë bëjnë. Ai shprehet në këtë mënyrë:

*“Merreni atë që është hallall dhe lijeni atë që është haram.”* (Ibni Maxhe, Tixharet, 2.) Ndaj dhe besimtari, duhet të bëjë një jetë duke bërë kujdes hallallin dhe haramin dhe duhet të ndjekë vetëm ato çfarë janë të lejuara.

Hallalli dhe harami është një *kornizë hyjnore* (hududullah) për njeriun. Hallalli dhe harami janë kufijtë që ka vendosur Zoti i Madhëruar për njerëzit që jetojnë në Botë, pra janë njëfarë caqesh. Besimtari duhet të respektojë aq sa të mundet këto caqe. Pasi këto caqe, janë të rëndësishme për të bërë një jetë të lumtur dhe për të arritur shpëtimin e amshuar në botën tjetër.

Hallalli është ajo çfarë është e bukur. Harami është ajo çfarë është e shëmtuar.

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Famëlartë, për fjalën “hallall” përdor shprehjen “e bukur”. Po; një tjetër emër i hallallit është e bukura. Edhe besimtari ashtu sikurse është vetë i bukur, duhet të shkojë mbas së bukurës.

Hallalli është i pastër, kurse harami është i ndotur.

Allahu i Madhëruar thotë kështu:

***“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë dhe, nëse jeni adhures të Allahut, falënderojeni Atë!”*** (Bekara, 172.) Hallalli, ashtu sikurse pastron trupin, pastron edhe shpirtin. Shpirti, i cili ndjek gjithmonë gjurmët e hallallit, larg ndotjes së haramit, afrohet edhe më pranë Zotit të Madhëruar.

Në gjërat hallall ka begati, kurse në haram nuk ka si të ketë begati.

Zoti i Madhëruar na drejtohet kështu:

***“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë...”*** (Bekara, 276.) Kështuqë, besimtari duhet të kërkojë begatinë dhe t’i drejtohet hallallit. Që nga dita e parë që ka zbritur njeriu në rruzullin tokësor nuk ka dëshmuar ndonjëherë që të ketë begati paraja që fitohet përmes rrugës së haramit.

Duatë janë më të pranueshme nëse vepron me hallall.

Një ditë Pejgamberi (s.a.s.) këshilloi në këtë mënyrë Sa’d bin Ebi Vakkasin (r.a.):

***“Bëj kujdes që ato që ha të jenë prej hallallit, që të të pranohen duatë.”*** (Taberani, Muxhemulvasat, VI, 310).

Nuk i pranohet duaja e atij që fitesën e nxjerr nga harami.

Lidhur me këtë, Pejgamberi ynë (a.s.), jep një shembull mjaft domethënës:

***“Një njeri kishte drejtuar duart nga qielli dhe po përgjerohej: “O Zot! O Zot!” Ndërkohë që, ajo çfarë hante ai ishte haram, ajo çfarë pinte ishte haram, ajo çfarë veshte ishte haram, ushqimin e kishte haram! Si mund t’i pranohet këtij njeriu duaja, përse kohë që është në këtë gjendje?”*** (Muslimi, Zekat, 65)

Nëse dëshironi të shijoni ibadetet duhet t’i

drejtoheni hallallit.

Një besimtar që jeton brenda rrethit të hallallit, kryen me plot kënaqësi dhe entuziazëm ibadetet.

Kurse harami i jep gaflet njeriut. Si përfundim, mbrapa mbesin ibadete pa ashk dhe dashuri – Zoti na ruajtë! I nderuari Ibrahim Et’hemi ka thënë kështu:

“Ata që analizojnë nëse ajo çfarë hyn në stomakun e tyre është haram apo hallall, lartësohen nga aspekti i imanit. Kurse ata që gjurmojnë kënaqësitë e kësaj bote, duke mos menduar fare nëse është prej hallallit ajo çfarë ata fitojnë; fillimisht u shkatërrohet stomaku, pastaj u ikën qetësia, nuk mund të lartësohen shpirtërisht, biejnë poshtë. Nuk mund të arrijnë kënaqësinë as të ibadeteve e as të mirësive që bëjnë.”

Ekziston një kundërhelm që pengon drejtimin e njeriut nga harami. Ajo është edukata e “të mjaftuarit me pak” ose “vetëmjaftueshmëria”.

Një besimtar që vepron brenda kornizës së kësaj edukate, madje edhe brenda rrethit të hallallit vepron me kujdes, mjaftohet me pak. Një besimtar që ka edukatën e mjaftueshmërisë me pak, thuajse është e pamundur të bëjë haramë. Në këtë kontekst, agjërimi është një ibadet rrënjësor, që përmban në zenitin e vet edukatën e mjaftueshmërisë me pak. Të mjaftohesh me pak, madje të mos zgjatësh duar as nga ajo çfarë është hallall... Për kë kjo gjë? Për hatër të Tij... Besimtari që nuk përpiket të marrë as hallallin madje për hir të Allahut, dëlirohet aq shumë sa, arrin shpëtimin dhe amnistinë hyjnore.

Ambicia gjendet në krye të shkaqeve që e shpiejnë njeriun për në haram. Kësaj mund t’i themi edhe dëshirë e paepur dhe e pafrenuar... Pra, të mos mjaftuarit me pak... Të duash, të ndiesh nevojën më të shumtës, edhe më të tepërtës...

Për shembull; një njeri që ka një makinë, sado të vjetër, nëse bie pre e dëshirës së paepur të nefsit, i cili do “edhe më shumë”, merr para me interesë – që sot dera e së cilës është gjithmonë e hapur- bie në sevdanë e një makine të re.

Të qenit i dhënë pas haramit, e cila është pjesë e natyrshmërisë së njeriut, në fakt është



një lojë e nefsit, është një përfundim i dëshirave të nefsit që nuk kanë fund. Një nga mënyrat për të shpëtuar nga kjo dredhi e nefsit është të posedojmë edukatën e vetëmjaftueshmërisë me pak, të qenit njerëz të kënaqur me pak. Pasi, një besimtar që mjaftohet me pak, nuk mund të kërkojë më shumë, më tepër.

Në fenë tonë hallallat dhe haramet janë krejtësisht të qarta. Në një hadith, këtë situatë Pejgamberi (s.a.s.) e shpreh në këtë mënyrë:

*“Hallalli është përcaktuar në librin e Allahut. Po ashtu edhe harami është përcaktuar në Librin e Allahut...”* (Tirmidhiu, Libas, 6.)

Rrethi i hallallit është i gjerë, mes tij dhe haramit ekziston një vijë e verdhë, që kjo vijë është vija e gjërave të dyshimta. Nëse njeriu qëndron shumë mbi vijën e verdhë, rrezikon në çdo moment që të bie në haram. Ndaj dhe besimtari duhet të bëjë maksimumin duke u ruajtur nga gjërat e dyshimta. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), e shpreh në këtë mënyrë nevojën për t’u ruajtur nga gjërat e dyshimta:

*“Hallalli është i qartë, ashtu sikurse edhe harami. Kurse mes tyre ka gjëra të dyshimta të cilat njerëzit nuk i njohin. Ndaj dhe ai që ruhet nga gjërat e dyshimta, atëherë ai ka ruajtur fenë dhe nderin e tij. Kurse ai që bie në gjëra të dy-*

*shimta, vërtetë ai ka rënë në haram.”* (Muslimi, Musakar, 107.)

Ebul-Havra es-Sa’di i është drejtuar Hasan bin Aliut (r.a.), duke i thënë:

- Çfarë ke mësuar përmendësh nga Resullahu, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem?

- Lëri gjërat që të ngjallin dyshim dhe bëji gjërat që nuk ke dyshim! – i qe përgjigjur ai. (Nesai, Eshribe, 50.)

Po! Besimtari, në saje të edukatës që merr duke u mjaftuar me pak dhe duke iu larguar gjërave të dyshimta, të cilat ndodhen brenda rrethit të hallallit, shpëton nga zinxhirët e nefsit dhe të shejtanit. Pra, lirohet. Pasi, ai që shkon pas nefsit është skllav. Një njeri i tillë, mund të bëhet rob i gjithçkaje tjetër përveç Allahut. Ndonjëherë bëhet rob i parasë dhe pasurisë, ndonjëherë i epshit. Sa jetë e errët!.. Ndërkohë që, liria e vërtetë është tek të qenit rob i Allahut. Sa e kthjellët dhe e ndritur që është rruga e një besimtarit që i është dorëzuar Zotit!

Zoti i Madhëruar na mundësoftë një rrugë të tillë të ndritur, që na bën të largohemi nga harami dhe nga gjërat e dyshimta. Na bëftë prej njerëzve që mjaftohen dhe kënaqen me pak...



**“O TË DËRGUAR!  
HANI NGA TË LEJUARAT  
DHE BËNI VEPRA  
TË MIRA! VËRTET,  
UNË E DI MIRË  
ÇFARË BËNI JU!”**

(MU’MINUN, 51)

# HANI NGA TË LEJUARAT DHE BËNI VEPRA TË MIRA!

— Irfan Êzturk —

## CILAT GJËRA JANË FITIM HALLALL DHE I PASTËR?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili është i obliguar për të shpjeguar shpalljen hyjnore, na e jep përgjigjen e kësaj pyetjeje duke u shprehur:

*“Ushqimi më i pastër që ha njeriu është ai (ushqim) që e fiton vetë.”* Enciklopedia e Hadithit, Kutubu’s-Sitte, 14-312.)

*“Njeriu nuk ka ngrënë gjë më hallall se një ushqim që e fiton me mundin e tij.”* (Buhari, Buju’, 15.)

Nisur nga kjo, risku i pastër për të cilin bëhet fjalë në ajet, është fitimi që besimtari e arrin duke punuar në përputhje me dispozitat që ka vendosur Allahu Teala. Sigurimi i riskut me anë të kësaj rruge është një farz / obligim për çdo besimtar.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpreh kështu këtë dispozitë në një hadith fisnik:

*“Sigurimi i jetesës në hallall është farz për çdo mysliman.”* (Taberani)

## ÇFARË I JEP BESIMTARIT KRYERJA E KËTJ FARZI / OBLIGIMI?

Të punosh për ta fituar riskun në hallall është ibadet.

Feja islame e konsideron ibadet të punuarit për ta fituar riskun në hallall. Të parët tanë kanë thënë:

*“Ibadeti / adhurimi është dhjetë pjesë. Nëntë prej këtyre pjesëve përbëjnë kërkimin e riskut në hallall.”* (Ihja, 2/236.)

Një njeri që i beson Allahut të Madhëruar, e kryen me ibadet detyrën e nënshtrimit që ka ndaj Tij, sepse ibadeti është borxh për çdo rob kundrejt Zotit (xh.xh.).

Përveç të tjerash, ka edhe një të vërtetë që duhet ta dimë. Ajo është: borxhi që duhet të paguhet

në mënyrën më urgjente është borxhi kundrejt Allahut Teala.

Përderisa njeriu merr frymë, është borxhli ndaj Zotit (xh.sh.)... Gjithashtu, ne nuk e dimë se kur do të marrë fund ajo frymë.

Besimtarët duhet ta bëjnë mirë llogarinë e çdo fryme që marrin e japin dhe absolutisht duhet ta harxhojnë në një formë që të shndërrohet në sevap ky kapital i vlefshëm, në mënyrë që të mos shkojnë me borxhe në botën tjetër.

Përgatitja për fundin absolut, domethënë, vdekjen, e cila është caktuar në pafillimësi dhe e cila dihet në mënyrë absolute nga Zoti (xh.xh.), por që ne nuk mund ta dimë, apo me një shprehje tjetër, për të mos u kapur nga vdekja pa qenë të përgatitur, myslimani duhet ta përdorë çdo çast për të kryer detyrat që ka ndaj Allahut Teala.

Ja pra, fitimi hallall është një mundësi e përkryer për ta adhuruar Zotin dhe për të kryer detyrën që kemi kundrejt Tij...

Madje, puna është një adhurim më i virtytshëm se disa ibadete nafie / vullnetare.

Isai, (a.s.), pa një burrë dhe e pyeti:

“Si je? Çfarë bën?” Burri iu përgjigj:

“Preokupohem me ibadet. Vazhdimisht i bëj ibadet Zotit. Hazreti Isai e pyeti përsëri:

“Kush ta siguron jetesën?” Burri i tha:

“Ma siguron vëllai.” Hazreti Isai ia ktheu:

“Në fakt, vëllai yt qenka ai që bëka ibadet.” (Ihja, 2/164.)

Por ka edhe një pikë tjetër që duhet të shpjegohet. Në ditët e sotme kanë dalë disa njerëz dhe japin fetva të gabuara duke u shprehur:

“Ai që punon me qëllim për të siguruar jetesën e familjes, është në adhurim. Për këtë arsye, nuk ka rëndësi nëse nuk i kryen ibadetet e tjera.” Kjo fetva shihet qartë se po ua ngatërron mendimet myslimanëve.

Njeriu nuk mund të rrijë gjithmonë larg mëkateve. Fakti që ai bën gabim ndonjëherë është rezultati normal i të qenit njeri... Veçanërisht në ditët e sotme, nuk është e lehtë të rrihet larg mëkateve... Andaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Jeni përpëlitur prej mëkateve. Prandaj mund të pastroheni me pendim.” Domethënë, ne, si njerëz dhe si robër mëkatarë, kemi nevojë për falje, në

mënyrë që të hyjmë në xhenet dhe të shohim Zotin (xh.xh.)...

Ja pra, përpjekja për të fituar në hallall ia mundëson robët këtë falje. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Kushdo që e kalon natën i lodhur prej punës së tij, do të thotë se e ka kaluar duke arritur faljen e Allahut.” (Enciklopedia e Hadithit, Kutubu's-Sitte, 14/312.)

Qoftë babai, i cili lodhet ditën për ta fituar në rrugë të lejuara riskun e familjes së tij apo qoftë nëna, e cila punon pa reshtur në shtëpi dhe kuzhinë për rehatinë e familjes së saj dhe të veten, përfshihet nga e njëjta falje hyjnore. Allahu i Lartësuar i shpërblen ata përgjatë gjithë natës duke ua falur mëkatet...

Sa mirësi e madhe! Edhe fitojmë para, edhe bëjmë ibadet në të njëjtën kohë...

Ata që zgjedhin rrugën e fitimit të lejuar janë ndërmjet banorëve të xhenetit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Banorët e xhenetit ndahen në tri grupe. Ato janë:

- Kryetari i shtetit që është i drejtë dhe i suksesshëm,

- Njeriu zemërbutë kundrejt të afërmeve dhe myslimanëve dhe;

- Njeriu që largohet nga fitimi haram dhe që nuk kërkon asgjë prej askujt, edhe pse familja e tij është kallaballëk.” (Muslim, Xhenet, 63.)

Të punojmë për ta fituar riskun në përputhje me pëlqimin e Allahut Teala... Të fitojmë me djersën e ballit në vend që t'ua zgjasim dorën të tjerëve... Në këtë mënyrë, do ta mbrojmë personalitetin tonë dhe do të hyjmë në xhenet...

Fitimi në hallall ia ngre pozitën njeriut te Allahu i Madhëruar.

Fitimi në hallall ia ngre pozitën njeriut edhe në ahiret, siç i jep atij edhe nder në këtë botë. Besimtarit, i cili do të arrijë shpërblime të ndryshme me çdo lloj vepre që bën në këtë botë, në botën tjetër i jep një jetë të lumtur dhe të përhershme në vendin ku gjenden të sinqertët...

Ja, a nuk është ky shpërblimi më i madh?

Sehli, (r.a.), i cili ishte prej sahabëve më të mëdhenj, thotë:

“Ai që dëshiron të lartësohet në shkallën e të

sinqertëve, le të fitojë nga hallalli dhe të veprojë sipas Sunetit.”

Në lidhje me këtë çështje, besimtari duhet të marrë shembull nga kjo këshillë që Lukmani i Urtë i dha birit të tij:

“Biri im! Mbrohu nga varfëria me fitim hallall! Atë që bie në varfëri e presin tri lloj fatkeqësish:

1. Dobësia në fe, sepse varfëria e zvarrit njeriun drejt së keqes.

2. Dobësia në mendje, sepse të menduarit e vazhdueshëm rreth nevojës e çorodit njeriun.

3. Humbja e burrërisë dhe e njerëzillëkut. Ndërsa fatkeqësia më e madhe edhe se këto, e cila e pret njeriun, është se ai bie në një pozitë në të cilën tallet nga të gjithë njerëzit.

### PO FITIMI NË HARAM!

Përsëri i Dërguari i Allahut (a.s.), na njofton se ka rreziqe të mëdha për ata që zgjedhin rrugën e haramit në fitimin e tyre.

Ja rreziqet e të ushqyerit me ushqim të fituar në haram:

Namazi është një ibadet të cilin besimtari nuk mund ta neglizhojë në jetën e tij. Ata që e nënvlerësojnë atë i pret një dëm i madh në këtë botë dhe në botën tjetër. Namazi është një ibadet i tillë që edhe në udhëtim, edhe në luftë me armikun nuk është e lejuar që të lihet.

• Namazi nuk mund të lihet për shkak të preokupimeve në këtë botë, domethënë, për shkak të tregtisë. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“O ju që keni besuar! Kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!”** (Xhumua, 9)

• Namazi nuk mund të lihet për shkak të ndonjë frike.

• Namazi nuk mund të lihet, edhe pse mund të ketë rrezik nga armiku përgjatë udhëtimit. **“Kur të udhëtoni, nuk është gjynah që ta shkurtoni namazin, nëse druheni që jobesimtarët do t’ju bëjnë ndonjë dëm. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiqtë tuaj të hapur.”** (Nisa, 101)

• Madje, edhe në luftë me armikun nuk është lejuar që të lihet namazi. **“Kur të jesh ti (o Muhamed) në mes të besimtarëve dhe të prish faljen e na-**

**ma-**  
**zit** (në luftë), **atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t’i mbajnë pranë edhe armët e veta! Pastaj këta, le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur dhe, le të falet me ty! Le të jenë syçelë dhe t’i mbajnë armët e veta! Jobesimtarët dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajimeve tua, që t’ju sulmojnë me tërë fuqinë. Nuk ka gjynah për ju nëse hasni në ndonjë shqetësim prej shiut ose sëmundjes e i lini armët, por edhe atëherë, bëhuni syçelë. Allahu, me të vërtetë, ka përgatitur dënim poshtërues për jobesimtarët.”** (Nisa, 102)

Në këto ajete fisnike është njoftuar qartë se si mund të falet namazi në këto lloj gjendjesh.

Pranimi i namazit, i cili është një obligim i tillë në jetën e myslimanit, hyn në rrezik me fitimin në haram. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), shprehet:

**“Namazi nuk pranohet përderisa të gjendet një copë prej një rrobe mbi njeriun që e ka marrë atë me dhjetë grosh, ndërkohë që në paratë e tij një grosh është haram.”** (Ihja, 2/236.)

Andaj, nuk mund të mendohet ndonjë dëm më i madh dhe një humbje më e madhe se kjo për një besimtar që i beson Allahut dhe ahiretit, sepse, siç na ka njoftuar edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), pyetja e parë që do të bëhet Ditën e Gjykimit do të jetë për namazin. Nëse llogaria e namazit është në rregull, do të kalohet te veprat e tjera. Nëse nuk është në rregull, veprat e tjera as që do të shikohen...

Allahu i Lartësuar na bëftë të gjithëve prej robërve të Tij që fitojnë në rrugë të lejuara dhe që bëjnë vepra të mira! Amin!

Çdo moment përpiku të fitosh në hallall,

Sado pak qoftë, hallalli është i mjaftueshëm.

Rri larg, mos iu afro haramit!

Harami nuk e ngop njeriun.



# PSIKOLOGJIA DHE PREHJA

## **bashkë me minuset dhe pluset e tyre**

— Kybra Ergin —

Problemi më i madh i shkencës së psikologjisë bashkëkohore është kontradikta që njeriu bën vetë kur pretendon se duke i vënë normë tjetrit e edukon dhe e mëson atë. Shkenca e psikologjisë moderne nuk i jep edukatë njeriut, sepse teoria ideologjike mbi të cilën është bazuar ajo e vlerëson njeriun si një copë frymor që ka evoluar brenda natyrës së vet. Kësisoj, ashtu sikurse nuk mund të vendosim kod etik sjelljeje, ndonjë lloj manuali mbi mirësjelljeje për majmunët, po ashtu as njeriut s'mund t'i vendosim ndonjë rregullore sjelljeje. Madje, Frojdi dhe simpatizantët e tij janë përpjekur që të pengojnë dhe të shtypin instinktet elementare dhe janë munduar t'i paraqesin si burimi i sëmundjeve. Ende sot vazhdon i njëjti botëkuptim; jepen rekomandime të gabuara, si për shembull; kur t'i mësohet fëmijës sjellja e shkuarjes në tualet, duhet sjellë me shumë tolerancë, pasi fëmija në të ardhmen mund të bëhet me shumë vese.

Krahas këtyre, njeriu i cili, si pasojë e edukimit jofetar që merr, është tëhuajësuar ndaj krijimit të vet, pas industrializimit është zhvlerësuar brenda jetës urbane; ndërkohë që kërkon një degë ku të kapet pasi bie në depresion, psikologët tashmë në një farë mënyre janë bërë si murshidët e

Ahizrëmanit. Psikologët, ne vijim të kësaj nevojë, marrin stilolapsin që t'u japin shënimet përkatëse murideve që u kërkojnë ndihmë dhe për t'i shëruar pacientët në fjale kanë zhvilluar disa lloj terapish.

Kur shohim të kaluarën e metodave të psikoterapisë vërejmë se ato bazohen në teori që janë në kundërshtim me njëra – tjetrën. Mënyra se si qasen ndaj njeriut ka bërë që secila prej tyre të dale si reagim ndaj tjetrës. Për shembull; teoria psikologjike e analizimit të pacientëve dhe e përpjekjes së shërimit të tyre përmes hipnozës, këshillimit, psikanalizës etj., pretendon se gjithçka është me bazë kujtimet që shqetësojnë, të cilat janë përjetuar në kohën e fëmijërisë dhe që janë hedhur në të pavetëdijshmen. Në këtë mënyrë, duke i bërë një analizë të thelluar të pandërgjegjshmes arrihet në disa konstatime të caktuara jo shumë të sigurta, behën stigmatizime. Kështu, shpeshherë njerëzit mësojnë (!) sesi prindërit e tyre ua kanë shkatërruar jetën duke bërë sjellje të gabuara ndaj tyre kur kanë qenë të vegjël, kështu i bëjnë përgjegjës këta njerëz që kanë dhënë aq shumë për vite të tëra. Po ashtu është kritikuar mjaft fakti që fajësohen padrejtësisht prindërit kur disa njerëz manifestojnë sjellje të çrregullta për

shkak të ndonjë dëmtimi që kanë në tru.

Kësisoj, metodat e ndryshimit të sjelljeve kognitive që lindin si reaksion ndaj këtyre metodave, zakonisht hedhin shikimin brenda çastit të cilin jetojmë dhe, duke u përpjekur për t'i dhënë një kuptim anormal dhe të tepruar një gjëje apo një fenomeni, çfarëdolloj shkakut që të ketë njeriu, përpiqet të rregullojë sjelljen e sëmurë. Madje, nganjëherë pa ngecur fare tek shkaqet shikon që të pakësojë sjelljen e gabuar dhe të fitojë sjellje të drejta vetëm përmes disa ushtrimeve të caktuara. Nga aspekti i drejtimit të bërë nga shërimi, ndonëse mund të duket praktike, por kjo metodë është së tepërmi edukative. Ky botëkuptim mund të pranohet më shumë si një rezultat i nevojave praktike, që përpiqen ta edukojnë atë, megjithëse nuk posedon një besim apo një pranim mbi ato

gjëra sa të pengojë jetën e punës, mund të përdorë lëndë që mund ta qetësojnë. Mundet që ta shpenzojë jetën e tij duke vrapuar pas karrierës dhe posteve, që përjeton marrëdhënie që i japin kënaqësi, të cilat mund ta dëfrenjë dhe mund ta emocionojnë. Këto janë normale dhe, njerëzit që bien në depresion duke mos u mjaftuar me atë që kanë, duhet gjetur menjëherë një rrugëdalje për këta njerëz dhe sërisht duhet mundësuar përjetimi i së njëjtës vorbull. (!)

Një pjesë e konsiderueshme e pacientëve që shkojnë tek psikologët, u drejtohen psikologëve duke u thënë:

“Nuk kam asnjëfarë çrregullimi në sjellje, asnjë lloj vesi, asnjë fobie, as frikë, por nuk arrij dot të kënaqem nga jeta. Pasi, jetën e kam shumë të pakuptimtë. Nuk e di çfarë duhet të bëj, si duhet



se çfarë duhet të ketë dhe se çfarë mund të jetë njeriu.

Mirëpo edhe kjo metodë është larg së treguari të një objektivi. E gjithë përpjekja e terapive të sjelljes duket sikur është tek realizimi i stabilitetit. E rëndësishme është që njeriu të mund të kalojë jetën e përditshme, të mund të shkojë në punë, të mund të punojë, të mund të vazhdojë jetën e tij familjare. Madje, në përkufizimet e sëmundjes dhe çrregullimit, bie në sy kjo shprehje:

“Frika, droja, pengesa etj., çfarëdo qoftë ankesa, të qenit e saj e fuqishme apo e zgjatur sa të mund ta pengojë jetën e përditshme të njeriut...”

Sikur, “njeriu ideal” është ai që shkon nga shtëpia në punë, nga puna në shtëpi, që dëfrehet me shoqëri, që flet broçkulla, që ka disa argëtime që kënaq veten. Madje, një njeri që nuk e tepron me

t’ia bëj...” Kështu, psikologët kanë shpikur një tjetër terapi:

“Psikoterapia ekzistencialiste”

Sjelljet në këtë terapi nuk depërton në kujtesat e fëmijërisë e as nuk jepen detyra shtëpie. Përgjithësisht, përmes metodës së terapisë së grupit, një grup njerëzish në depresion flasin nën vëzhgimin e psikologut. Pjesë e bisedës së tyre kanë tema mjaft esenciale si; rolet dhe identitetet që merr njeriu gjatë rrjedhës së jetës si dhe tema të rënda si uni ynë përtej roleve në jetë, liria, vdekja etj. Mirëpo, fatkeqësisht me këtë metodë i thonë si të kërkosh gjilpërën në kashtë apo si të kërkosh birën e gjilpërës në errësirë, pra një përpjekje e kote. Shpeshherë bisedat e tyre janë vetëm një e folur jerm. Pasi, është e pamundur që mendja e njeriut të arrijë të gjejë vetvetiu të vërtetën, mbi të gjitha kur nuk përpiqet fare ta kërkojë të



vërtetën akoma me e pamundur. Arsyeja pse po themi “kur nuk përpiqet fare ta kërkojë” është sepse filozofia ekzistencialiste që në krye të herës shprehet se; “Jeta nuk ka ndonjë kuptim, njeriu nuk ka ndonjë qëllim. Njeriu i jep kuptim jetës dhe vetes ashtu sikurse i aka enda”. Duke mbajtur këtë qëndrim, të gjitha shpresat i hedh në greminën e pafund të nihilizmit.

Sipas psikologëve që përkrahin këtë filozofi;

“Njeriu, ngaqë është qenia e vetme që është e ndërgjegjshme për unin e vet, është në një depresion të thellë. Njeriu është i lirë dhe për shkak të kësaj lirie të gjitha përgjegjësitë i mban mbi supet e veta.”

Kjo qasje e cila e percepton njeriun si një qenie që jeton në një vetmi tejet të padurueshme, larg te tjerëve dhe nën peshën që nuk mund ta mbajë, ashtu siç mund të parashikohet, nuk mund të thuhet se ka qenë e suksesshme në sjelljen e ndonjë zgjidhjeje për pacientët, të cilët presin një zgjidhje sa me urgjente. Kësisoj, shumica e psikologëve, përpiqen të ndihmojnë përmes metodave relaksuese të marra hua nga fetë e Lindjes së Largët.

Mund ta zgjasim edhe më tej listën, por le t'i biem me shkurt:

Ndërkohë që mendja e njeriut është një organ i thjeshtë shqisor që njeh, percepton dhe analizon vetëm një pjesë të botës shpirtërore, ndoshta vetëm lëvoren e saj dhe ndoshta vetëm botën materiale; atëherë kur njeriu ngrihet të përkufizojë botën shpirtërore, si ne rastin kur të verbrit përkufizojnë se çfarë ishte elefanti, bëjnë të njëjtin gabim. Natyrisht që ka fusha ku funksionon studimi përmes arsytimit mbi shëndetin psikologjik te njeriut. Sot përmes PET, SPECT, MEG,

f-MR dhe aparaturave të tjera mjekësore, mund të analizojmë qendrat e trurit dhe hormone, të cilat ndikojnë në ndjenjat dhe sjelljet tona. Mund t'i mbledhim informacionet në fusha të ndryshme, përmes metodave të ndryshme, si anketat, testet, statistikatat dhe analizat e ngjarjeve.

Mirëpo këto të dhëna që na akumulohet para nesh porsì një mal i madh, nuk na japin të dhënë themelore, të cilën mund ta ndërtojmë mbi jetën tonë, që mund ta formësojmë veten tonë sipas saj, e cila mund të na udhëheqë kur përdorim vullnetin tonë:

“Përse ekzistojmë ne? Përse Ekziston gjithësia? Përse i jetojmë këto? Çfarë do të ndodhë në fund të tyre? Atëherë, çfarë duhet bërë dhe si duhet të sillemi? Si duhet të veprojmë që të vlerësojmë mirë jetën dhe që mund të jemi njerëz të mira, të vërtetë?”

Përkundrazi, të dhënat që kemi, na drejtojnë më shumë nga:

“Njeriu është një qenie, ndryshe nga gjallesat e tjera, si nga aspekti fizik po ashtu edhe nga struktura shpirtërore e cila administron trupin. Njeriu ka një prirje për t'u drejtuar nga lartësimi i ndjesive dhe mendimeve sublime, që administron instinktet që vijnë nga trupi. Veçanërisht vlerat morale të të vjetërve, stili i jetesës, praktikatat shpirtërore ndikojnë që të zbulohen këto prirje... Atëherë, vallë ato mos dinë diç që ne nuk dimë?”

Sot me orientimin e këtij mendimi; në shumë vende të botës, disiplinat e mbetura nga fetë e vjetra, po u bëhen studime shpirtërore, po praktikohen duke i modernizuar. Mirëpo edhe këto janë larg paraqitjes së vërtetës mbi njeriun dhe larg së rregulluar të rrugëve të lartësimit që kërkon njeriu.

Ekziston një nevojë e thellë që nuk arrin dot të shpalosë rrugëzgjdhjen dhe që nuk arrin ta përkufizojë në mënyrë të duhur asnjë shkollë të psikologjisë, që bën studim mbi nevojat psikologjike të njeriut:

Njeriu ndien nevojën e zhvillimit pors i një embrion në mitrën e kësaj bote dhe lindjes në botën tjetër në formë të përsosur. Për të arritur këtë përsosje, ndien një uri shpirtërore ndaj vitaminave që shpirtit i nevojiten. Të gjithë studimet psikoterapeutiste nuk kanë arritur ndonjë sukses tjetër përveç punës së shtypjes së gjërave dytësore të kësaj urie.

Mirëpo, nuk mund të thuhet se shkenca e psikologjisë nuk ka arritur asnjë lloj suksesi. Pesë natyrat e mëdha të personalitetit (Big Five) janë një shembull për këtë. Realisht është një studim që përmban vlerë. Nëse do të thelloheshim më tej, do të vërenim se Pejgamberi ynë (a.s.), si mësuesi më i përsosur i njerëzimit, i bartte këto cilësi në mënyrën më të përsosur të mundshme si dhe ai i stolisi shokët e tij të ngushtë me këto cilësi sublime.

Emrat në anglisht të këtyre pesë faktorëve që lartësojnë njeriun dhe rrisin cilësinë e jetës së tij, janë: Openness te Experience, Conscientiousness, Extraversion, Agreeableness, Neuroticism, që mund të përkthehen si I hapur drejt Përvojave, Përgjegjësia, Ekstravert, Pajtueshmëria dhe Neurotika.

Tipari që përkthehet si I hapur drejt Përvojave, do të thotë: të mos jesh i mbyllur brenda një trajte të caktuar mendimi, të jesh njeri që mirëkupton, njeri i hapur për dije të reja, për përvoja të reja, i hapur për të zhvilluar pikëpamjet... Një nga tiparet dalluese të shokëve të Pejgamberit nga ata që ishin këmbëngulnin me fanatizëm të qëndronin në rrugën e etërve të tyre, që ishin ngulitur në një fanatizëm të verbuar, të cilët mbyllnin veshët ndaj dijes së re që po u vinte, a nuk është hapja e zemrës ndaj dashurisë për të Dashurit të Allahut dhe që kishin hapur veshët të dëgjonin shpalljen hyjnore? Një hapje ndaj një fillimi krejtësisht të ri me Atë, duke lënë çdo praktikë të vjetër...

Përgjegjësia, që është si tipar i dytë, sikur i vendos një kornizë, një masë mendimit të kësaj "hapjeje ndaj të rejave". Gjendja e të qenit i hapur ndaj të rejave, nuk duhet kuptuar si devijim ndaj përgjegjësiave mbi vlerat morale, mospërfillje, moskokëçarje dhe të kapurit e jetës sipas ëndjes. Përkundrazi, i vetëdijshëm për përgjegjësitë që

ka, njeri që kryen detyrat që ka, madje një njeri që bën detyrën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme, në mënyrë të përsosur, njerëz që ndiejnë veten përgjegjës jo vetëm për gjërat e tyre personale, por edhe për gjërat që e interesojnë njerëzimin, atëherë mund të konsiderohet njeri me personalitet. Këto cilësi që përmendëm, i shohim së tepri në jetën e Pejgamberit tonë të nderuar (a.s.) dhe në jetën e shokëve të tij fisnikë. Një shoqëri e mrekullueshme, që ndiente përsipër përgjegjësinë për tërë ymetin që do vinte deri në Kiamet dhe që sakrifikonte jetën për të lënë pas një etalon virtyti.

Pika tjetër është ekstravert. Natyrisht këtë nuk duhet ta kuptojmë si një socializim i rëndomtë, si një mundshmëri për të folur. Një njeri që përpiket jo si një un i vetëm, por me vendin e tij, në brendësi të së tërës, pikësëpari njeri që përpiket të krijojë kontakt me Krijuesin e vet përmes lutjeve dhe dhikrit. Pastaj, një njeri që është i hapur ndaj kontaktit me rrethin e afërm dhe të largët... Është një njeri që për çdo punë që bën konsultohet me njerëzit e duhur, nuk ecën sipas opinionit vetjak, por duke marrë dhe dhënë dije... Hazreti Enesi (r.a.), lidhur me Pejgamberin (a.s.), ka thënë kështu:

"Nuk kam parë njeri më të dhënë pas konsulentës sesa i Dërguari i Allahut."

Një tjetër trajtë që e plotëson këtë cilësi sublime është edhe sjellja në harmoni, paqeruajtës. Njeri që nuk ecën me mendjemadhësi dhe moskokëçarje, përkundrazi një njeri me zemër të butë, i dashur, modest dhe solidar. Ai është një personalitet në zenit mbi këto çështje...

Si përfundim, të qenit i qëndrueshëm, të cilën mund ta përkthejmë si të qenit në prehje me botën e brendshme, i qetë, i kthjellët dhe i ekuilibruar; mos të ndikuarit në mënyrë të ekzagjeruar nga ndikimet e brendshme dhe të jashtëme. Të kesh cilësi si durimi, qëndrimi, tolerimi dhe me cilësi të tjera të larta. Në krye të asaj detyre të vështirë, ndonëse po kalonte sprovat e llojllojshme, ai kurrë nuk u lëkund, qëndroi pors i një mal gjakftohtë. Ashtu sikurse kishte thënë edhe kur po përcillte xhenazen e Siddikut:

"Ti ishe pors i një mal, i palëkundshëm..."

Ja pra pika ku ka mbërritur shkenca e psikologjisë:

Fundi i këmbëve të mësuesit, te cilin e ka dërguar Allahu...



# DOBËSIMI I FAMILJES

— Sami Byjkkajnak —

Nëse dëshironi të shikoni të ardhmen e një shoqërie, mjafton të shikoni se në çfarë gjendjeje janë familjet e saj. Nëse në një shoqëri familja është e fortë dhe e shëndetshme, ajo shoqëri premtan të ardhme. Si kundër kësaj, nëse familja është prishur në një shoqëri, ekzistenca në të ardhmen e asaj shoqërie është e dyshimtë. Absolutisht që ajo do të vijë në një gjendje saqë të mos njihet, sepse themelin e shoqërisë e përbëjnë familjet. Ndërsa familjen e formojnë njerëz që e ndajnë të njëjtën banesë, që veprojnë me të njëjtat ndjenja dhe që qeshin apo qajnë të gjithë së bashku. Ndarja e banesës me pjesëtarët e tjerë të familjes nuk do të thotë që vetëm të shkosh dhe të dalësh nga shtëpia, pra, me një thënie tjetër, ta përdorësh shtëpinë si hotel. Përkundrazi, do të thotë që të hash e të pish në të njëjtën tryezë, të veprosh me të njëjtat ndjenja, të qash hallet, të rrish dhe të

bisedosh me të tjerë.

Modernizimi, i cili dëshiron ta formojë jetën me sistemin e një jete pozitiviste, deterministe dhe pragmatiste në këtë shekull që po jetojmë, po përpiket të na sundojë si një fatkeqësi mbi kokat tona. Modernizimi, i cili e formon sistemin e jetës së njeriut sipas qëllimit të tij, ka dy këmbë. Këmba e parë është sekularizmi. Ndërsa këmba e dytë është individualizmi.

Institucioni më i rëndësishëm që e sulmojnë më të gjithë fuqinë e tyre këto dy këmbë është familja, sepse ata që do t'i japin suksese modernizmit janë njerëzit që do të bëhen ndjekës të tij. Kur të prishen njerëzit, do të prishet edhe familja. Kur familja të pësojë erozion, do të frenohet përparimi i sistemit të formuar nga Islami. Ja, për këtë arsye, që kur sistemi i familjes në shoqëritë perëndimore

ka filluar të mbartet te shoqëritë islame, familjet kanë filluar të prishen dhe kanë ardhur në një gjendje saqë nuk njihen. Mirë atëherë, por si është familja që e do modernizimi?

Modernizimi i imponon njeriut një familje e cila përbëhet nga pjesëtarë që veprojnë vetëm duke menduar për këtë botë, që nuk e përvetësojnë martesën, që jetojnë ilegalisht, që konsumojnë vazhdimisht, që nuk u japin rëndësi ndjenjave shpirtërore, që i harrojnë fqinjët, të afërmit madje edhe prindërit, që kërkojnë medet nga vendet si qendrat tregtare dhe qendrat e dëfrimit dhe që ngurohen e ngelin në botën e tyre të ngushtë.

Në këtë lloj familjeje sundojnë vetëm marrëdhëniet bilaterale. Fëmijët, nëse është e mundur, duhet të bëhen pasi të realizohet karriera. Televizori dhe interneti janë anëtarët e pandashëm të shtëpisë. Eja në shtëpi në mbrëmje, porosit ushqim të gatshëm, ha, kalo në krye të televizorit, në njërin dorë mbaj kompjuterin dhe kalo kohë me ta deri në orët e vona të natës. Pastaj shko për të fjetur, ngrihu në mëngjes, shko në punë, në fund të javës shko te qendrat tregtare që janë faltoret moderne të modernizmit, shetit, dëfrehu, ha, pi, bëj allishverish dhe kënaqu deri në mbrëmje. Nëse të kujtohet, merri në telefon prindërit që kanë mbetur në azil të pleqve. T'i vizitosh the? Nuk ka kohë. Fqinji ka vdekur dhe trupi i kundërmon... Kujt i intereson. Ja, kjo është familja moderne.

Kjo mënyrë jetese, para 15-20 viteve, i përkiste strukturës së quajtur "familja moderne perëndimore" që ishte integruar në modernizëm. Përgjatë viteve të tëra, nëpër telenovelat e televizorëve dhe shfaqjeve të kinemave, njerëzve u është dhënë për të ndjekur kjo mënyrë jetese familjare. Këto telenovela dhe filma u janë dhënë aq shumë fëmijëve dhe familjeve të vendeve islame për t'i ndjekur saqë tani, si rezultat i ndikimit të këtyre, në strukturën e familjes myslimane kanë filluar të shfaqen prishje të konsiderueshme. Të rinjtë që e kanë hedhur martesën në plan të dytë dhe që kanë filluar të jetojnë me lidhje të paligjshme, ti rinjtë e rritur pakëz që e braktisin shtëpinë dhe formojnë një vatrë tjetër, të rinjtë që nuk i njohin prindërit, të rinjtë që nuk interesohen me fqinjët e me të afërmit dhe ata që nuk e vrasin mendjen për të siguruar jetesën pasi martohen, tashmë kanë filluar të duken si normalë në shoqëritë myslimane.

Në strukturat e familjes janë shfaqur prishje të tilla që edhe ata të cilët sapo janë martuar, pas pak kohe fillojnë të mos e pëlqejnë më njëri-tjetrin. Bashkëshortët që duhet të jenë si një petk për njëri-tjetrin në vështirësi dhe probleme, për shkak të orientimit të kulturës populiste, kanë arritur në një gjendje që e kanë syrin dhe zemrën jashtë (te dikush tjetër). Ata që pandehin se do të bëhen të

lumtur me flirtin para martesës, nuk e durojnë dot njëri-tjetrin kur të fillojnë të ndajnë të njëjtën vatrë dhe të njëjtën familje. Ata që pranojnë vetëm bukurinë si rregull në zgjedhjen e bashkëshortit/es, nuk e gjejnë dot shansin për të ndërhyrë kur t'u shkatërrohet familja. Familjeve të cilat shkojnë, edhe nëse duken si të tyre, në të vërtetë u janë pakësuar gjurmët që mbartin prej tyre. Të folurit, veshja, qëndrimi dhe sjellja e bashkëshortit/es, tregojnë se janë shumë larg familjes. Sjelljet, flokët, mjekra, të folurit, veshja, qëndrimi ulur dhe ngritja e fëmijës nuk janë prej asaj familjeje. Veshja, shikimi, makijazhi dhe flokët e vajzës i përkasin dikujt tjetër. Familjet që përjetojnë probleme në përshtatshmëri me fëmijët dhe bashkëshortët dhe që e kanë stilin e jetës të ndryshëm janë shtuar pa masë.

Sot është e pamundur të mos i përkushtohesh rëndësisë së shpëtimit të familjes myslimane. Myslimanët duhet t'u kthehen përsëri familjeve të tyre, në mënyrë që të mos ndjehet edhe më shumë në të ardhmen shkatërrimi i modernizmit që i ka dërmuar familjet tonë këto pesëmbëdhjetë vitet e fundit. Ky kthim mund të realizohet duke u kapur fort pas vlerave që janë humbur dhe duke i dhënë rëndësi edukimit kuranor e profetik. Në këtë çështje duhet të mendojmë për dobinë e "seminareve të shkollës së familjes" që i organizojnë dijetarët të cilët i reflektojnë në familjet e tyre vlerat që posedojnë me anë të përvojave të tyre dhe që e lodhin kokën për këtë punë. Sigurisht se formimi i rregullit familjar nuk është një punë që mund të kryhet vetëm me anë të shkollës. Familjet duhet të japin ndihmën më të madhe ndaj këtyre shkollave që mund të konsiderohen si përpjekja më e madhe për themelimin e vatrës familjare islame. Çdokush që dëshiron ta shpëtojë familjen e tij nga sundimi i modernizmit dhe t'i japë prehje e paqe asaj, nuk duhet të kufizohet vetëm me shkuarjen në këto shkolla, por duhet të shfaqë përpjekjen për ta shpëtuar familjen nga robëria e kafazeve të modernizmit dhe duhet ta pakësojë sa të jetë e mundur depërtimin në shtëpinë e tij të ndërhyrjeve të jashtme, madje nuk duhet t'i lejojë aspak këto ndërhyrje, në mënyrë që t'ia japë familjes vlerat që do ta mbajnë në këmbë atë. Rezultati i shtëpive që ngrihen sipas rregullave që na ka treguar Allahu Teala dhe i Dërguari i Tij (s.a.s.), është njëra këmbë e xhenetit në këtë botë. Bashkëshortja e devotshme, fëmija i hajrit dhe rrësku hallall janë themeli i këtyre familjeve. Përforsimi i këtij themeli është i mundur vetëm duke formuar mburoja kundër kërcënimeve të jashtme.

Lum për ata që e shpëtojnë familjen e tyre duke përdorur mburojën e Islamit kundër sundimit të modernizmit!..

# MËSHIRA E PROFETIT (A.S.)

— Naim Driaj —

Fjala “mëshirë” përmban mirësinë, dhembshurinë, dashurinë, miqësinë, lumturinë, përmirësimin, edukimin, udhëzimin etj. Allahu (xh.sh.), e filloi krijimin e gjithësisë me atë të mëshirës. Fjala e para që i tha njeriut ishte fjala “Mëshirë!” Librin e Tij që ia shpalli njerëzimit, e filloi me mëshirë. Të gjitha suret e Kuranit përveç sures Tevbe fillojnë me “بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ” “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirë - shmit, Mëshirëplotit!”

Emri i Zotit (xh.sh.), “Err-Rrahim në Kuranin famëlartë përmendet 114 herë, ndërsa emri “Err-Rrahman” përmendet 57 herë. (Türkiye Diyanet Vakfı islam Ansiklopedisi. Viti, 2007, vëll, 34, f. 419.) Besimtari të paktën tridhjetë e katër herë në ditë, gjatë faljeve të detyruara, e përsërit këtë togfjalësh: “الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ”.

Njerëzimi, sidomos në ditët e sotme, ka nevojë të madhe për këtë cilësi madhështore që nxit në plotësimin e të drejtave të prindërve dhe të afërmve, në ndihmë të të dobtëve, jetimëve, si dhe në ruajtjen e të drejtave të çdokujt tjetër. Mëshira është cilësi e Allahut (xh.sh.), sepse mëshira e Tij i ka përfshirë të gjitha krijesat. **“Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe diturinë Tënde.”** (Gafir, 7)

Mëshira e përsos natyrën e njeriut dhe e bën atë të jetë i ndjeshëm ndaj dhimbjeve të krijesave. Aty ku ndodhet mëshira, ekziston paqja, respekti dhe marrëdhëniet e mira.

Shumë prej emrave të bukur të Allahut burojnë nga kuptimet e mëshirës, fisnikërisë, mirësisë faljes etj. Në një hadith kudsiy thuhet: **“Mëshira Ime e ka kaluar hidhërimin Tim.”** (Muslimi.) Në lidhje me hadithin e mësipërm, Ibnul Kajjimi thotë: “Mëshira është baza e emrave dhe cilësive të Allahut (xh.

sh.). Kjo, për arsye se Allahu i Madhëruar është i Mëshirshëm dhe kjo është në natyrën e Tij, ashtu siç është dituria, fuqia, aftësia, dëgjimi, shikimi, mirësia etj.

Myslimani, i cili i kupton mësimet e Islamit, është i mëshirshëm, pasi ai e kupton se mëshira ndaj njerëzve në tokë do të bëjë që të zbresë mëshira e qiellit: **“Jini të mëshirshëm ndaj atyre që janë në tokë, që t’ju mëshirojë Ai që është në qiell.”** (Buhariu)

Myslimani ka mësuar nga kjo fe se: **“Kush nuk i mëshiron njerëzit, nuk do të mëshirohet nga Allahu.”** (Taberani.) **“Të mëshirshmëve do t’ju jepet mëshirë nga i Gjithëmëshirshmi.”** (Buhariu në el-Edeb el-Mufred.) **“Mëshira nuk largohet përveç nga njeriu fatkeq (i mjerë).”** (Tirmidhiu.)

Myslimani i vërtetë nuk e kufizon mëshirën e tij, vetëm ndaj familjes, fëmijëve dhe shokëve, por i mëshiron të gjithë njerëzit. Kjo është në pajtim me mësimet e të Dërguarit (a.s.), i cili përfshiu në mëshirën e tij të gjithë njerëzit dhe e bëri mëshirën kusht të besimit, siç transmeton Ebu Musa el-Esh’ariu (r.a.), nga i Dërguari (a.s.): **“Ju nuk keni besuar derisa të mos mëshironi njëri-tjetrin.”** Ata thanë: “O i Dërguar i Allahut, të gjithë ne jemi të mëshirshëm.” Ai tha: **“Nuk e kam fjalën për mëshirën tuaj ndaj shokut, mirëpo për mëshirën ndaj të gjithë njerëzve dhe mëshirën ndaj njerëzve të rëndomtë.”** (Taberani.)

Omeri (r.a.), dëshironte ta caktonte një njeri në një pozitë, mirëpo e dëgjoi duke thënë diçka që e kishte thënë El-Akre ibn Habis, se nuk i puthte fëmijët e tij. Kështu Omeri e ndërroi mendjen dhe tha: **“Nëse zemra jote nuk rrah me mëshirë ndaj fëmijëve tuaj, si mendon të jesh i mëshirshëm ndaj njerëzve të tjerë?”** Pasha Allahun, kurrë nuk do t’ju

caktoj.” Pastaj e grisi kontratën, të cilën e kishte përgatitur për këtë njeri.

Myslimani është i mëshirshëm. Mëshira është pjesë e moralit të tij. Transmetohet se një herë, Zejnel Abidinin, të birin e Husejnit, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur ishte duke shkuar në xhami, e shau dikush. Shërbëtorët e tij u vërsulën të rrihnin ofenduesin, por ai, nga mëshira që ndjeu për atë njeri, i ndaloi. Pastaj i tha: “O njeri! Unë jam më i keq se ç’më the ti tani.

Ajo çka ti nuk di për mua është më e madhe se ajo që di, prandaj, nëse kërkon të dish më shumë, mjafton të më thuash!” Personi u turpërua kur dëgjoi këto fjalë, ndërsa Zejnel Abidini hoqi këmbishën e vet dhe ia fali atij, së bashku me një mijë derhemë. Kjo falje dhe bamirësi nuk ishin gjë tjetër, veçse shprehje e mëshirës që ndodhej në zemrën e nipit të Profetit (a.s.). (Ebu Bekër el Xhezairi, “Minhaxh el Myslim” botimi i 2-të, Tiranë, 2006, f. 160.)

Mëshira islame ka vend dhe në luftë me armikun. Pejgamberi (a.s.), i këshillonte luftëtarët myslimanë para betejës, duke u thënë: “O Myslimanë! Mos vrisni gratë e fëmijët, mos vrisni pleqtë. Në ato vende do të shihni murgjër, që adhurojnë Zotin sipas formës së tyre. Mos i prekni këta njerëz. Mos i digjni të mbjellat e tyre, mos i vrisni kafshët e tyre, mos i prisni pemët e tyre. Luftoni vetëm ata që ju luftojnë juve”.

Pasi Zoti e shpërbleu profetin e tij me fitore në Bedër, myslimanët zunë shumë mekas robër. Robërit e kapur gjatë betejës së Bedrit ishin ndër armiq të më të betuar të tij. Profeti Muhamed (a.s.), i shpërndau në shtëpitë e myslimanëve të cilët i porositi: “I trajtoni mirë!” Mes tyre ishte edhe Suhejl ibn Amr, një nga oratorët më të zjarrtë kundër Profetit (a.s.). Omer ibn Hattabi vajtë tek Profeti (a.s.) dhe i tha: “O i dërguar i Allahut! Më lejo t’ia shkul dhëmbët e parë Suhejlit. Kështu nuk do mund të të fyejë dhe ironizojë.” Suhejl njihej si orator dhe ironizonte myslimanët pa pushim. Profeti (a.s.), ia ktheu: “Unë nuk gjymtoj. Përndryshe do më gjymtojë Zoti, edhe pse jam profet.” I tillë ishte profeti i mëshirës në sheshin e luftës.

Në momentet më të rënda, në luftën e Uhudit, kur idhujtarët u munduan ta vrisnin Pejgamberin (a.s.) dhe e detyruan atë të drejtohej drejt një kurthi, një grope të hapur. I rrethuar nga të gjithë anët me armiq Pejgamberi (a.s.), u plagos rëndë aq sa u dëmtua në fytyrën e bekuar që ia mbuloi gjaku dhe iu thyen dy dhëmbët e përparmë. Sahabët u zemëruan dhe i thanë: “Lutu kundër tyre (idhujtarëve), o i Dërguar i Allahut”, ndërsa ai iu përgjigj: “Unë nuk jam dërguar për të mallkuar, por vetëm për mëshirë”. Ai i ngriti duart nga qielli, dhe njerëzit që e panë duke vepruar ashtu menduan se Profeti do t’i mallkonte idhujtarët, ndërsa nga goja e tij e

bekuar dolën fjalët: “Zoti im! Fale, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk e dinë se ç’po veprojnë”.

Banorët e Mekës përdorën të gjitha mënyrat për t’i shkaktuar vuajtje Profetit (a.s.), derisa përfundimisht e detyruan të emigronte në Medinë. Kur Ai hyri triumfues në Meke pas 23 vitesh, i fali të gjithë. Ai u tha: “Shkoni se jeni të falur”. (Bejhakiu në Sunenul Kubra)

I Dërguari (a.s.), përveç mëshirës ndaj njerëzve, nxiti edhe për mëshirë ndaj kafshëve. Ebu Hurejra (r.a.), transmeton dhe thotë se i Dërguari (a.s.), ka thënë: “Një njeri, duke udhëtuar e kishte lodhur etja e madhe, gjen një pus dhe zbret poshtë dhe shuan etjen. Kur del jashtë gjen një qen me gjuhë të nxjerrë jashtë, që hante dheun nga etja. Atëherë mendoi me vete: “Kjo krijesë ndihet e etur, ashtu siç ndihesha unë pak më parë.” Atëherë zbret përsëri në pus, mbush këpucën e tij me ujë dhe ngjitet e ia jep qenit. Allahu për këtë e shpërbleu dhe ia fali gjynahet.” (Buhariu dhe Myslimi)

“Një grua u ndëshkua për shkak të një maceje. Ajo e mbylli atë derisa ngordhi nga uria. As nuk e ushqeje dhe as nuk e la të lirë të ushqehej vetë.” (Buhariu dhe Myslimi)

Një herë një njeri ia kishte marrë vezën një zogu. Ai (a.s.), tha: “Kush e ka shqetësuar atë duke ia marrë vezën?” Njeriu i tha: “O i Dërguar i Allahut, unë e kam marrë atë.” I Dërguari (a.s.), i tha: “Ktheja nga mëshira ndaj saj.” (Buhariu në el-Edeb el-Mufred) Pejgamberi (a.s.), dëshiroi në këtë rast, të nguliste një ndjenjë të mëshirës gjithëpërfshirëse në ndërgjegjen e myslimanit, kështu që ata të bëhen të mëshirshëm nga natyra, madje edhe ndaj kafshëve, pasi kush ka zemër të mëshirshme ndaj kafshëve, nuk do të jetë i vrazhdë ndaj vëllait të tij.

Gjatë kthimit nga një fushatë ushtarake disa nga shokët e Profetit morën disa zogj nga një fole dhe filluan t’i përkëdhelnin. Pasi nëna e tyre u kthye dhe nuk i gjeti në fole, filloi të fluturonte përreth duke i kërkuar. Sapo dëgjoi për këtë, Profeti (a.s.), u nervozua dhe urdhëroi që zogjtë të ktheheshin në follenë e tyre. (Ebu Davudi)

Historianët thonë se kur Amr Ibnul As hyri në Egjipt, një pëllumb vendosi follenë në tendën e tij. Kur erdhi koha për t’u larguar, atij i erdhi keq t’ia prishte pëllumbit follenë dhe kështu nuk e prishi tendën. Ndaj dhe tenda nuk u prish, përkundrazi vendi filloi të popullohej dhe në këtë mënyrë lindi qyteti Fustat. (Dr. Jusuf Kardavi, “Besimi dhe jeta” Furkan 2010, f. 290-291)

Kur mëshira përhapet në tokë, nga qielli zbret mëshira hyjnore. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Mëshironi ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojë Ai që është në qiell.” (Taberani)



# Jo Vetëm për Gatim

*Zbuloni përdorimet e habitshme të qepës*

Pavarësisht aromës dhe lotëve që shkakton, qepa është një nga ushqimet më të vlerësuara në botë.

Qepa është aq e mirë dhe e shëndetshme për njeriun sa ndoshta do të ishte me vend të thuhej “një qepë në ditë i thua mjekut ik.”

Qepët janë të dobishme kundër sëmundjeve dhe baktereve, madje e mbrojnë organizmin nga dëmtimet e qelizave.

Kurat e mëposhtme me bazë qepe mund të duken të çuditshme por funksionojnë me të vërtetë.

## KUR FTOHESH, VAR NJË QEPË

Zgjidhni një qese rrjetë, futeni qepën në të dhe vareni sa më pranë shtratit.

Aroma e qepës do të mbushë dhomën dhe do të çlirojë hundën dhe fytyrën e bllokuar.

Qepa nuk duhet qëruar sepse flavonoidët ndodhen pikërisht në shtresën e jashtme.

Kur të zgjoheni në mëngjes, do të habiteni me frymëmarrjen pa probleme që vjen si pasojë e qepës.

## QEPA KUNDËR GJAKDERDHJES NGA HUNDËT

Nëse ju del gjak nga hundët, vendosni një copë qepë nën hundë.

Qepa do të ndalojë gjakderdhjen menjëherë.

## QEPA PËR GJUMË TË MIRË

Qepa kuron pagjumësinë.

Prisni një qepë në dysh dhe nuhateni pesë deri në dhjetë herë përpara se të bini për të fjetur.

Për rezultate më të mira, vendoseni qepën në një gotë pranë shtratit dhe do ju zërë gjumi menjëherë.

## QEPA KUNDËR MUSHKONJAVE

Priteni një qepë në gjysëm dhe vendoseni në një enë të mbushur me ujë.

Vendoseni enën pranë vendit të punës apo ndenjes dhe insektet do rrinë larg jush.

Një alternativë më e shpejtë është që të lyeni lëkurën e pickuar nga insektet me lëngun e qepës.

## QEPA KUNDËR NJOLLAVE TË MOSHËS

Qepët eliminojnë njollat e errëta në lëkurë sepse përmbajnë sulfur dhe acide që shërbejnë si eksfoliantë. Prisni një qepë të kuqe dhe me të fërkoni njollat e lëkurës.

Fytyrën shpëlajeni pas 10-15 minutash.

Përsëriteni dy herë në ditë dhe do të vini re zhdukjen e njollave.

## QEPA KUNDËR DHIMBJEVE TË FYTIT

Çaji i qepës zbut fytin e lënduar.

Përdorni lëkurën e jashtme të qepës dhe zijeni në ujë. Pasi uji të ketë marrë ngjyrën e lëkurës së qepës, hiqeni nga zjarri, lëreni të ftohet dhe pijeni.

Pas një ore nuk do të keni më dhimbje.

## KUNDËR DHIMBJEVE TË CIKLIT

Qepët zbusin dhimbjet e ciklit tek femrat.

Ekspertët rekomandojnë konsumin e qepëve të freksëta 4-5 ditë përpara nisjes së ciklit që të keni më pak dhimbje.

## PILAFI I DJEGUR

Nëse pilafi që keni gatuar për drekë është djegur pak, atëherë përdorni qepën.

Prini një qepë në gjysmë.

Njëren gjysmë vendoseni sipër pilafit. Në më pak minuta aroma e djegur do të zhduket

## KUNDËR PICKIMIT TË BLETËS

Nëse bleta ose grenza ju kanë vënë në shënjestër atëherë përdorni lëngun e qepës dhe dhimbja do të zhduket pothuajse menjëherë.

## PËRMIRËSON HUMORIN

Qepët përmirësojnë humorin dhe shëndetin mendor.

Sulfuri tek qepa kombinohet me proteinat e sistemit dhe stimulojnë prodhimin e aminoacideve në tru.

Konsumi i qepëve zbut simptomat e stresit, depresionit dhe problemeve të tjera mendore.

# Ndikimi i Vitaminës D

Vitamina D është thelbësore për shëndetin e megjithatë shumë njerëz nuk e kuptojnë rëndësinë e saj. Ekspertët thonë se në një pikë të jetës, njerëzit përballen me rënien e niveleve të vitaminës D, ndonëse nuk e kuptojnë një gjë të tillë. Nivelet e ulëta të vitaminës D manifestohen me një sërë simptomash siç janë: energjia e pakët, pagjumësia, problemet me imunitetin dhe luhatjet e humorit.

## FAKTE TË RËNDËSISHME PËR ROLIN E VITAMINËS D NË ORGANIZËM

Burimi më i mirë i vitaminës D është dielli. Ekspozimi i pakët ndaj tij, ul ndjeshëm nivelet e vitaminës D në organizëm që pasohet me probleme të tjera me shëndetin.

## VITAMINA D UL RREZIKUN E KANCERIT TË GJIRIT

Ekspertët thonë se të qëndruarit në diell për pak kohë çdo ditë ul rrezikun e kancerit të gjirit. Ekspozimi në diell, stimulon prodhimin dhe sintetizimin e kësaj vitamine në lëkurë dhe një gjë e tillë përgjysmon rrezikun e kancerit të gjirit. Ekspertët rekomandojnë qëndrimin në diell për 20-30 minuta në ditë.

## VITAMINA D UL RREZIKUN E SKLEROZËS SË SHUMËFISHTË.

Shqipëtarët janë me fat sa i përket klimës së ngrohtë dhe ekspozimit në diell. Por një pjesë e konsiderueshme e vendeve të globit i gëzohet shumë pak ditëve me diell. Në këto vende regjistrohen edhe shifrat më të larta të sklerozës së shumëfishtë. Një gjë e tillë i ka shtyrë ekspertët të arrijnë në konkluzionin se ka një lidhje të fortë mes vitaminës D dhe shëndetit të trurit.

## MUNGESA E VITAMINËS D

Gjetjet e shumë studimeve mbi ndikimin e mungesës së vitaminës D në shëndet janë shqetësuese. Disa prej tyre paralajmërojnë se nivelet e ulëta të vitaminës D kanë lidhje të fortë me vdekjen e parakohshme. Madje mungesa e vitaminës D e dyfishon rrezikun e vdekjes së parakohshme.

Vitamina D e mbron njeriun nga tensioni i lartë i gjakut, sëmundjet e zemrës, madje edhe nga ishemia. Megjithatë, frika për kancerin e lëkurës po i mban njerëzit larg diellit, duke ulur në mënyrë të pashmangshme nivelet e kësaj vitamine.



## DRONËT QË MBROJNË TË KORRAT NGA INSEKTET

Insektet fluturuese shkatërrojnë miliarda dollarë të korra në botë çdo vit. Megjithatë shpesh herë fermerët zgjedhin të mos përdorin pesticide për të mbrojtur bimët e tyre. Por një kompani e re në Holandë thotë se ka gjetur një zgjidhje.

Në mes të natës në Holandë, një dron gjahtar vë në shënjestër një qenie të paftuar.

Bëhet fjalë për fluturat e natës që kërcënojnë të korrat në serrat si ajo në Koppert Cress.

“Nuk mund të përdor kimikate. Jam furnizues restorantesh. Kam produkte unike të cilat nuk çertifikohen për t’u spërkatur me kimikate prandaj nuk e dua”, thotë Rob Baan, pronar i kompanisë Koppert Cress.

Një kompani e re holandeze, Pats Drones, projekttoi një dron të modeluar nga studentët që donin një mënyrë për të vrarë mushkonjat. Krijuesi i kësaj teknologjie Kevin van Hecke, shpjegon se sistemi përdor dy kamera për të përcaktuar pozicionin e fluturës së natës dhe dronit.

“E sheh duke fluturuar. Sistemi e di se ku ndodhet droni i cili nis drejt insektit. Duhet ta bëjë atë në mënyrë shumë të shpejtë”, thotë ai.

Në serrën Koppert Cress, zoti Baan thotë se droni gjahtar e di se cilat insekte të sulmojë e cilat të mos i ngacmojë lë rehat.

“E dallon nga fluturat e tjera, e di cilat të vrasë e cilat jo, sepse disa prej tyre nuk janë të dëmshme, si për shembull mollëkuqja sepse ajo mbron nga disa insekte të tjera. Pra dronët duhet të vrasin inspektet e këqia. Ato të mirat janë shumë të shtrenjta. Unë paguaj të paktën 50 cent për një grerëz, prandaj nuk dua që dronët të vrasin grerëzat”, thotë Rob Baan, pronar në Koppert Cress.

Zoti Baan thotë se një flutur nate e vetme mund t’i shkaktojë dëme prej dhjetra mijëra eurosh, prandaj mirëpret sigurinë e dronëve fluturues.

Sipas Kombeve të Bashkuara mes 20 dhe 40 për qind të prodhimit botëror të kulturave bujqësore çdo vit shkatërrohet nga qeniet keqdashëse. Vetëm insektet dëmtojnë rreth 70 miliardë dollarë.

## NASA PUBLIKON TINGUJT E PARË TË REGJISTRUAR NË MARS

Agjencia amerikane e hapësirës NASA ka publikuar një regjistrim audio dhe erërave marsiane dhe tingullin e një lazeri drejtuar një shkëmbi. Ato u regjistruan nga sonda Perseverance, ndërsa filloi për herë të parë të përdorë instrumentat e saj shkencorë të sofistikuar.

Regjistrimet, të publikuara nga NASA të mërkurës, u bënë nga instrumenti SuperCam i sondës, i krijuar nga bashkëpunimi mes Labororit Kombëtar Los Alamos (ILANL) në New Mexico dhe agjencisë hapësinore franceze, Qendra Kombëtare e Studimeve Hapësinore (CNES).

Instrumenti është montuar në direkun e sondës dhe përmban një kokë 5.6 kilogramëshe me sensorë

që mund të kryejë pesë lloje analizash për të studiuar gjeologjinë e Marsit dhe për të ndihmuar shkencëtarët të zgjedhin se nga cilët shkëmbinjtë duhet të merren mostra në kërkim të shenjave të jetës.

Sonda lëshoi impulse lazeri në një shkëmb rreth tre metra larg, të cilat mund të dëgjohen në regjistrime si tinguj klikimi. Shkencëtarët do të jenë në gjendje të studiojnë ndryshimet në intensitetin e tingujve për të dhënë informacion në lidhje me strukturën fizike të objekteve dhe nëse ata janë kandidatë të mirë për analiza më nga afër.

Regjistrimet janë pjesë e kontrolleve të integritetit të sistemit që kryhen për t’u siguruar që të gjitha instrumentet funksionojnë siç duhet.

Që kur sonda Perseverance, me madhësinë e një automobili, zbarkoi në Mars më 18 shkurt, ajo ka kryer kontrolle për të gjitha sistemet dhe nënsistemet e tij. Të dhënat e hershme nga testet e instrumentit SuperCam - përfshirë tingujt nga Planeti i Kuq - kanë qenë intriguese.

## GM: NË VITIN 2035 DO TË PRODHOJMË VETËM MAKINA ELEKTRIKE

Premtimi i kohëve të fundit i kompanisë “General Motors” për të prodhuar vetëm automjete elektrike deri në vitin 2035, me përjashtim të kamionëve të rëndë, pritet të shërbejë si nxitje e madhe drejt largimi nga përdorimi i naftës dhe benzinës si burime energjie në industrinë e automobilëve. Korrespondenti i Zërit të Amerikës Mike O’Sullivan njofton për këtë prirje globale, siç e quajnë analistët.

General Motors ka një synim ambicioz që, pas 14 vjetësh të prodhojë vetëm makina elektrike, përfshi SUV dhe kamionë të vegjël dhe pesë vite më vonë të bëhet një kompani që eliminon ndotjen nga karboni. Mary Barra është shefja ekzekutive e gjigandit General Motors.

“Vizioni ynë për të ardhmen është një botë pa aksidente, pa ndotje dhe trafik.”

Kjo do të thotë ulje e varësisë nga karburantet fosile dhe zvogëlim i ndotjeve nga dioksidi i karbonit që po ngrohin planetin.

General Motors hyri në vitin 2010 në tregun e gjelbër me makinën hibride me benzinë dhe bateri Chevy Volt.

Por në vitin 2019 GM doli në krah të administratës Trump për të luftuar standardet e rrepta të ndotjes të miratura nga Kalifornia dhe të ndjekura nga 12 shtete të tjera. Nën administratën Biden, trajektorja po zhvendoset, thotë profesori i biznesit Martin Zimmerman i cili ka qenë kryeekonomist dhe nën-president i grupit Ford.

“Po shohim një ripozicionim të General Motors dhe sigurisht që po e përshtat politikën dhe vizionin e saj në përputhje me synimet e administratës Biden.”

Industria ka ecur në të njëjtin drejtim por me hapa të ngadaltë. Kompania Tesla ka provuar se makinat elektrike mund të tërheqin konsumatorët. Analistët thonë se tregu amerikan mbetet i vogël.

Tyson Jominy është zyrtar i lartë në kompaninë J.D. Power.

“Tregu i makinave elektrike aktualisht është vetëm

Shkencëtarët shpresojnë të gjejnë gjurmë biologjike të ngulitura në mostrat e mbetjeve antike që sonda Perseverance do të nxjerrë nga shkëmbinjtë marsianë për analiza të ardhshme kur të jenë marrë në Tokë.



2%. Tregu i makinave elektrike në Evropë tremujorin e fundit arriti në 10%.”

Në Kinë makinat elektrike zënë më shumë se 5% të tregut. Por në Norvegji, ato zënë më shumë se 50%.

Amerikanëve u pëlqejnë makinat e mëdha të cilat harxhojnë shumë karburant, dhe sjellin fitime të larta për prodhuesit. Bruce Belezowski punon për kompaninë hulumtuese “Automotive Futures Group”.

“Vitin e shkuar, 70% e automjeteve të shitura ishin makina të larta ose kamionë. Që të shiten, makinat elektrike duhet të prodhojnë këto lloj tipesh.”

Por sfida është se fitimet do të jenë të vogla në prodhimin e kamionëve dhe makinave të larta. Megjithatë, GM do të nxjerrë në shitje këtë vit një SUV elektrike të tipit Hummer dhe do të zgjerojë ofertat deri në fund të dekadës. Problem tjetër është edhe çmimi i lartë i baterive, thotë Tyson Jominy i firmës J. D. Power.

“Ekziston një prirje që kosotoja e baterisë është duke u ulur me shpejtësi. Sikurse kemi parë me kompaninë Tesla, po rritet edhe kilometrazhi që përshkohet me një karikim të baterisë.”

Stacionet e karikimit janë të pakta, kryesisht kur flitet për udhëtime të gjata. Një studim nga J.D. Power tregon se kjo është shqetësuese për pronarët e makinave elektrike.

“Ka gjasa që do të duhet ndihma e qeverisë për të kapërcyer këtë problem. Konsumatorët nuk do të blejnë makina elektrike nëse nuk ka kudo stacione për rimbushjen e baterive. Nga ana tjetër, njerëzit nuk duan të investojnë në stacione karikimi nëse nuk ka automjete elektrike të mjaftueshme”, thotë profesori Martin Zimmerman.

Stimuj qeveritarë, rritja e kërkesës, përmirësimi i teknologjisë, përhapja e infrastrukturës dhe rënia e çmimit, janë të gjitha këto pjesë e ekuacionit para se makinat elektrike të mund të dominojnë tregun.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,  
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,  
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,  
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



**CIKLI FILLOR**

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË  
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Ne e kemi zbritur  
(Kuranin)  
në Natën e Kadrit.  
E kush mund  
të ta shpjegojë ty  
se ç’është  
nata e Kadrit?”

*(Kadr, 1-2)*